

RELACION

mbi

PROJEKTLIGJIN

“PËR BUXHETIN E VITIT 2015”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Ministria e Financave

Tiranë, Tetor 2014

Ky dokument mund të aksesohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë
(<http://www.financa.gov.al>)

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
2. SITUATA EKONOMIKE NË SHQIPËRI	7
2.1 ZHVILLIMET KRYESORE MAKROEKONOMIKE GJATË VITIT 2014	7
2.2 PERSPEKTIVA AFATMESME	9
3. TREGUESIT KRYESOR TË BUXHETIT PËR VITIN 2015	10
3.1 TË ARDHURAT	10
3.2 SHPENZIMET	11
3.3 DEFICITI BUXHETOR DHE BORXHI PUBLIK	14
3.4 BUXHETI VENDOR 2015	14
4. POLITIKAT SEKTORIALE	16
5. POLITIKAT E TAKSAVE PËR VITIN 2015	30
5.1 PAKETA E RE FISKALE	30
5.2 POLITIKAT PËR MBËSHTETJEN E BIZNESIT	32
6. RREZIQET DHE MASAT PËR ZBATIMIN RIGOROZ TË BUXHETIT 2015	34
6.1 MOSREALIZIMI NË KOHË I INVESTIMEVE PUBLIKE	34
6.2 VENDIMET GJYQËSORE/ÇËSHTJET E PRONËSISË	35
6.3 AKUMULIMI I DETYRIMEVE TE REJA	35
6.4 ADMINISTRIMI I TË ARDHURAVE TATIMORE	36
6.5 MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK	38
7. CILËSIA E FINANCAVE PUBLIKE	39
7.1 PLANIFIKIMI BUXHETOR AFATMESËM	39
7.2 BUXHETIMI MBI BAZË PERFORMANCE	39
7.3 REFORMA NË MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE	40
7.4 REFORMA E ENERGJISË	40
7.5 REFORMA E PENSIONEVE	41
7.6 SHLYERJA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA DHE PARANDALIMI I KRIJIMIT TË DETYRIMEVE TË REJA	42

8. SHTOJCAT ILUSTRUESE.....	42
8.1 TREGUESIT E PËRZGJEDHUR MAKROEKONOMIKË DHE FISKALË.....	42
8.2 ZHVILLIMET FISKALE GJATË 9-MUJORIT 2014.....	45
8.3 ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN JANAR-GUSHT 2014.....	55
8.4 SHPJEGIME MBI TRANSFERTËN E PAKUSHTËZUAR E PUSHTETIT VENDOR.....	63
8.5 ECURIA E BORXHIT PUBLIK PËR PERIUDHËN JANAR-GUSHT 2014.....	65

1. HYRJE

Qeveria shqiptare është e angazhuar për zbatimin e një programi ambicioz reformash, që synojnë arritjen e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike me rezultate konkrete në punësim dhe në përmirësimin e mirëqenies së shqiptarëve. Ky program ka në bazë përpjekjet për rritjen e stabilitetit makroekonomik si një parakusht i rëndësishëm për një rritje të qëndrueshme ekonomike. Projektbuxheti i vitit 2015, pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm 2015-2017, është përgatitur në funksion të mbështetjes së këtyre reformave, duke përmirësuar më tej parametrat makroekonomikë dhe fiskal. Buxheti i vitit 2014, kishte synime ambicioze si në nivelin e të ardhurave, ashtu edhe në atë të shpenzimeve, synime të cilat u përmbushën me sukses. Buxheti i vitit 2015 mban të njëjtin ritëm ambicioz objektivash.

Projektbuxheti 2015 është projektbuxheti i reformave strukturore, për të përshpejtuar modelin e ri të zhvillimit të vendit, duke u përqendruar në disa nga sektorët më të rëndësishëm si: zhvillimi lokal dhe reforma administrative, energjia, bujqësia dhe reforma e ujit, inovacioni dhe shërbimet për qytetarët, rendi publik dhe siguria.

Në funksion të këtyre, projektbuxheti 2015 mundëson konsolidimin dhe thellimin e reformave të ndërmarra tashmë me buxhetin e vitit 2014, dhe në të njëjtën kohë siguron vazhdimësinë e mbajtjes së zotimeve të Programit të Qeverisë për periudhën 2013-2017. Në nivelin makroekonomik ky projektbuxhet bën të mundur:

- ✓ Mbajtjen e një niveli 5.4% të investimeve publike, duke u fokusuar në sektorin e ujit të pijshëm; energjisë; inovacionit dhe IT; turizmit dhe infrastrukturës rrugore qendrore e vendore;
- ✓ Vazhdimin e reformave strukturore në fushën e pensioneve, energjisë, ndarjes administrative dhe territoriale dhe tregut të punës;
- ✓ Vazhdimin e konsolidimit fiskal, me synimin që të përmbushet objektivi afatmesëm i uljes së borxhit publik nga rreth 71% e PBB në fund të vitit 2014, në 65.5% të PBB në 2017.

Më konkretisht, buxheti i vitit 2015 mbështet **reformat në sektorët kyç**, si më poshtë:

- **Zhvillimi Lokal do të mbështetet veçanërisht** në këtë buxhet nëpërmjet **Fondit të Zhvillimit të Rajoneve**, i provuar si një skemë financimi e suksesshme merr rëndësi akoma më të madhe në buxhetin e vitit 2015. Objektivat madhore të Qeverisë për zbatimin e ndarjes së re administrative-territoriale dhe për rilindjen e qyteteve e të qendrave të tjera zhvillimore, do të mbështeten fuqishëm nga skema e financimit të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve. Zgjerimi i kësaj skeme, bën që buxheti vendor të jetë më i madhi në historinë e tij.
- Në **Bujqësi**, do të përmirësohet efektiviteti i funksionimit të skemës së subvencionimit të fermerëve, si dhe do të përmirësohet infrastruktura e ujitjes dhe e kullimit , ndërsa për herë të parë Qeveria do të paraqesë një paketë të gjerë mbështetjeje për bujqësinë, agro-industrinë dhe peshkimin, me synim zgjerimin e aktivitetit ekonomik dhe këta sektorë dhe rritjen e eficiencës brenda tyre.

- Në **Transportin Rrugor**, gjatë vitit 2015 do të rritet ndjeshëm siguria rrugore, duke përmirësuar mirëmbajtjen dhe sinjalistikën rrugore.
- Në sektorin e **Ujësjellës - Kanalizimeve** do zgjerohet dhe përmirësohet aksesit i popullatës në furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizime, sidomos në zonën turistike të Durrësit, me zbatimin e një investimi të ri të rëndësishëm.
- Në drejtim të zhvillimit ekonomik, me anë të buxhetit 2015 do të vazhdojë reforma në klimën e biznesit, për të vazhduar lehtësimin e sipërmarrjes vendase, rritjen e prodhimit dhe punësimit në sektorët me potencial të lartë zhvillimi dhe uljen e hapave administrativë dhe proceduralë, reduktimin e afateve kohorë dhe të kostove për shërbimet ndaj biznesit.
- Për të mbështetur reformën e nisur në **sektorin e Energjisë** do të fillojë zbatimin një investim i madh prej 150 milionë USD, i cili do të përmirësojë infrastrukturën dhe ulë humbjet duke synuar uljen e humbjeve dhe kthimin e sektorit në një sektor fitimprurës brenda 5 viteve.
- Në fushën e **Inovacionit**, do të përmirësohen shërbimet e ofruara qytetarit dhe biznesit përmes projektit “Reforma e Shërbimeve në Administratën Publike”, mbështetur nga një kredi prej 35 milionë EUR nga Banka Botërore.
- **Nxitja e Punësimit**, do të përfshijë në programin e saj, për herë të parë këtë vit, fondin e “Punësimit dhe Aftësive” në masën 250 milionë LEK, i cili do të mbështesë punësimin dhe aftësimin e punëkërkuësve të orientuar drejt industrisë fasone.
- Në **Arsim**, do mbështetet përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në të gjitha nivelet, përmes përmirësimit të infrastrukturës, kurrikulave, teknologjisë dhe aftësive të arsimtarëve/pedagogëve.
- Në **Shëndetësi**, buxheti i vitit 2015 materializon fillimin e zbatimit të mbulimit dhe qasjes universale ndaj kujdesit shëndetësor.
- Sektori i **Turizmit**, gjatë vitit 2015, do të synojë krijimin e një modeli turizmi gjithë-vjetor e të integruar, me fokus në dimensionin kulturor-natyror-bregdetar, duke zhvilluar produkte turistike tërheqëse dhe konkurruese në destinacionet turistike.
- Në **Rendin dhe Sigurinë Publike**, do të rritet numri i punonjësve të policisë, referuar faktit se aktualisht numri i punonjësve të policisë për 1000 banorë është më i ulët se në gjithë vendet e rajonit, duke krijuar kështu edhe mundësinë për funksionimin e zyrave të pritjes së qytetarëve pranë çdo drejtorie policie qarku.

Relacioni i projektbuxhetit 2015 është organizuar si vijon:

- Në pjesën e parë jepet një përshkrim i situatës ekonomike dhe zhvillimeve fiskale gjatë vitit 2014 dhe parashikimet për periudhën afatmesme, si dhe objektivat kryesor të politikës fiskale në periudhën afatmesme.
- Në pjesën e dytë parashtrihen objektivat kryesore të buxhetit të vitit 2015 sipas sektorëve, duke filluar nga ata më prioritarë.
- Në pjesën e tretë paraqitet politika tatimore që do të ndiqet gjatë vitit 2015 (i) për zgjerimin e të ardhurave tatimore, dhe (ii) nxitjen e biznesit.
- Pjesa e katërt analizon disa nga rreziqet dhe problematikat që mund të hasen në zbatimin e buxhetit 2015, duke u përqendruar te realizimi në kohë i investimeve publike, shmangia e detyrimeve të reja të prapambetura, administrimi i të ardhurave tatimore dhe trajtimi i çështjeve gjyqësore e të pronësisë.
- Pjesa e fundit përshkruan masat për përmirësimin e menaxhimit të financave publike në periudhën afatmesme duke u përqendruar te përgatitja dhe zbatimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, përmirësimi i menaxhimit të financave publike, reforma e pensioneve, etj.
- Në shtojcat ilustruese jepen më shumë detaje të zhvillimeve dhe performancës makroekonomike, fiskale dhe buxhetore gjatë vitit 2014.

2. SITUATA EKONOMIKE NË SHQIPËRI

2.1 ZHVILLIMET KRYESORE MAKROEKONOMIKE GJATË VITIT 2014

Gjatë kësaj periudhe të vitit 2014 ekonomia ka hyrë në një fazë rimëkëmbjeje, krahasuar me vitin e shkuar, në përputhje me parashikimet. Tregues të ndryshëm dëshmojnë për një performancë pozitive të ekonomisë gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, si dhe pritshmërisë për gjysmën e dytë të tij. Parashikimi i rritjes reale vjetore të PBB rikonfirmohet në 2 për qind, në përputhje me parashikimet më të fundit të FMN.

Në tremujorin e parë, ekonomia përshpejtoi ritmin e saj të rritjes në 1.7% nga 1.4% që ishte vitin e kaluar. Ndërsa në tremujorin e dytë rezultoi një rritje të lehtë negative prej -0.6%, e cila i atribuohet në një masë të konsiderueshme asimetrisë (rritjes së ekzagjeruar) të shpenzimeve buxhetore në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Ndërkohë, treguesit e tjerë ekonomikë të disponueshëm deri më tani, tregojnë për një rigjallërim të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, e në veçanti, e ndjesisë së biznesit dhe konsumatorit. Përmirësimi i ndjesisë ekonomike të agjentëve vlerësohet të ketë nxitur një kërkesë të brendshme më të lartë, e cila ka qenë ushqyesi kryesor i ekonomisë gjatë kësaj pjese të vitit, duke kompensuar edhe kontributin lehtësisht negativ të kërkesës së huaj neto.

Indeksi i Tregtisë me Pakicë, i cili është një “tregues indirekt” për konsumin e mallrave, tregon një rigjallërim të konsumit. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2014 ky indeks u rrit me 5.7% në terma volumi krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të mëparshëm. Ndërsa në terma vlere ai shënoi një rritje prej 7.6%.

Vihen re shenja për një farë rigjallërimi edhe të investimeve private gjatë kësaj pjese të vitit. Kjo referuar ecurisë së importit të mallrave kapitale, makineri e pajisje dhe materiale ndërtimi, të cilat gjatë periudhës janar-gusht kanë patur një rritje respektivisht prej 8.3% dhe 9.3% krahasuar me një vit më parë.

Eksportet kanë vijuar të rriten me rreth 7% gjatë shtatë muajve të parë të vitit kundrejt një viti më parë, brenda të cilave spikasin produktet bujqësore, veshjet dhe këpucët. Ndërkohë importet totale janë rritur me rreth 7.9% gjatë kësaj periudhe, duke çuar në një zgjerim prej rreth 8.7% të deficitit tregtar. Nga ana tjetër importet e mallrave ushqimore, pijeve dhe duhanit kanë patur një rënie. Kjo rënie, e mbështetur dhe nga rritja e prodhimit bujqësor, si dhe rritja e eksporteve të kësaj kategorie, dëshmon për ecurinë e mirë të sektorit bujqësor dhe agropërpunimit në tërësi, ku përveç eksporteve më të larta, një pjesë e mallrave të importit gjithnjë e më tepër vijnë të zëvendësohen nga prodhimi vendas. Nga ana tjetër, ritmet e rritjes në sektorët ku ka patur politika mbështetëse nga qeveria tregojnë se ka potencial rritjeje të mëtejshme në disa nga sektorët të cilët deri tani kanë patur ecuri pozitive. Për këtë arsye do të ketë paketa specifike mbështetëse për disa sektorë të ekonomisë, duke veçuar këtu bujqësinë dhe turizmin, si sektorë me potencial të konsiderueshëm rritjeje.

Ndërkohë investimet publike kanë qenë ndjeshëm më të ulta se një vit më parë prej rreth 43% më pak, por stimuli i injektuar në ekonomi prej buxhetit është kompensuar ndjeshëm prej pagesave të detyrimeve të prapambetura. Deri në shtator të këtij viti janë paguar rreth 26 miliardë LEK detyrime të prapambetura të qeverisë ndaj biznesit, e cila ka ndikuar në përmirësimin e likuiditetit të sektorit privat në tërësi. Vlera e shpenzimeve kapitale dhe pagesave të detyrimeve të prapambetura të marra së bashku, që janë injektuar nga buxheti gjatë nëntë muajve të parë të 2014, rezulton rreth 5.6% më e lartë se vlera respektive e së njëjtës periudhë të një viti më parë. Megjithatë, në tërësinë e saj, kërkesa publike gjatë nëntë muajve të parë të vitit vlerësohet të ketë patur një efekt shtrëngues në rritjen ekonomike, e cila reflektohet prej përmirësimit me rreth 29 miliardë LEK të balancës primare¹. Balanca primare ka njohur një konsolidim të fortë gjatë këtij viti, e cila nga një deficit prej rreth 28.4 miliardë LEK gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2013, ka rezultuar me një tepriçë prej rreth 1 miliard LEK gjatë të njëjtës periudhë të këtij viti.

Sinjale pozitive kanë ardhur edhe prej tregut të punës, i cili në tremujorin e dytë të vitit regjistroi një rënie të normës së papunësisë në nivelin prej 17.7% nga 18.6% që kulmoi një tremujor më parë dhe një rritje të punësimit total.

Treguesit financiar gjithashtu kanë pasur një ecuri pozitive gjatë gjysmës së parë të vitit. Këtu do të veçohej kredia. Pas një viti me kontraktim, në korrik të këtij viti, rritja relative në përqindje kundrejt korrikut të një viti më parë kaloi në terren pozitiv prej 0.5%, e cila u pasua nga një tjetër rritje pozitive prej 2.2% në gusht. Në të njëjtën kohë, kjo ecuri e kreditimit në ekonomi është në linjë me raportimin nga sistemi bankar sa i takon lehtësimeve të kushteve të kreditimit dhe rritjes së kërkesës për kredi. Sistemi bankar mbetet mjaft solid, likuid dhe fitimprurës. Megjithatë, një prej pengesave për ecurinë e kreditimit mbeten kreditë me probleme, të cilat vijnë të mbeten në rreth 24% të totalit të stokut të kredive. Në këtë drejtim pritet të ketë një përmirësim gjatë vitit 2015 dhe në vijim, nisur nga ulja e financimit të borxhit afatshkurtër nga tregu i brendshëm dhe nga politikat e reja për thjeshtëzimin e procedurave.

¹ Balanca Primare llogaritet si: Të Ardhura Totale minus Shpenzime Totale, pa përfshirë shpenzimet për interesa të borxhit ose ndryshe, si Deficit i Përgjithshëm Fiskal plus Shpenzimet për Interesat e Borxhit.

Norma e inflacionit, e ndikuar edhe nga presionet e zbehta inflacioniste prej tregjeve të huaja, mbetet e ulët, poshtë kufirit të poshtëm prej 2% të targetuar nga Banka e Shqipërisë. Ndërkohë monedha vendase ka qëndruar përgjithësisht e stabilizuar kundrejt valutave të huaja kryesore.

Situata fiskale ka patur një përmirësim të ndjeshëm gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2014. Të ardhurat janë realizuar në përputhje me planin, dhe ndjeshëm mbi të ardhurat faktike të së njëjtës periudhë të vitit të kaluar, me një rritje prej rreth 13.2% më shumë. Ndërkohë që, deficitit është ulur ndjeshëm me rreth 48% më pak, i ndihmuar edhe nga kursimet në zërat e ndryshëm të shpenzimeve, gjë që pritet të çojë në një reduktim të borxhit publik krahasuar me nivelin që ishte planifikuar në fillim të vitit 2014.

2.2 PERSPEKTIVA AFATMESME

Në periudhën afatmesme, pritet që zgjerimi i aktivitetit ekonomik të vazhdojë të mbështetet nga zgjerimi i konsumit privat dhe investimeve, si dhe nga kërkesa e jashtme, ndonëse nga kjo e fundit më pak se parashikimet e mëparshme me dobësimin e rimëkëmbjes të Eurozonës. Kërkesa e brendshme do të mbështetet nga përmirësimi i konsumit, shlyerja e detyrimeve të prapambetura dhe kushtet më të lehta të financimit të ofruara nga sistemi bankar në tërësi.

Rritja ekonomike pritet të rimëkëmbet gradualisht në 3% në vitin 2015, e më pas të arrijë 4% në vitin 2016 dhe 4.5% në vitin 2017. Ndikim të rëndësishëm pritet të kenë disa faktorë të jashtëm (vazhdimi i rimëkëmbjes ekonomike të Eurozonës dhe veçanërisht në Greqi, pavarësisht ritmit më të ulët nga sa pritej), si dhe disa faktorë të brendshëm (rritja e IHD-ve, veçanërisht në energji, rritja e eksporteve, si dhe progresi i dukshëm në projekte investimesh të rëndësishme).

Niveli i lartë i borxhit publik mbetet rreziku kryesor për arritjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme. Qeveria është plotësisht e angazhuar për të trajtuar në mënyrën më adekuate situatën aktuale në mënyrë që të rivendosë borxhin publik në një trajektore rënëse duke filluar që prej vitit 2015. Në vitin 2017 pritet që niveli i borxhit publik të jetë rreth 65.5% e PBB. Ky objektivi i nivelit të borxhit pritet të arrihet duke marrë në konsideratë edhe impaktin fiskal, që pritet të ketë reforma e sektorit të energjisë përgjatë kësaj periudhe tre-vjeçare.

Faktorët kryesorë që do të mbështesin arritjen e objektivit të uljes së borxhit janë: (i) lufta e vijueshme dhe pa tolerancë ndaj evazionit fiskal; (ii) reformimi i mënyrës së përdorimit të fondeve publike me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të tyre; si dhe (iii) ndërmarrja e reformave të rëndësishme tatimore.

Rritja ekonomike në kushtet e konsolidimit fiskal pritet të mbështetet nga efektet pozitive të përmirësimit të klimës së biznesit, zgjerimit të hapësirës së kreditimit të ekonomisë nëpërmjet zëvendësimit të huamarrjes së qeverisë në tregun e brendshëm me financime nga tregjet ndërkombëtare, rritjes së investimeve publike (sidomos në sektorin e infrastrukturës), një kuadri akomodues të politikës monetare për periudhën afatmesme në vijim, si dhe zbutjes së rreziqeve të jashtme (rimëkëmbja ekonomike në Itali dhe Greqi, politika monetare akomoduese të BQE). Po kështu pritet një rritje e aktivitetit ekonomik në vend si pasojë e marrjes së statusit të vendit kandidat për në BE, si rrjedhojë e uljes së kërkesës nga ana e qeverisë për huamarrje në tregun e brendshëm, çka do të rrisë ofertën për sektorin privat, dhe si pasojë e

paketave mbështetëse në sektorë të ndryshëm të ekonomisë si: manufaktura, turizmi, bujqësia dhe sektorë të tjerë në rritje.

3. TREGUESIT KRYESOR TË BUXHETIT PËR VITIN 2015

3.1 TË ARDHURAT

Totali i të ardhurave buxhetore për vitin 2015 është parashikuar në nivelin rreth **414.4 miliardë LEK** ose rreth **27.8% e PBB**, me një rritje në terma nominalë prej 49.7 miliard LEK krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2014. Sipas zërave kryesorë të të ardhurave, tabloja paraqitet si vijon:

- **Të ardhurat tatimore** rriten me rreth 42 miliardë LEK, duke kapur nivelin 377.1 miliardë LEK ose 25.3% të PBB, nga 335 miliardë LEK ose 24% e PBB që ishin në buxhetin fillestar 2014. Nga këto:
 - Të ardhurat nga tatimet dhe doganat rriten me rreth 34.2 miliardë LEK, duke kapur nivelin 294.7 miliardë LEK, nga 260.5 miliardë LEK të buxhetit fillestar 2014. Kjo rritje i dedikohet kryesisht Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, i cili për vitin 2015 parashikohet në nivelin 135.3 miliardë LEK ose rreth 16.9 miliardë LEK më shumë se buxheti fillestar 2014.
 - Të ardhurat nga pushteti vendor parashikohen me një rritje në masën 2.9 miliardë LEK krahasuar me buxhetin fillestar 2014, duke kapur kështu nivelin 13.6 miliardë LEK ose 0.9% të PBB në vitin 2015. Kjo rritje i dedikohet kryesisht vjeljes së të ardhurave nga taksat vendore, të cilat për vitin 2015 paraqiten me një rritje në masën 2.1 miliardë LEK, duke kapur nivelin 8 miliardë LEK, nga 5.9 miliardë LEK në buxhetin fillestar 2014.
 - Të ardhurat nga fondet speciale, për vitin 2015 parashikohet të rriten në nivelin 68.8 miliardë LEK, nga 63.8 miliardë LEK në buxhetin fillestar 2014. Pra, me një rritje nominale prej rreth 5 miliardë LEK, e cila i dedikohet kryesisht rritjes së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore, të cilat parashikohen rreth 4.9 miliardë më shumë se në buxhetin fillestar 2014.
- **Të ardhurat jo-tatimore** për vitin 2015 parashikohen në nivelin 25.4 miliardë LEK, nga 21.2 miliardë LEK që ishte në buxhetin fillestar 2014. Ky zë paraqitet me një rritje në masën 4.2 miliardë LEK, e cila është kryesisht rezultante e:
 - Rritjes së të ardhurave nga institucionet buxhetore në masën 1.8 miliardë LEK;
 - Uljes së ndjeshme me rreth 1.4 miliardë LEK të zërit “Transferta e fitimit nga Banka e Shqipërisë”;
 - Rritjes së Dividentit që parashikohet të derdhet nga ndërmarrjet me kapital shtetëror në buxhetin e shtetit me rreth 211 milionë LEK më shumë;
 - Rritje e zërit “Të ardhura të tjera jo-tatimore”, si pasojë e rinovimit të frekuencës së akorduar për kompaninë AMC, si dhe shitja e frekuencave të reja për operatorë të telefonisë celulare.

Parashikimi në ulje i transfertës së fitimit nga Banka e Shqipërisë, argumentohet nga ky institucion me uljen e konsiderueshme të normave të interesit, si dhe me transferimin e parakohshëm të një pjese të fitimit të vitit 2014, në buxhetin e vitit 2014. Gjithsesi, mbetet shqetësues edhe parashikimi i vitit 2016 (37.2 milionë LEK) dhe i vitit 2017 (842 milionë LEK) për këtë zë nga Banka e Shqipërisë, parashikime të cilat janë nën nivelin e pritshëm të këtij zëri për këtë periudhë në

Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2015-2017, si dhe mbi 10 herë nën mesataren prej rreth 5.2 miliardë LEK të realizuar në periudhën 2011-2013.

3.2 SHPENZIMET

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2015 është planifikuar të arrijë **475 miliardë LEK** ose rreth **31.7% e PBB**. Bazuar në parashikimet afatmesme, shpenzimet totale buxhetore parashikohen të ulen në terma realë (30.6% e PBB në 2016 dhe 29% të PBB në 2017) duke reflektuar kështu objektivin e uljes së borxhit publik gjatë kësaj periudhe. Sidoqoftë, niveli total i investimeve publike i parashikuar për periudhën 2015-2017, reflekton një trend konstant përgjatë kësaj periudhe me një mesatare prej 5.3% të PBB. Ky fakt, konfirmon dhe një herë prioritetin e Qeverisë për të kontribuar aktivisht në rritjen ekonomike dhe rritjen e nivelit të punësimit në vend.

Karakteristikat kryesore të shpenzimeve korrente për buxhetin e vitit 2015 janë si më poshtë:

Shpenzimet e Personelit – Për vitin 2015 reforma e administratës publike do të fokusohet në rritjen e vazhdueshme të eficiencës dhe performancës së administratës qendrore, e cila do të arrihet nëpërmjet ristrukturimeve të institucioneve ekzistuese. Numri i punonjësve për vitin 2015 arrin në 87,700 punonjës, duke reflektuar kështu dhe shtesën prej 1200 punonjësish në sistemin e policisë së shtetit, në përputhje me prioritetet e Qeverisë. Fondi i shpenzimeve të personelit për vitin 2015, në terma realë, do të pësojë një ulje të lehtë nga 5.2 % të PBB (Akti Normativ i Buxhetit 2014) në 5.1 % të PBB në 2015.

Shpenzimet për interesa janë bazuar në fluksin e huamarrjes së brendshme dhe të huaj, si dhe në nivelin e parashikuar të normës së interesit. Për pasojë, shpenzimet për këtë zë parashikohen në nivelin 51.5 miliardë LEK ose 3.4 për qind të PBB, me një rritje në masën 5 miliardë LEK krahasuar me buxhetin fillestar 2014.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për qeverisjen qendrore për vitin 2015 *(pa përfshirë shpenzimet që realizohen nga institucione publike, që kanë si burim financimi të ardhurat jashtë limitit)*, janë parashikuar në masën 35 miliardë LEK ose rreth 2.3% për qind të PBB-së, nga 2.2% e PBB që ishin në buxhetin fillestar 2014. Në vlerësimin e këtyre shpenzimeve, janë marrë si bazë shpenzimet e buxhetit fillestar 2014, me një rritje prej rreth 12%. Në këtë zë është përfshirë gjithashtu edhe fondi prej 1.2 miliardë LEK, që do të shërbejë për pagesën e detyrimeve të Qeverisë shqiptare lidhur me shlyerjen e vendimeve gjyqësore të formës së prerë të dëmshpërblimit të pronarëve, nxjerrë nga Gjykata Ndërkombëtare e Strasburgut.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2015 janë parashikuar në masën 41.2 miliardë LEK ose 2.7% e PBB-së. Në këtë zë është përllogaritur rritja e transfertës së pakushtëzuar për njësitë vendore, së bashku me Fondin e Zhvillimit të Rajoneve në raport me vitin 2014 me rreth 28.6%, dhe është reflektuar rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore në masën 2.6 miliardë LEK, krahasuar me buxhetin fillestar 2014. Në buxhetin e vitit 2015, është vazhduar me përmirësime dhe rregullime në mënyrën e llogaritjes së transfertës së pakushtëzuar për çdo njësi të qeverisjes vendore. Disa nga elementet e ndryshuar dhe të rregulluar janë:

- Të dhënat për popullsinë janë marrë nga të dhënat e regjistrit të gjendjes civile. Të ardhurat nga biznesi i vogël dhe taksa e automjeteve të përdorura për efekt të kapacitetit fiskal janë llogaritur nga të dhënat faktike të vitit 2013.
- Niveli minimal për frymë, për vitin 2015 do të jetë:
 - për bashkitë, 2.960 LEK/frymë,
 - për komunat 2.000 LEK/frymë.
- Bashkitë Berat dhe Gjirokastrë, që bëjnë pjesë në UNESCO, janë trajtuar me një koeficient favorizues financimi.

Buxheti vendor i vitit 2015 është buxheti i tranzicionit nga ndarja aktuale administrativo-territoriale në implementimin e reformës së re administrativo-territoriale.

Shpenzimet e fondeve speciale. Këtu përfshihen shpenzimet totale për fondet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, të cilat kapin një vlerë prej 143.7 miliardë LEK. Niveli i shpenzimeve për *Skemën e Sigurimeve Shoqërore* për vitin 2015, parashikohet në masën 106 miliardë LEK ose 7.1% e PBB, me një rritje në masën 5.2 miliardë LEK krahasuar me buxhetin fillestar 2014. Për politikën e rritjes së pensioneve është parashikuar një fond prej 1.2 miliardë LEK, që mbulon rritjen e parashikuar të të gjitha pensioneve, në përputhje me reformën e re të këtij sektori, e cila starton zbatimin e saj në 1 janar 2015.

Ndërsa, shpenzimet e *Skemës së Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor* për vitin 2015 janë parashikuar në masën 35 miliardë LEK ose 2.3% e PBB, me një rritje në masën 2.1 miliardë LEK krahasuar me vitin 2014.

Së fundi, shpenzimet për *Fondin e Kompensimit në vlerë të ish-Pronarëve*, parashikohet në total në masën prej 1.4 miliardë LEK ose 0.1% e PBB, i njëjti nivel si në buxhetin fillestar 2014.

Shpenzime të tjera sociale. Këtu përfshihen fondet për pagesën e papunësisë, aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike dhe dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë.

- Shpenzimet për **pagesën e papunësisë** parashikohen në të njëjtin nivel sikurse dhe vitet e kaluara, në masën 1 miliardë LEK.
- Shpenzimet për pagesën e **ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar** parashikohen në nivelin 19.9 miliardë LEK. Ndërkohë që, gjatë vitit 2015 e gjithë skema e ndihmës ekonomike dhe e pagesës së paaftësisë do t'i nënshtrohet një procesi rrënjësor rivlerësimi, duke rishikuar si procedurat e përfitimit të një statusi të tillë, ashtu edhe instrumentet dhe mekanizmat e kontrollit dhe monitorimit të saj, me qëllim eliminimin e abuzivitetit në skemë dhe uljen e barrës financiare në buxhetin e shtetit.
- **Për ish-të përndjekurit** është parashikuar një fond prej 2 miliardë LEK ose 0.1% e PBB, me një rritje në masën 200 milionë LEK krahasuar me buxhetin fillestar 2014.
- Së fundi, është parashikuar edhe fondi prej 1.6 miliardë LEK, **si kompensim për shtresat në nevojë**, në mbështetje të politikave të reja në sektorin e energjisë. Ky fond paraqitet me një rritje në masën 500 milionë LEK krahasuar me vitin 2014.

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar në masën 1.76 miliardë LEK, kryesisht për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të veprimtarisë hekurudhore dhe atë të ujësjellësave, subvencionimin e librit për një kategori të caktuar të nxënësve, veprimtarinë e shërbimeve qeveritare, etj. Njëkohësisht, për herë të parë në

vitin 2015, në buxhetin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në këtë zë, përfshihet edhe fondi në mbështetje të industrisë Fasone, për rrjedhojë zëri subvencione në totalin e vet paraqet një rritje në masën 160 milionë LEK, krahasuar me vitin 2014.

Niveli i fondit rezervë të Këshillit të Ministrave dhe Kontigjencës për ruajtjen e deficitit për vitin 2015, parashikohet të jetë në masën 5.5 miliardë LEK, përkatësisht 1.5 miliardë fond rezervë i Këshillit të Ministrave dhe 4 miliardë lekë fond kontigjence për ruajtjen e deficitit. Krahasuar me vitin 2014, ai paraqet një rritje në masën 1 miliard LEK. Për sa i përket fondit kontigjencë për ruajtjen e deficitit, propozojmë që shpërndarja e tij të bëhet me vendim të Kuvendit dhe jo të Këshillit të Ministrave, me qëllim monitorimin optimal të çdo lloj ndryshimi eventual të nivelit të deficitit të brendshëm dhe borxhit publik.

Detyrimet e prapambetura. Për vitin 2015, ky fond parashikohet në masën 20 miliardë LEK, nga 35 miliardë LEK që ishte në planin fillestar 2014. Ky nivel është përcaktuar në dakordësi me Fondin Monetar Ndërkombëtar

Investimet Publike. Për vitin 2015 investimet publike janë planifikuar 5.4% e Produktit të Brendshëm Bruto ose 80 miliardë LEK (*duke përfshirë këtu dhe Fondin e Zhvillimit Rajonal prej 12.5 miliardë LEK*). Për vitin 2015 është parashikuar rritje e mëtejshme e financimit të Fondit të Zhvillimit Rajonal dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit me synimin e uljes së diferencave në zhvillim mes rajoneve (qarqeve) të ndryshme të vendit. Kjo përbën një risi dhe një instrument për realizimin e politikave të Qeverisë për orientimin e investimeve dhe të shërbimeve publike tek qytetarët dhe në funksion të përmirësimit të kushteve të jetesës së tyre. Në planifikimin e investimeve për vitin 2015 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm të trashëguara nga viti 2013 dhe më parë. Ashtu si në 2014, do të ketë përparësi shmangia e detyrimeve të reja dhe mbartja e tyre në vitet e ardhshme, si dhe minimizimi i detyrimeve kontraktuale për projektet në proces zbatimi, duke u fokusuar me përparësi në financimin e projekteve në vazhdim. Për planifikimin e investimeve janë ndjekur kriteret e mëposhtme:

- *Prioritetet e integritit europian;*
- *Prioritetet e Programit të Qeverisë për periudhën 2013 – 2017;*
- *Mbështetja me kosto lokale dhe TVSH për projektet me financim të huaj;*
- *Projektet në vazhdim.*

Në programin e investimeve për vitin 2015 është rritur ndjeshëm pesha e investimeve për sektorët social, të cilat ofrojnë shërbime drejtpërdrejt të lidhura me nevojat e qytetarëve: në veçanti për sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe të mirëqenies sociale. Në funksion të modernizimit të shërbimeve të administratës publike janë rritur ndjeshëm investimet për teknologjinë dhe informacionin, si dhe transparencën e shërbimeve të ofruara nga qeveria. Për këtë është propozuar një program i ri për projektet e Ministrisë të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike. Për sa i takon shpërndarjes së investimeve sipas ministrive të linjës / sektorëve:

- *Edhe në buxhetin e vitit 2015, peshën kryesore të investimeve gjithsej e zë Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës me rreth 58,3 % të investimeve gjithsej. Investimet për MTI për vitin 2015 janë parashikuar 39,300 milionë LEK, kundrejt 35,136 milionë LEK në vitin 2014, me një rritje neto prej 11,85 %. Rritja e investimeve brenda këtij grup-sektori është bërë me përparësi për sektorin e*

furnizimit me ujë, që përbën edhe një nga prioritetet kryesore të programit të qeverisë për periudhën 2013-2017. Gjatë vitit 2015 do të vazhdojë financimi i projekteve në vazhdim me qëllim reduktimin e mëtejshëm të detyrimeve kontraktuale nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve publike në fushën e furnizimit me ujë të popullsisë.

- Për Ministrinë e Bujqësisë, që përbën një sektor të lidhur drejtpërdrejt me prioritetet e programit të Qeverisë, investimet për vitin 2015 janë parashikuar në vlerën 3,425 milionë LEK, kundrejt 3,185 milionë LEK të financuara në vitin 2014, me një rritje prej 7,53 %. Sipas burimit të financimit, investimet me financim të brendshëm janë parashikuar në vlerën 1,424 milionë LEK, kundrejt 925,1 milionë LEK të financuara në vitin 2014, me një rritje prej 54 % kundrejt vitit 2014.
- Për Ministrinë e Mirëqenies Sociale, për vitin 2015 është bërë ristrukturimi i burimeve të financimit. Investimet me financim të brendshëm janë parashikuar të financohen në vlerën 410 milionë LEK, kundrejt 242,6 milionë LEK të financuara në vitin 2014, me një rritje prej rreth 69 % kundrejt vitit 2014.
- Për vitin 2015 është parashikuar rritje e mëtejshme e financimeve për Fondin e Zhvillimit Rajonal dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit me synimin e reduktimit të diferencave në zhvillim mes rajoneve (qarqeve) të ndryshme të vendit. Kjo përbën një risi dhe një instrument për realizimin e politikave të Qeverisë për orientimin e investimeve dhe të shërbimeve publike tek qytetarët dhe në funksion të përmirësimit të kushteve të jetesës së tyre. Financimi i FZHR është parashikuar në masën 12,500 milionë LEK.

3.3 DEFICITI BUXHETOR DHE BORXHI PUBLIK

Deficiti buxhetor për vitin 2015 parashikohet të ulet në nivelin 4.0% të PBB nga 6.6% e PBB që ishte planifikuar në buxhetin 2014. Financimi i tij do të realizohet kryesisht nëpërmjet huamarrjes së brendshme me rreth 2.9% të PBB. Për rrjedhojë, niveli i Borxhit Publik në fund të vitit 2015 parashikohet të ulet në nivelin 70.6% të PBB, krahasuar me nivelin e pritshëm të tij për vitin 2014 prej 71% të PBB.

3.4 BUXHETI VENDOR 2015

Viti 2015 shënon një tjetër moment historik të decentralizimit dhe të autonomisë së pushtetit vendor. Zgjedhjet vendore të vitit 2015, shënojnë fillimin e qeverisjes vendore sipas ndarjes së re administrative-territoriale, e cila synon të përmirësojë të gjithë ato aspekte të decentralizimit që gjatë dhjetë-vjeçarit të fundit kanë rezultuar problematike dhe që kanë fragmentuar burimet financiare për shërbime dhe punë publike. Reforma e re territoriale do t'i kursejë buxhetit vendor rreth 6 miliardë LEK shpenzime administrative, të cilat do të shkojnë për shërbime dhe investime publike në favor të komuniteteve. Gjithashtu ndarja e re administrative-territoriale, do të pasohet nga një reformë tjetër e decentralizimit fiskal. Me këto reforma synohet: (i) demokratizimi i qeverisjes; (ii) eficienta në ofrimin e shërbimeve për qytetarët; (iii) zhvillimi ekonomik lokal, si dhe (iv) zhdukja e pabarazive dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Në terma të tjerë, me krijimin e njësisive më të mëdha vendore, do të ofrohen shërbime në mënyrë më eficiente, do të sigurohet një përdorim më i mirë i burimeve financiare dhe një përfaqësim më i mirë i qytetarit në vendimmarrje. Me këtë reformë, eliminohet problemi madhor i fragmentizimit tepër të lartë të vendit, gjë që nuk reflektonte lëvizjet demografike të dy dekadave të fundit, por gjithashtu

gjeneronte edhe pabarazi të larta mes komunave/bashkive për sa u përket kapaciteteve lokale, aftësisë për mobilizimin e të ardhurave, si edhe ofrimit të shërbimeve.

Buxheti i vitit 2015 garanton kalimin efektiv dhe eficient të kompetencave, përgjegjësi dhe të gjitha problematikave vendore nga të zgjedhurit aktual tek të zgjedhurit e rinj, sipas ndarjes së re territoriale. Në një aneks të veçantë të ligjit të buxhetit të vitit 2015 janë paracaktuar masat e nevojshme, rolet dhe detyrat përkatëse për periudhën tranzitore. Gjithashtu në këtë aneks janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e organeve të qeverisjes vendore të zgjedhura në vitin 2011 dhe organeve të qeverisjes vendore që do të zgjidhen në vitin 2015. Gjithashtu, janë bërë disa përmirësime të tjera cilësore në formulën ndarjes së transfertës së pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore. Janë vendosur kritere dhe tavane që garantojnë funksionimin normal të të gjitha njësive të qeverisjes vendore. Në vitin 2015, me ndryshimin e ligjit për taksat kombëtare, të ardhurat nga renta minerare do t'i akordohen në mënyrë të drejtpërdrejt njësive të qeverisjes vendore. Nga eksperiencia e deritanishme, shuma bazë e transfertës së pakushtëzuar në përgjithësi ka ndjekur rritjen e buxhetit të përgjithshëm. Në vitin 2015, konstatohet një ndryshim në lidhje me transfertën e pakushtëzuar të qeverisjes vendore, e cila kushtëzohet nga disa elementë shtesë si:

- *reforma territoriale dhe periudha e tranzicionit deri në hyrjen në fuqi të ndarjes së re administrative,*
- *politikat e kufizimit të shpenzimeve të ndjekura nga qeveria në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar.*

Gjithsesi, pavarësisht elementëve të sipërcituar, në përcaktimin e madhësisë së transfertës, janë marrë në konsideratë: funksionet transferuar te njësitë e qeverisjes vendore, fondet respektive për to, si dhe rregullimet specifike mbi bazë vjetore, bazuar në transferimin e taksave. Specifikisht për vitin 2015, transfertat e pakushtëzuar do të vazhdojnë të ndahet në 373 NJQV, sipas kriterëve të mësipërme, por duke rifreskuar të dhënat për popullsinë, kapacitetet fiskale dhe tregues të tjerë të varfërisë. Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore parashikohet të jenë rreth 18.5 për qind më të larta se ato të vitit 2014 ose 2.6 miliardë LEK më shumë se një vit më parë.

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, i provuar si një skemë financimi e suksesshme merr rëndësi akoma më të madhe në buxhetin e vitit 2015. Objektivat madhore të qeverisë për zbatimin e ndarjes administrative-territoriale dhe për rilindjen e qyteteve dhe të qendrave të tjera zhvillimore, gjejnë mbështetjen e plotë në skemën e financimit të investimeve nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve. Rritja e konsiderueshme e fondit në këtë skemë bën që buxheti vendor të jetë më i madhi në historinë e tij.

Buxheti vendor i vitit 2015, me tërë komponentët e tij (transfertë e pakushtëzuar, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, renta minerare dhe të ardhurat e veta) është 24.4 për qind më i lartë, si ai i vitit 2014, ndërkohë që shpenzimet e buxhetit të shtetit janë rritur vetëm 4%. Kjo rritje e buxhetit vendor me 20.4% më shumë se sa buxheti i shtetit, tregon rëndësinë që ka miratimi dhe zbatimi i reformës administrativo-territoriale.

Objektivat kryesor për vitin 2015:

- Sigurimi i një tranzicioni efektiv i kalimit të kompetencave, burimeve materiale dhe monetare, nga njësitë sipas ndarjes së vjetër administrative, në njësitë vendore që do jenë sipas ndarjes së re administrativo-territoriale. Për sigurimin e këtij tranzicioni do të miratohen aktet e nevojshme

nënligjore për zbatimin e buxhetit, inventarizimin dhe transferimin e aseteve në njësitë e reja, kalimin e arkivave dhe dokumentacionit të njësitë e reja, integrimin e bilanceve kontabël, etj;

- Rishikimin e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore. Nëpërmjet rishikimit të formulës synohet që mekanizmi i shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar të përshtatet dhe të jetë në funksion të reformës administrativo-territoriale;
- Konsolidimi dhe rritja e të ardhurave vendore për garantimin e qëndrueshmërisë së reformës së decentralizimit;
- Reforma e decentralizimit fiskal do të përqendrohet në saktësimin e marrëdhënieve fiskale midis pushtetit qendror dhe atij vendor. Kjo do të realizohet nëpërmjet hartimit dhe miratimit të projektligjit për financat vendore, i cili do të përcaktojë:
 - *procedurën e hartimit dhe zbatimit të buxhetit vendor,*
 - *skemën e financimit të transfertës së pakushtëzuar për pushtetin vendor,*
 - *rregullat dhe procedurat e kontabilitetit, auditit të brendshëm dhe të jashtëm,*
 - *instrumentet e nevojshme për shtimin e transparencës dhe llogaridhënies, etj.;*
- Nëpërmjet kritereve të ndarjes së Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, do të nxitet zhvillimi i qëndrueshëm në nivel vendor;
- Nëpërmjet përdorimit të mekanizmave financiare për shpërndarjen e subvencioneve, do ndikohet në rritjen e performancës së menaxhimit të shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve në varësi të njërive të qeverisjes vendore;
- Do të vazhdohet bashkëpunimi i ngushtë me donatorët që asistojnë pushtetin vendor në drejtim të decentralizimit fiskal dhe modernizimit të financave vendore. Nëpërmjet përdorimit të mekanizmave financiare për shpërndarjen e subvencioneve, do ndikohet në rritjen e performancës së menaxhimit të shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve në varësi të njërive të qeverisjes vendore;
- Do të vazhdohet bashkëpunimi i ngushtë me donatorët që asistojnë pushtetin vendor në drejtim të decentralizimit fiskal dhe modernizimit të financave vendore.

4. POLITIKAT SEKTORIALE

ARSIMI:

Buxheti i vitit 2015 synon përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në të gjitha nivelet, përmes përmirësimit të infrastrukturës, kurrikulave, teknologjisë dhe aftësive të arsimtarëve/pedagogëve.

- *Arsimi Parauniversitar (përfshirë atë parashkollor)*
 - Viti 2015 do të jetë viti i përmirësimit të niveleve arsimore të sistemit parauniversitar (parashkollor, 9-vjeçar, i mesëm dhe i lartë), si edhe të kushteve të shkollimit dhe standardeve të të nxënies, për rreth 356.286 nxënës të arsimit bazë dhe 134.644 të arsimit të mesëm. Njëkohësisht:
 - ✓ *Për nivelin e arsimit parashkollor, do të hartohen dhe do të pilotohen standardet e zhvillimit dhe të nxënies për moshat përkatëse (3-6 vjeç) dhe, mbi këtë bazë, do të*

hartohet kurrikula e re e arsimit parashkollor (planet, programet, mjetet didaktike gjegjëse etj.) në shërbim të rreth 72.910 fëmijëve.

- ✓ *Për tri nivelet e arsimit parauniversitar, do të hartohet kurrikula e re dhe do vijojë pilotimi i saj në vitet II, VII dhe X.*
- ✓ *Me përparësi do të adresohen problemet e teksteve të reja shkollore (kuadri rregullator, procedurat e reja të botimit, etj.).*
- ✓ *Me përparësi do të trajtohet infrastruktura shkollore. Në këtë aspekt, do të financohen 63 objekte arsimore dhe 46 terrene sportive, duke synuar reduktimin e mësimit me turne dhe uljen e numrit të nxënësve në klasë (30 nxënës/klasë) dhe intensifikimin e procesit të kthimit të shkollave në qendra komunitare.*
- ✓ *Përmirësimet në infrastrukturë përfshijnë pajisjet, bazën e nevojshme materiale dhe mjetet didaktike, shtimin e kabineteve dhe laboratorëve shkencorë, ofrimin e shërbimit të internetit në 1350 shkolla, zbatimin e platformës e-learning, në kuadër të sigurimit të kredisë me terma të butë nga Qeveria Austriake, si dhe do të zbatohet projekti i pajisjes me tableta të nxënësve të kl. X-XI-XII të arsimit të mesëm të përgjithshëm mundësuar nga buxheti.*
- ✓ *Shtresat sociale në nevojë dhe kategoritë e veçanta do të mbështeten edhe me shërbimin e transportit falas për rreth 30.000 nxënës dhe 11.000 mësues.*
- ✓ *Do të rimbursohen shpenzimet e blerjes së teksteve shkollore për rreth 120 mijë nxënës, do të pajisjen me tekste falas fëmijët e minoritetit dhe ata të diasporës, si dhe do të trajtohen me bursa 3500 nxënës përfshirë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara dhe nxënësit që vijnë nga familjet në nevojë.*

- **Arsimi i Lartë**

- Në vitin 2015, do të vijojë reforma e nisur në këtë sektor, duke përmirësuar kuadrin ligjor dhe atë rregullator;
- Do të reformohet skema e financimit të IAL-ve publike dhe kredisë studentore, skemë që do të zbatohet nga një Agjenci e posaçme;
- Do të mbështetet me fonde buxhetore përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës së IAL-ve publike;
- Fokus të posaçëm do të ketë përmirësimi i cilësisë së IAL-ve, duke vijuar monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë së tyre, si dhe duke forcuar kontrollin për përmbushjen e standardeve të akreditimit të tyre. Do të trajtohen me bursa rreth 8000 studentë.

Njëkohësisht, synim do të jetë edhe:

- Akreditimi institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe kontraktimi i një agjencie të huaj për këtë qëllim;
- Rritja e kapaciteteve në staf dhe infrastrukturë të IAL, si dhe i nevojave të tregut të punës, rritjen e numrit të pedagogëve me 800, rritjen e numrit të laboratorëve shkencorë dhe/ose përmirësimin dhe zgjerimin e tyre, përmirësim i infrastrukturës ekzistuese të IAL dhe ngritja e godinave të reja, rritja e aksesit në bibliotekat dhe revistat on-line dhe krijimi i një rrjeti bibliotekash shkencore, si dhe hartimi i nevojave reale për këto komponentë;

- Përgatitja e regjistrit elektronik kombëtar të diplomave universitare në bashkëpunim me RASH për të rritur transparencën dhe ulur korrupsionin, si dhe i një Data Baze kombëtare për regjistrin e studentëve, të dhënat e karrierës akademike, diplomimit, provimet e shtetit, të dhënat e stafit akademik, etj.;
- Realizimi i politikave të përfshirjes sociale dhe aksesit të gjerë në arsimin e lartë nëpërmjet skemës së kredithënies studentore dhe mbështetjes financiare për përmirësimin e kushteve në shtëpitë e studentëve, heqjen e barrierave arkitektonike në IAL, përfshirjen e kategorive të tjera të veçanta në kuotat e parashikuara për këto kategori.
- *Kërkimi shkencor*
 - Do të mbështetet pjesëmarrja e Shqipërisë në programin “Horizon 2020” dhe “Erasmus+”, me një kontribut vjetor prej rreth 1.1 milionë EUR, duke siguruar mbështetjen e kërkuesve shqiptarë në këto projekte të rëndësishme kërkimore-shkencore.
 - Do të mbështeten financiarisht studentët ekselentë që studiojnë në 15 universitetet më të mira, referuar renditjes së “Times Higher Education”.
 - Do të mbështeten punonjësit e administratës publike, të përfitojnë trajnime/kualifikime apo studime të ciklit të dytë dhe tretë në 300 universitetet më të mira të botës.
 - Do të reformohet Agjencia e Kërkimit Shkencor, në përputhje me kuadrin e ri rregullator dhe ligjor të IAL-ve.
- *Zhvillimi i Sportit*
 - Në vitin 2015, do të mbështeten me grand buxhetor Federatat Sportive Olimpikë, duke synuar kualifikimin e sportistëve tanë në Lojërat Olimpikë “Rio 2016”, si viti i kualifikimeve për pjesëmarrjen në Olimpiadë.
 - Do të përmirësohet infrastruktura sportive, duke financuar projektin “Tirana Olimpik Park”, i cili do të mundësojë krijimin e mjediseve të përshtatshme dhe cilësore për ushtrimin e sporteve, veçanërisht për sportet e peshëngritjes, mundjes, artet marciale, lojërat me dorë, duke i shndërruar mjediset e agjencisë ekzistuese të sportit në Qendër Kombëtare Shumëfunktionale.

SHËNDETËSIA:

Buxheti i vitit 2015 për këtë sektor, materializon fillimin e zbatimit të mbulimit dhe qasjes universale ndaj kujdesit shëndetësor. Më konkretisht:

- **Kujdesi parësor** – Viti 2015 do të jetë viti i zbatimit të plotë të kontrollit shëndetësor bazë pa pagesë për shqiptarët rezidentë të grupmoshës 40-65 vjeç. Ky është hapi i parë konkret drejt vendosjes së mbulimit universal. Tashmë është miratuar protokollin mjekësor i programit bazë, janë hartuar kurrikulat e trajnimit, ka filluar trajnimi i personeli shëndetësor dhe është përzgjedhur kontraktori, që për një periudhë 10-vjeçare do të mbështesë aspektet logjistike dhe të këmbimit të informacionit të këtij programi. Tarifa e kontraktuar individuale e kontrollit bazë është 1,536 LEK (+TVSH). Programi do të realizohet në të gjitha qendrat shëndetësore parësore, si dhe do të mbështetet nga 5 njësi të lëvizshme për të mbuluar plotësisht edhe zonat më të largëta të vendit, si dhe zonat ku në periudhën e dimrit vështirësohet transporti. Ky program shënon hapin e parë konkret drejt parandalimit dhe diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve kryesore që shtojnë

invaliditetet, shkurtojnë vitet e shëndetshme dhe prodhojnë humbje jetësh njerëzore të parakohshme. Në këtë mënyrë, orientojmë qendrën e sistemit të kujdesit shëndetësor në vend nga mënyra tradicionale e fokusuar tek sëmundja, drejt fokusimit tek shëndeti. Zbatimi i kontrollit bazë shëndetësor pa pagesë është një hap konkret drejt reduktimit të barrierave financiare, gjeografike dhe kulturore që kanë hasur shqiptarët tradicionalisht në qasjen ndaj kujdesit shëndetësor parësor. Fondi i barnave të rimbursueshme ka një rritje me rreth 500 milionë LEK në krahasim me vitin 2014. Gjetjet e zbatimit të projektit pilot të recetës elektronike në rrethin e Durrësit, të realizuar në vitin 2014 janë një bazë e shëndetshme për të filluar zbatimin në të gjithë vendin në periudhën 2015-2016.

- **Kujdesi spitalor** - Sistemi spitalor do të fuqizohet dhe optimizohet në kapacitete diagnostikuese dhe kuruese. Eksperienca pozitive e vitit 2014 në furnizimin e vijueshëm me barna, materiale mjekësore dhe kite e reagent, do të konsolidohet dhe zgjerohet. Funksionimi i përditshëm i pajisjeve bio-mjekësore do të garantohet me kontrata afatgjata e me mbulim të plotë të riskut të mirëmbajtjes, që tashmë janë realizuar. Do të fillojë të ofrohen edhe në spitalet rajonale ato shërbime që tradicionalisht janë ofruar vetëm në spitale universitare, përfshirë shërbimin e kimioterapisë, shërbimin e koronarografisë dhe shërbimin paliativ. Në shërbimin e kirurgjisë në të gjitha spitalet e vendit do të përmirësohet ndjeshëm inventari i instrumenteve kirurgjikale dhe do të ofrohet një nivel shumë i lartë sterilizimi. Do të zgjerohet dhe konsolidohet bashkëpunimi me institucionet shëndetësore jo-publike. Paketat e shërbimeve të kujdesit spitalor janë kontraktuar dhe buxheti 2015 mbulon financimin e tyre. FSDKSH ka tashmë bazën ligjore të kontraktosë edhe me dhënës shërbimesh jashtë vendit në ato raste kur institucionet vendase nuk i ofrojnë paketat që janë përcaktuar. Në buxhetin e kujdesit spitalor do të përfshihet edhe mbulimi i shpenzimeve të kryera jashtë vendit për raste të veçanta, të cilat deri më sot janë paguar nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Miratimi për rastet e veçanta do të bëhet nominalisht nga Këshilli i Ministrave. Ndërkohë që, do të rritet ndjeshëm cilësia e kujdesit në shërbimin spitalor, përmes investimeve kapitale, si vijon:
 - *17 milionë EUR, nga kredia e Bankës së Këshillit të Europës për shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme dhe spitalin e sëmundjeve të brendshme në QSUT;*
 - *14 milionë EUR nga kredia austriake për shëndetësinë elektronike; dhe*
 - *5 milionë EUR nga kredia e Qeverisë italiane për spitalin universitar të traumës.*
- **Shëndeti Publik** - Shëndeti publik është një program që do të marrë vëmendje të veçantë. Gjatë vitit 2015 do të financohet në mënyrë të plotë programi i dezinfektimit të mushkonjave. Eksperienca e vitit 2014 shërben si bazë e mirë për të ofruar një program të shtrirë në të gjithë vitin dhe me një mbulim shumë më të mirë të territorit. Mbrojtja e shëndetit nga efektet e dëmshme të duhanpirjes, alkoolit dhe obezitetit do të jenë në fokus të promocionit shëndetësor. Inspektoriati Shëndetësor Shtetëror do të veprojë në mënyrë të plotë në të gjithë territorin e vendit. Do të forcohen kapacitetet laboratorike për përballimin e kërcënimeve të ndryshme epidemiologjike. Do të rriten kapacitetet institucionale të Agjencisë së sapokrijuar të Barnave dhe Materialeve Mjekësore,

me qëllim rritjen e garancisë së barnave që qarkullojnë në vend, si dhe fillimin e vendosjes në treg në mënyrë të kontrolluar të materiale dhe pajisjeve mjekësore.

- **Urgjenca Mjekësore** - Në vitin 2015, buxheti i shëndetësisë është pasuruar me një program të ri buxhetor, atë të “Urgjencës mjekësore”. Ligji përkatës është miratuar dhe ka filluar përfitimi i asistencës teknike të huaj për të ndërtuar modelin e vendosjes në territor, sistemin e komunikimit dhe funksionin e qendrës së komandës dhe kontrollit. Në vitin 2015 do të ngrihet institucioni i Shërbimit të Urgjencës Mjekësore, do të hartohen protokollat mjekësore, do të hartohen kurrikulat e trajnimit dhe do të fillojë procesi i trajnimit të infermierëve që do të jenë pjesë e këtij shërbimi. Do të vijojë fuqizimi i flotës së autoambulancave dhe do të realizohet një menaxhim i plotë i gatishmërisë së përditshme të automjeteve dhe pajisjeve mjekësore të autoambulancave. Në mbështetje të mirëfunksionimit dhe mbarëvajtjes së sezonit turistik do të funksionojnë edhe rreth 15 qendra shëndetësore të përkohshme në periudhën maj-shtator, përgjatë gjithë vijës bregdetare, si dhe në disa qendra turistike brenda vendit që kanë numër të lartë vizitorësh.

Rritja e fondeve për barna e materiale mjekësore për përdorim spitalor, rritja e fondeve për barnat e rimbursueshme, afrimi i kujdesit sa më pranë vendbanimeve, funksionimi i vijueshëm i pajisjeve bio-mjekësore, fuqizimi i kapaciteteve të urgjencës mjekësore, përdorimi e gjerë i shëndetësisë elektronike do të ndihmojnë edhe në ngushtimin e hapësirave për dukuri korruptive.

BUJQËSIA:

Buxheti i vitit 2015 do të synojë zgjerimin dhe përmirësimin e efektivitetit të skemave të mbështetjes së fermerëve, përmirësimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, si edhe formalizimi i sektorit të peshkimit. Më konkretisht synohet:

- Rajonizimi i prodhimit bujqësor dhe blegtoral mbi bazën e potencialeve specifike sipas rajoneve, duke sjellë për pasojë rritjen e efektivitetit të mbështetjes financiare.
 - *Do të mbështeten financiarisht afërsisht 10,800 fermerë me skema financimi që synojnë nxitjen e prodhimit bujqësor e blegtoral vendas, si dhe lehtësimin e daljes në treg (kostoja totale 1.9 miliardë LEK).*
- Stimulimi i përdorimit të teknologjive të zhvilluara dhe inovacionit në sektor.
 - *Rritja e konkurrueshmërisë të prodhimit dhe agro-përpunimit në vend.*
- Zbatimi rigoroz i legjislacionit në fuqi, si dhe i detyrimeve që rrjedhin nga PKZMSA për fushën e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
- Krijimi i kushteve favorizuese për rritjen e sigurisë ushqimore dhe rritjen e standardeve të tregtimit në sektorin e peshkimit.
- Heqja e barrierave tarifore për inputet bujqësore dhe lëndët e para të prodhimit bujqësor dhe industrial.
- Rregullimi i TVSH-së për uljen e kostos së produkteve bujqësore.
- Ulja e barrës financiare për importin e makinerive bujqësore dhe kafshëve për mbarështim.

Po kështu një efekt domethënës në zgjerim të aktivitetit ekonomik brenda këtij sektori pritet të ketë edhe paketa e bujqësisë, e cila do të ndihmojë ndjeshëm si në rritjen e eficiencës brenda sektorit ashtu

edhe në lehtësira në disa nga nyjet kyçe të rritjes në industrinë agropërpunuese, në peshkim, tek lëndët e para dhe në rritjen e mekanizimit të sektorit. Për pasojë, kjo paketë do të ketë një efekt formalizimi brenda sektorit të bujqësisë, duke ju mundësuar më shumë operatorëve të vegjël që të jenë konkurrues me produktet e prodhuara në vend, si pasojë e lehtësimit të procedurave për tregtimin dhe kreditimin e TVSH të mallrave nga prodhuesit e vegjël tek grumbulluesit. Efekti i pritshëm do të jetë rritja e prodhimit vendas me kosto më të ulëta, për të plotësuar një pjesë të kërkesës në treg, e cila deri tani mbulohet me importe.

ENERGJIA:

Sektori i Energjisë, gjatë vitit 2015 do t'i nënshtrohet një reformimi të plotë, me synim përmirësimin e eficiencës dhe efektivitetit të sektorit.

- Për këtë qëllim në buxhetin 2015 janë parashikuar si shpenzime buxhetore pjesa prej 3 miliardë LEK nga mbështetja financiare prej 150 milionë USD e Bankës Botërore, e cila synon kryesisht për investime në rrjet, sisteme matjeje, sisteme menaxhimi, matje në distancë, suporti për fillimin e liberalizimit të tregut, për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, etj.
- Gjithashtu, është parashikuar edhe një fond prej 1.6 miliardë LEK, si masë kompensuese e plotë për shtresat në nevojë, nga heqja e fashës 300 kw të konsumit të energjisë.
- Duke përfshirë edhe garancitë që mund të lëshohen gjatë vitit 2015 për huamarrjet e sektorit, mbështetja buxhetore për energjinë shkon në rreth 20 miliardë LEK.

Me këtë mbështetje në buxhetin 2015 do të vazhdojë reforma e thellë e sektorit të energjisë që ka nisur në vitin 2014, në funksion të rritjes së eficiencës së sektorit në tërësi, duke ulur humbjet jo teknike dhe vjedhjen e energjisë elektrike, duke rritur faturimin dhe mbledhjen e të ardhurave në shpërndarje dhe duke stabilizuar bilancet e të tre kompanive shtetërore në sektorin e energjisë elektrike. Të tre kompanitë do të reformohen nga ana administrative dhe operacionale, për t'u shndërruar në operatorë tregu dhe jo në institucione buxhetore, në mënyrë që të rritet eficientia dhe të ulet varësia nga instrumentat dhe garancitë buxhetore. Impakt pozitiv do të ketë edhe ulja e vjedhjes së energjisë elektrike, e cila do të rrisë arkëtimet në shpërndarje, duke ulur progresivisht vit pas viti nivelin e angazhimit buxhetor për të mbështetur sektorin dhe duke synuar që brenda një periudhe pesë-vjeçare i gjithë sektori i energjisë elektrike të kthehet në një sektor fitimprurës.

TRANSPORTI RRUGOR:

Gjatë vitit 2015 synohet ulja ndjeshëm e aksidenteve rrugore, duke përmirësuar sinjalistikën dhe mirëmbajtjen e njollave të zeza, si dhe përfundimi i disa akseve kryesore. Më konkretisht:

- Ky sektor ka prioritet:
 - Rritjen e sigurisë së qarkullimit rrugor, duke synuar arritjen e standardeve evropiane dhe uljen e aksidenteve rrugore, si: përmirësimin e komponentëve të sigurisë rrugore me sinjalistikë dhe përmirësimin e pikave të rrezikut (përmirësimi i sigurisë dhe sinjalistikës rrugore në superstradën Tiranë – Durrës dhe segmentin Kashar – Rinas, përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare, menaxhimi e mirëmbajtje e pajisjeve dhe operimit të tunelit të Thirrës dhe të Krrabës).

- Shtirirjen më tej të procesit të dhënies me koncension të mirëmbajtjes rrugore (pritet që të fillojë dhënia me koncension e shërbimit të mirëmbajtjes së autostradës Milot – Rrëshen - Morinë, me gjatësi 115 km).
 - Vënien në eficiencë të rrugëve që lidhen me zonat turistike të vendit si: rrugët lidhëse me bregdetin Jug-Perëndimor (Llogara - Sarandë), Qafë Thanë – Lin – Pogradec - Tushemisht, rrugës së Valbonës (B.Curri – Margegaj – Dragobi - Valbonë), Gjinarit, Shishtavecit, etj.
 - Ndërtimin e rrugëve që lidhen me zonat kufitare, si: vazhdimi i punimeve për ndërtimin e rrugës Librazhd - Q.Studë - Ura e Çerenecit, Ersekë – Leskovik, etj.
 - Mbulimi me TVSH, kosto lokale dhe i shpronësimeve të projekteve me financim të huaj.
- Me financime të huaja parashikohet të realizohen:
 - Ndërtimi By Pass-it Fier 22 km dhe By Pass-it Vlorë 29 km (financime BERZH & BEI dhe delegacioni i BE);
 - Përfundimi i rrugës Fier (Levan) - Tepelenë 70 km (BEI & BERZH);
 - Ndërtimi i By Pass-it Shkozet (F.Kuvajtin & F.Saudit) dhe i Nyjes së Vorës (F. Kuvajtian);
 - Ndër projektet e reja që parashikohen të zbatohen me financim të huaj gjatë periudhës së PBA-së janë:
 - *Projekti i Bankës Botërore për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore (nevojat e financimit për këtë projekt do të dalin me përfundimin e punës së konsulentit për përgatitjen e projektit, që parashikon ruajtjen e aseteve rrugore, për të siguruar investimin e madh të Qeverisë shqiptare në rrjetin rrugor kombëtar dhe në rrugët sekondare/lokale),*
 - *ndërtimi i rrugës Qukës-Qafë Plloçë, By Pass-i Vlorë, Rrogozhinë, Tepelenë, etj.*

UJËSJELLËS-KANALIZIME:

Me buxhetin e vitit 2015 do përmirësohet ndjeshëm aksesit i ujit për zonat urbane dhe ato rurale. Gjithashtu, do të synohet:

- Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, nëpërmjet mbulimit me rrjet ujësjellësi në zonat urbane në masën 95% dhe në zonat rurale në masën 79%.
- Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit të kanalizimeve, nëpërmjet mbulimit me rrjet kanalizimesh në zonat urbane në rreth 86% dhe ato rurale 25%.
- Rritja e përqindjes së popullsisë, e lidhur me sistemin e kanalizimeve të pajisur me një impiant të ujërave të ndotura deri në 30%.
- Orientimi i ndërmarrjeve të ujësjellësit drejt parimit të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostove.
 - *Mbulimi 100% i Kostos Direkte të Operimit (KDO) me të ardhurat nga 58 sh.a. UK (100% e sh.a-ve).*
 - *Mbulimi 100% i Kostos Totale të Operimit (KTO) me të ardhura nga 29 sh.a. UK (50% e sh.a-ve). Reduktimi i nivelit të ujit pa të ardhura në 48%.*
- Vazhdimësia e shërbimit të furnizimit me ujë në shkallë vendi do të jetë 16 orë/ditë.
- Përfshirja e ndërmarrjeve të Ujësjellës-Kanalizimeve në procesin e rajonalizimit, përmes uljes së numrit të ndërmarrjeve nga 58 në vitin 2012, në 53 të tilla në vitin 2015.

MBËSHTETJA E ZHVILLIMIT EKONOMIK:

Politikat buxhetore në këtë sektor, do të synojnë lehtësimin e mëtejshëm të bërjes biznes në Shqipëri, si edhe njëkohësisht:

- mbështetjen e reformave të ndërmarra në zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë ekonomik të vendit;
- përputhjen e financimeve buxhetore me politikat ekonomike të zhvillimit dhe projekteve, me strategjitë sektoriale dhe ndër-sektoriale për fushat të tregtisë dhe të sipërmarrjes;
- në drejtim të zhvillimit të sipërmarrjes dhe nxitjes së investimeve, në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve për periudhën 2014-2020, politikat buxhetore synojnë krijimin e një klime pozitive për zhvillimin e biznesit dhe rritjen e konkurrueshmërisë së SME-ve, krijimit të vendeve të reja të punës dhe zhvillimit të potencialit ekonomik të vendit.

Nëpërmjet buxhetit të vitit 2015, MZHETS synon rritjen e konkurrueshmërisë dhe zhvillimit të SME-ve me fokus inovacionin. Më konkretisht:

- Për SME-të inovative dhe sipërmarrjen:
 - *Krijimi i Fondit për mbështetjen e mbi 100 bizneseve të udhëhequra nga gratë nëpërmjet kredive me interesa të ulëta, deri në 50%.*
 - *Krijimi i Fondit për Start Up për mbështetjen e rreth 400 bizneseve të reja (start up), nëpërmjet fondeve grant që menaxhohen nga AIDA.*
 - *Krijimi i fondit për mbështetjen e 470 bizneseve krijuese sidomos ato në fushën e artizanatit me grande.*
- Për ndërkombëtarizimin e SME-ve:
 - *Mbi 250 kompani që do të përfitojnë grante nga Fondi i Konkurrueshmërisë për rritjen e konkurrueshmërisë së tyre.*
 - *Referuar vitit bazë 2013, është parashikuar që numri i të punësuarve të ketë një rritje në vitin 2020 prej 40. % ose 116 mijë vende të krijuara në sektorin privat jo-bujqësor.*
- Në drejtim të Mbikëqyrjes së Tregut, synohet:
 - *Krijimi i një mjedisi të përgjithshëm ligjor dhe institucional që i garanton konsumatorëve mbrojtjen e shëndetit, të sigurisë dhe interesave ekonomike, përmirësimin e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin, mbështetjen për një zbatim efektiv të të drejtave të tyre, me qëllim fuqizimin e konsumatorëve dhe rritjen e besimit të tyre për kryerjen e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve në treg, si edhe përmirësimin e sigurisë së konsumatorëve mbështetur në një infrastrukturë efektive të cilësisë, sipas praktikave më të mira evropiane.*
 - *Një masë kritike që do të sjellë një ndryshim cilësor të domosdoshëm, nëpërmjet buxhetit 2015 për MZHETS, në lidhje me konsumatorin, është krijimi i Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut. Ky inspektoriat synon mbikëqyrjen efektive të tregut dhe mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë për konsumatorët, si edhe krijimin e standardeve të produkteve të tregut në mbrojtje të konsumatorit.*
- Reforma në Klimën e Biznesit:

- *Po kështu, nëpërmjet buxhetit të vitit 2015, MZHETS do të vazhdojë rrugën e reformave për lehtësimin e procedurave në të gjithë sektorët, duke vazhduar reformën e thellë për indikatorët e "Doing Business Report", e do të vijojë me reformën institucionale që do të zvogëlojë procedurat, kohën dhe kostot për shërbimet ndaj biznesit. Pavarësisht përmirësimit prej 40 vendesh në renditjen botërore që u arrit në "Doing Business 2015", Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do të vazhdojë punën në drejtim të grupit ndër-institucional të punës për të vazhduar përmirësimin e mëtejshëm të indikatorëve dhe krijimin e lehtësirave të mëtejshme për zhvillimin e sipërmarrjes në Shqipëri.*
- *Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Qendra Kombëtare e Licencimit do të shkojnë drejt bashkimit të tyre, për të krijuar një sportel të vetëm për shërbimet ndaj biznesit, duke rritur njëkohësisht edhe eficiencën dhe duke ulur kostot, kohën dhe numrin e procedurave në funksion të lehtësimit të klimës së zhvillimit të biznesit.*
- *Një tjetër zhvillim cilësor në drejtim të zgjidhjes së problemeve procedurale, të luftës pa kompromise ndaj mitmarrjes dhe korrupsionit dhe në funksion të mbështetjes së aktiviteteve prodhuese në vend, e sidomos në funksion të rritjes së investimeve të huaja të drejtpërdrejta, MZhETS, në bashkëpunim me BERZH do të krijojë Këshillin e Investimeve, një organ jo qeveritar, i cili do të mbështesë Këshillin Ekonomik Kombëtar dhe MZhETS në adresimin e problemeve të sipërmarrjes, si një forum komunikimi dhe veprimi ndaj problematikave që bllokojnë zhvillimin normal të biznesit në Shqipëri.*
- *Paralelisht me krijimin e këtij organi të ri, do të vijojë edhe reforma strukturale në Agjencinë e Zhvillimit të Investimeve të Huaja (AIDA) për ta kthyer këtë institucion në një sportel unik me informacion dhe suport për të gjithë investitorët e huaj që janë të interesuar për të investuar në Shqipëri. Reforma institucionale tek AIDA do të mbështesë krijimin e një strukture funksionale edhe në mbështetje të SME-ve shqiptare, për të ndihmuar në zgjerimin e aktivitetit të tyre ekonomik dhe në rritjen brenda zhinxhirit të vlerës, në mënyrë që produktet "Made in Albania" të gjejnë tregje të reja dhe të zhvillohen me synim eksportin dhe konkurrueshmërinë në nivel ndërkombëtar.*
- *Njëkohësisht do të vazhdojë monitorimi i sektorëve në zhvillim të ekonomisë, nga manifaktura e deri tek turizmi e bujqësia, për të analizuar efektshmërinë e masave lehtësuese që po merren në kuadër të reformave sektoriale dhe njëherazi për të qenë të gatshëm të mbështeten këto sektorë edhe me politika të tjera lehtësuese sipas nevojave të rritjes dhe zhvillimit të tyre.*
- *MZhETS është duke zhvilluar një reformë në drejtim të krijimit të zonave industriale dhe zonave të lira ekonomike funksionale, reformë e cila synon krijimin e zonave të posaçme zhvillimore me fokus inovacionin dhe prodhimin industrial dhe krijimin e zonave të lira ekonomike si qendra të prodhimit për eksport. Krahas reformës së ndërmarrë në manifakturë, kjo reformë pritet të tërheqë drejt vendit investitorë të mëdhenj dhe të rrisë ndjeshëm prodhimin vendas, duke patur një impakt tejet të gjerë, si mbi punësimin dhe aktivitetin ekonomik në vend, ashtu edhe në drejtim të bilancit tregtar, sidomos me partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë në Bashkimin Europian*

Me anë të tërësisë së këtyre reformave synojmë që të krijojmë më shumë mundësi ekonomike, thjeshtëzimin e procedurave dhe hapave administrative dhe krijimin e një klime optimale për zhvillimet të shpejta në sektorët e ndryshëm të ekonomisë, për të sjellë një zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë.

INTEGRIMI:

Pas marrjes së statusit të vendit kandidat, Shqipëria dhe Qeveria e saj, ndodhen para sfidave të rëndësishme, që njëkohësisht përbëjnë edhe objektivat kryesore të Ministrisë së Integrimit Evropian në vitin 2015 dhe në vazhdim, të tilla si:

- sigurimi i hapjes së shpejtë të negociatave,
- organizimi dhe përgatitja e këtij procesi,
- ngritja dhe përshtatja e strukturave përgjegjëse për këtë proces, si dhe
- vetë-koordinimi i negociatave.

Në shërbim të arritjes së këtyre objektivave, projektbuxheti i MIE për vitin 2015 siguron vazhdimësinë e koordinimit dhe monitorimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) dhe veçanërisht, plotësimin e proceseve të tilla të rëndësishme si:

- hartimi dhe monitorimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, si instrumenti kryesor i Qeverisë shqiptare në procesin e integrimit evropian;
- raportimi mbi progresin e arritur tek shërbimet e Komisionit Evropian;
- koordinimi i takimeve të institucioneve të përbashkëta Shqipëri-Bashkimi Evropian ngritur në kuadër të MSA-së;
- planifikimi dhe monitorimi i asistencës së Bashkimit Evropian bazuar në programimin sektorial dhe menaxhimin e decentralizuar të kësaj asistence.

Për më tepër, MIE është angazhuar në shërbim të procesit të integrimit evropian të vendit edhe përmes informimit të shoqërisë civile, rinisë, botës akademike, grupeve të interesit dhe aktorëve të tjerë shoqërorë, mbi proceset e integrimit evropian të Shqipërisë dhe njohja e tyre me fazat e ndryshme të këtij procesi.

Së fundi, hapja e negociatave, procesi i integrimit dhe anëtarësimi kërkon përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian. Duke pasur parasysh përsheptimin e arritur në këtë proces dhe pritshmërinë e mëtejshme në këtë fushë, realizimi i këtij objektivi merr një shtytje të re me projektbuxhetin e vitit 2015.

NXITJA E PUNËSIMIT:

Risia kryesore për 2015 do të jetë fondi për “Zhvillimin e Punësimit dhe Aftësive” në vlerën rreth 250 milionë LEK, i cili do të mbështesë punësimin dhe aftësimin e punëkërkuarve të orientuar drejt industrisë fasone, si dhe:

- Financimi i Programeve të Nxitjes së Punësimit në vlerën prej 450 milionë LEK, brenda të cilëve parashikohet të përfshihen rreth 5,000 punëkërkuar të papunë. Financimin brenda këtij fondi të programeve të reja, me histori suksesi në vendet fqinje, si ai i nxitjes për hapjen e aktiviteteve prodhuese, ku për vitin 2015 parashikohet të përfshihen 50 të rinj.

- Shtrirja e mëtejshme e modelit të Zyra të reja të Punës në shërbim të punëkërkesve dhe punëdhënësve, si dhe promovimi i shërbimeve të reja të ofruara. Ky model ka sjellë rezultate konkrete gjatë vitit 2014 në aplikimin e tij në 6 zyra rajonale.
- Përmirësimin e shërbimeve të punësimit nëpërmjet informacionit mbi tregun e punës, ndërmjetësimit, informimit, këshillimit për plotësimin e vendeve të lira të punës dhe përfshirjen në programet aktive e pasive të tregut të punës. Parashikohet të kryhen 12,500 ndërmjetësime për punëkërkesit e papunë.
- Mbështetjen financiare të nevojshme për rritjen e cilësisë dhe përshtatjen me kërkesat e tregut të punës të kurseve të formimit profesional, që synon plotësimin dhe përmirësimin e nevojave për përballimin me materiale, hapje kursesh të reja, instruktorë part-time në bazë të nevojës për hapje kursesh, etj.
- Rritjen e numrit të punëkërkesve të papunë që do të trajtohen me formim profesional në 10,100 persona dhe ndjekja e punësimit post-formim për 4,000 punëkërkes të papunë.
- Trajtimin me pagesë papunësie për 10,500 persona, me një fond prej 1 miliard LEK.

TURIZMI:

Trajtimi i turizmit si një fushë prioritare e zhvillimit të qëndrueshëm në vend, me një qasje të integruar dhe plotësuese ndërsektoriale, që menaxhon burimet në mënyrë të balancuar, gjeneron zhvillim ekonomik dhe garanton punësim. Dhe njëkohësisht:

- Përmirësimi i identitetit shqiptar të turizmit në rajon e më gjerë, nëpërmjet zbatimit të Strategjisë së Brandimit të Shqipërisë për Turizmin dhe Investimet, duke synuar rritjen e numrit total të turistëve me 5–8% krahasuar me vitin 2014, rritjen e numrit të netë-qëndrimeve me 5% krahasuar me 2014, si dhe rritjen e të ardhurave nëpërmjet turizmit me 10% krahasuar me 2014.
- Zhvillimi i integruar i produkteve konkurruese turistike të kulturës, bregdetit, dhe natyrës/rural në destinacionet turistike kryesore, bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit 2014 – 2020. Këto produkte do të zhvillohen në 4 destinacione për turizmin e natyrës, 5 për turizmin kulturor, dhe 3 destinacione për turizmin e bregdetit.
- Përmirësimi cilësor i të dhënave statistikore të turizmit, të cilat do të shërbejnë për të ngritur një sistem kombëtar të të dhënave statistikore për turizmin, duke përfshirë për herë të parë edhe turizmin e brendshëm; ngritja e regjistrit kombëtar të turizmit që do të përfshijë sipërmarrjet turistike, strukturat akomoduese, si dhe burimet turistike cilësore dhe të gatshme për t’u bërë pjesë e produktit turistik.
 - *Ngritja për herë të parë e sistemit kombëtar të statistikave të turizmit të brendshëm, që do të mundësojë marrjen e të dhënave nga turizmi i brendshëm, vlerësimin e tyre, si dhe hartimin e politikave përkatëse për përmirësimin e produkteve kryesore turistike me fokus në lëvizjen e shtetasve shqiptarë në Shqipëri.*
- Pjesëmarrja e Shqipërisë **për herë të parë** në “Expo Milano” me temën “*Our Food, Our Story, Our Mystery...*”, që do të zhvillohet në Itali nga maj – tetor 2015, që do t’i shërbejë rritjes së imazhit të Shqipërisë, si dhe vendosjes në hartën ndërkombëtare të turizmit dhe udhëtimit.

MJEDISI:

Edhe për vitin 2015 do të synohet përmirësimi i qëndrueshëm i cilësisë së mjedisit duke u fokusuar në mirëmenaxhimin e mbetjeve, uljen e ndotjeve, mbrojtjen e eko-sistemeve dhe bio-diversitetit vendas. Më konkretisht synohet:

- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve duke zbatuar në praktikë konceptin “3R”, ndërgjegjësimin e publikut, edukimin mjedisor mbi riciklimin e mbetjeve.
- Zhvillimi i një strategjie kombëtare për uljen e karbonit dhe zbatimit të detyrimeve që dalin nga Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike.
- Ruajtja e qëndrueshme e bio-diversitetit unik bregdetar dhe detar të Shqipërisë. Përmirësimin në mënyrë efektive të mbulimit dhe menaxhimit të rrjetit të Shqipërisë për zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare, si një aspekt plotësues thelbësor për rrjetin e zonave të mbrojtura tokësore.
- Dhënia e kontributit në mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit në kontekstin ndërkufitar të tre shteteve: Shqipëri, Greqi, Maqedoni.
- Promovimi i përmirësimit të eko-sistemeve detare dhe bregdetare duke propozuar modele për një menaxhim të koordinuar të peshkimit, me aktivitetet direkte për të përmirësuar qëndrueshmërinë e peshkimit dhe forcimin e bio-diversitetit detar.
- Automatizimi i bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjorë dhe kullësorë, si dhe krijimi i kadastrës kombëtare të pyjeve dhe kullotave.
- Shtimi i sipërfaqes pyjore nëpërmjet pyllëzimit dhe ri-pyllëzimit.

KULTURA:

Me buxhetin e vitit 2015, do të mundësohet rritja e gamës dhe cilësisë së fondit të trashëgimisë kulturore, si dhe do të zgjerohet numri i projekteve të shumëllojshme në kuadër të promovimit të artit dhe kulturës vendase. Më konkretisht synohet:

- Restaurimi i objekteve madhore të trashëgimisë kulturore, që për shkak të vendndodhjes apo natyrës së tyre, gjenerojnë të ardhura në funksion të komuniteteve:
 - Restaurimi i Qendrave të Trashëgimisë Botërore të Njerëzimit Gjirokastër dhe Berat;
 - Restaurimin dhe krijimin e disa muzeve si ai Arkeologjik i Durrësit, Muzeu i Sigurimit të Shtetit, Muzeu Etnografik në Berat, etj;
 - Restaurime të disa objekteve të kultit në qendrat kryesore si: Berat, Korçë, Vlorë.
- Përmirësimi i pajisjeve hardware dhe software të sistemit të institucioneve të trashëgimisë kulturore, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit dhe standardizimit të punës për një menaxhim sa më të mirë të burimeve dhe katalogim të vlerave kulturore.
- Rritja me 4% e prurjeve artistike, aksesit, përmirësimit të kushteve infrastrukturore, si dhe promovimit të vlerave kulturore nëpërmjet rikonceptimit të funksionimit institucional në fushën e Artit dhe Kulturës deri në vitin 2017.
- Rritja me 7% e projekteve krijuese nëpërmjet konkurrencës artistike dhe një mirëadministrimi në projektim, shpërndarje; menaxhim të fondeve për projektet kulturore artistike, me synim nxitjen dhe promovimin e krijimtarisë artistike dhe edukimit përmes kulturës.
- Zgjerimi me 5% i hapësirave ndërkombëtare të komunikimit dhe performimit artistik e kulturor në programe dhe evenimente ndërkombëtare.

MBROJTJA SOCIALE:

Gjatë 2015 do të përmirësohet ndjeshëm targetimi i skemave sociale, duke rritur hapësirën e fondeve buxhetore, dhe njëkohësisht:

- Do të ulet me rreth 20,000 persona numri i përfituesve të Ndhmës Ekonomike, krahasuar me vitin 2014, si pasojë e rishikimit të skemës dhe e targetimit më të mirë të grupeve dhe individëve që janë realisht në nevojë. Duke planifikuar të njëjtin fond si për vitin 2014 (4.6 miliardë LEK), do të bëhet e mundur rritja e masës së mbështetjes për këtë kategori personash në nevojë.
- Si rezultat i rishikimit të vazhdueshëm të legjislacionit në fuqi dhe e evidentimit e eliminimit e rasteve abuzive, synohet të mbahet konstant numri i përfituesve dhe i fondit të parashikuar për Personat me Aftësi të Kufizuar (krahasuar me vitin 2014), pavarësisht rritjes natyrore të numrit të kësaj kategorie dhe indeksimit të pritshëm.
- Ngritja e një sistemi të përshtatshëm shërbimesh sociale në Institucionet e Kujdesit Social, me standarde bashkëkohore për rehabilitimin dhe ri-integrimin në jetën normale të kategorive që trajtohen në to, si: fëmijët jetim, të moshuar të braktisur, viktimat të trafikimit, si dhe fëmijët me aftësi të kufizuar, viktimat të dhunës në familje.
- Rritja e aksesueshmërisë dhe përfshirjes së PAK, në zbatim të ligjit përkatës. Planifikimi për vitin 2015 përfshin pagesa për printimin e ligjit në format të aksesueshëm (Braille) dhe për interpretë të gjuhës së shenjave.
- Hartimi dhe zbatimi i politikave për mbështetjen e rinisë në të gjitha fushat e veprimtarisë dhe garantimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën sociale. Për vitin 2015 është propozuar një buxhet ambicioz në lidhje me projektet për rininë, i cili synon fuqizimin dhe mbështetjen e të rinjve të talentuar për zhvillimin e potencialit të tyre krijues dhe përfshirjen e tyre në vendimmarrje. Gjithashtu, gjatë vitit 2015 parashikohet dyfishimi i rjetit të Qendrave Rinore Rajonale.
- Rritja e cilësisë së shërbimeve sociale, për shtresën e të përndjekurve politikë, si dhe hartimi i programeve të përkujdesit për integrimin social dhe ngritja e një memorie historike. Në vijim të përmirësimeve të bazës ligjore, në të cilën kushtet e përfitimit për këtë shtresë u ndryshuan me ligjin nr. 94/2014, fondi për kompensimin e kësaj shtrese parashikohet të jetë 2 miliardë LEK.

RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE:

Gjatë vitit 2015, do të përmirësohet ndjeshëm siguria publike, duke rritur mbështetjen për forcat policore. Me buxhetin e parashikuar për Ministrinë e Brendshme për vitin 2015, garantohet mbështetja financiare për funksionimin normal të strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Gjendjes Civile, Shërbimeve të Emergjencës Civile, si dhe strukturave të tjera në varësi. Në mënyrë të veçantë, si risi të buxhetit të parashikuar për vitin 2015, mund të përmendim:

- Mbështetjen e reformimit të strukturave të Policisë së Shtetit në kuadër dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji i ri i miratuar për këtë strukturë;
- Mbështetjen e Policisë së Shtetit, me mjete, pajisje dhe teknologji bashkëkohore, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve policore dhe qenien e saj sa më afër me qytetarët;
- Përfundimin e disa projekteve të rëndësishme të ndërtimit dhe rikonstruksionit të ambienteve për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë;

- Rritjen e numrit të punonjësve të policisë për çdo 1000 banorë, referuar faktit se aktualisht numri i punonjësve të policisë për 1000 banorë është më i ulët se në gjithë vendet e rajonit dhe krijimin e mundësisë për funksionimin e zyrave të pritjes së qytetarëve pranë çdo drejtorie policie qarku;
- Përmirësimi i Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpërmjet përmirësimit dhe mirëmbajtjes së Rrjetit të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe Regjistrimit Kombëtar të Adresave;
- Reformimin dhe ristrukturimin e Gardës së Republikës.

MBROJTJA:

Bazuar në tavanet e miratuara për Ministrinë e Mbrojtjes, strukturat planifikuese dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik shqyrtoi prioritet kryesorë në kuadër të një planifikimi sa më efektiv dhe eficient, duke u fokusuar specifikisht në:

- **Modernizimi i Forcave të Armatosura:**
 - *Përfundimi i kontratës së helikopterëve, në vlerën 1.3 miliardë LEK;*
 - *Vazhdimi i kompletimit të Batalionit të II-të të këmbësorisë, rikonstrukcioni i njësisë ushtarake, poligoneve, qendrave të trajnimit dhe klasave, depove të armatimit, etj, sistemi i automatizimit kompjuterik, arsim, edukim, strehim, përkudësje ndaj ushtarakëve, etj, në vlerën 400 milionë LEK.*
- **Përmirësimi i infrastrukturës ushtarake**
 - *Rikonstrukcione në njësi ushtarake, poligone, rikonstrukcione të qendrave të trajnimit, depove dhe magazinave;*
 - *Përmirësimi i infrastrukturës për rritjen e kapaciteteve të forcave të armatosura, arsim, edukim e përkudësje ndaj ushtarakëve.*
- **Bashkëpunimi rajonal në kuadër të NATO-s**, me një vlerë mbi 800 milionë LEK, kundrejt 300 milionë LEK të parashikuara deri në fund të vitit 2014, ku përfshihet:
 - *Pjesëmarrja në operacione të përbashkëta;*
 - *Vazhdimi i kontributeve në kuadër të NATO-s, në zonat e nxehta.*
- **Bashkëpunimi Ushtarako-Civil**
 - *Përballimi i emergjencave civile;*
 - *Pjesëmarrje në aktivitetet për një Shqipëri të pastër;*
 - *Kontrolli i integruar i hapësirave detare;*
 - *De-militarizimi dhe pastrimi i hot-spotëve.*

Nisur nga fondet e planifikuara për vitin 2015 theksojmë se për modernizim do të shpenzohen 92% të totalit të fondit të investimeve dhe 8% do të shpenzohen për infrastrukturë. Ky raport për vitin 2014 shprehet në modernizim 97% dhe infrastrukturë 3%. Në projektet e modernizimit për vitin 2014, 96% të tyre e zë projekti i blerjes së helikopterëve dhe armatimit përkundrejt 80% që do të zërë në vitin 2015. Në këtë mënyrë është ulur pesha e blerjes së armatimit, duke synuar elementë të tjerë të modernizimit, siç janë infrastruktura, blerja e pajisjeve hardware, etj.

POLITIKA E JASHTME:

Gjatë vitit 2015, orientimi i Politikës së Jashtme do të jetë marrëdhënia më intensive me të gjitha vendet anëtare të BE-së, si dhe me Organizatat Ndërkombëtare, me synim përsheptimin e negociatave për

anëtarësim në BE, si dhe rritjen e rolit aktiv të Shqipërisë në sferën rajonale e më gjerë. Më konkretisht, synohet:

- Intensifikimi i marrëdhënieve në të gjitha fushat me vendet anëtare të BE-së. Ajo do të bashkëpunojë ngushtë me to për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE;
- Forcimi i bashkëpunimit të Shqipërisë me Organizatat Ndërkombëtare dhe pjesëmarrja aktive e saj në veprimtaritë e tyre në fushën e sigurisë dhe paqes, demokracisë, çarmatimit, ekonomiko-sociale, të së drejtës ndërkombëtare, si dhe të të drejtave të njeriut;
- Ndjekja në vijimësi e aktivitetit të Organizatave Ndërkombëtare në lidhje me Kosovën dhe përgatitja për zhvillimet e pritshme që lidhen me forcimin e lobingut për njohjen ndërkombëtare të Kosovës. Avancimi i çështjes së Kosovës në OBI dhe në organizatat e tjera;
- Forcimi i bashkëpunimit rajonal me vendet e Evropës Juglindore në përgjithësi dhe me ato të Ballkanit Perëndimor në veçanti, me qëllim përshpejtimin e proceseve të bashkëpunimit, kryesisht, në fusha të tilla si: infrastruktura, energjia, ekonomia, turizmi, etj., dhe përparimit në procesin e integritimit evropian.

5. POLITIKAT E TAKSAVE PËR VITIN 2015

5.1 PAKETA E RE FISKALE

Politikat e reja të taksave dhe tatimeve në vitin 2015 synojnë një zgjerim të mëtejshëm të bazës së të ardhurave për të mbështetur rritjen e shpenzimeve publike dhe konsolidimin fiskal. Njëkohësisht, hartimi i Paketës Fiskale 2015 është bërë në drejtim të mbështetjes së reformave të qeverisë për vitin 2015, për disa sektorë të ekonomisë të tilla si : a) Sektori i sigurimeve, duke hequr TVSH për produktet e jo-jetës prej 20% dhe aplikimi i një takse mbi primin prej 3%; b) Sektori i peshkimit duke e përjashtuar nga taksa e qarkullimit dhe karbonit për karburantet; c) Sektori i bujqësisë dhe agrobiznesit duke hequr tarifat doganore për disa lëndë të para si, gruri, materiali biologjik, mielli, ushqimi për kafshët, kafshët për mbarështim si viçat apo derrat; ç) Rafineritë vendase, duke hequr taksën doganore të naftës bruto prej 10%; d) Sektori i pensioneve vullnetare, duke përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale kontributet në fondet vullnetare të pensioneve që në momentin e kontributit; dh) Rritja e rentës minerare për pushtetin vendor dhe heqja e kushtëzimit me transfertën e pakushtëzuar, duke rritur kështu financat e pushtetit vendor. Gjithashtu, në këtë Paketë Fiskale adresohen disa kërkesa disavjeçare të biznesit si p.sh. çështja e firove apo e amortizimit me vlerën e mbetur.

Paketa Fiskale 2015 sjell ndryshime të rëndësishme në taksat e mëposhtme:

Tatimi mbi të ardhurat personale synon ndryshimin e normës së taksimit mbi të ardhurat personale (TAP) nga 10% në 15%, përveç normës së tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga paga (që u ulën vitin e kaluar me Paketën Fiskale 2014). Efekti në të ardhurat e buxhetit të shtetit vlerësohen të jenë rreth 5 miliardë LEK për vitin 2015. Më konkretisht komponentët e TAP që ndryshojnë janë: tatimi mbi dividendin, interesat nga huatë, depozitat ose kontrata të ngjashme, të ardhurat nga e drejta e autorit ose

pronësia intelektuale, qiraja, të ardhurat nga lojërat e fatit, si dhe të gjitha shpërblimet apo të ardhurat e tjera. Këto masa vijnë në të njëjtën linjë me politikat afatmesme të qeverisë lidhur me qëndrueshmërinë fiskale.

Taksa e qarkullimit është një taksë tjetër që synohet të rritet me 10 LEK / litri për naftën dhe benzinën. Efekti në të ardhurat e buxhetit të shtetit vlerësohen të jenë rreth 5.6 miliardë LEK nga taksa e qarkullimit dhe 1.1 miliardë LEK nga TVSH-ja, për vitin 2015. Arsyet për ndryshimin e kësaj takse janë:

- **nevojat në rritje të mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore.** Taksat gjithsej në benzinë dhe naftë janë 57 LEK /litër. Totali i mbledhjes së këtyre taksave, ekonomikisht, nuk mbulon plotësisht investimet me anë të buxhetit të shtetit;
- **adresimi i efekteve anësore** në lidhje me mjedisin duke vazhduar angazhimet ambientaliste të qeverisë;
- marrja në konsideratë e **një game efektsh anësore** nga përdorimi i mjeteve rrugore, të cilat duhet të reflektohen në taksat e karburantit motorik (përfshirjen e emetimeve të karbonit, ndotjen e ajrit lokal, bllokimet dhe aksidentet).

Duhet të theksojmë se, me gjithë propozimet e mësipërme, Shqipëria ende nuk i plotëson kërkesat minimale të BE-së për akcizat e karburanteve motorike. Direktiva e BE-së 2003/96 kërkon një akcizë minimale prej 0,359 EUR (50 LEK) për litër për benzinën, 0.330 EUR (46 LEK) për litër në naftën (motorike). Përsa i përket ndikimit të rritjes së kësaj takse në çmimin final të shitjes me pakicë të naftës dhe benzinës, vlerësohet se kjo rritje takse nuk do të përkthehet në rritje çmimi, për arsye të rënies së çmimeve në tregjet ndërkombëtare. E njëjta rritje takse u bë edhe në Paketën Fiskale 2014, rritje e cila nuk u pasqyrua në rritjen e çmimit në tregun e brendshëm.

Rritja e **akcizës për duhanin** është një nga politikat e përdorura për frenimin dhe uljen e konsumit të cigareve nga popullata, duke rritur çmimin e shitjes së tyre. Përpos kësaj, ne kemi një nivel modest taksimi të cigareve dhe një rritje progresive është e nevojshme për t'u përafëruar me nivelin minimal sipas BE-së. Për këtë arsye, në muajin tetor 2014, Kuvendi miratoi rritje të akcizës së cigareve nga 4500 LEK/1000 copë (90 LEK /paketë), që ishte në 5500 LEK /1000 copë (110 LEK /paketë). Efekti pozitiv në të ardhurat e buxhetit të shtetit nga rritja e akcizës, për vitin 2015, parashikohet të jetë rreth 3.4 miliardë LEK nga akciza dhe 600 milionë LEK nga TVSH-ja. Në linjë me rritjen e akcizës së cigareve, Kuvendi miratoi edhe rritjen e akcizës së duhanit të dredhur me 1400 LEK / kg deri në fund të vitit 2015. Efekti në të ardhura është 200 milionë LEK për vitin 2015.

Renta minerare dhe ndryshimet në kuadrin ligjor të saj, synojnë që renta minerale që do të marrë pushteti vendor të mos jetë e lidhur me shumën e transfertës së pakushtëzuar. Për këtë arsye, do të ndryshojë përqindja e të ardhurave nga renta minerare që merr pushteti vendor ku zhvillohet veprimtaria minerare, nga 25% në 5%. Ndarja e të ardhurave nga renta minerare, midis pushtetit vendor dhe qendror, përbën një politikë normale fiskale të decentralizimit fiskal. Mirëpo, për këtë ndarje të ardhurash midis dy pushteteve, ka dy ligje specifike, të cilat përcaktojnë procedurën e shpërndarjes dhe që në dualizëm me njëra-tjetrën kanë bërë që pushteti vendor të përfitojë shumë pak nga mbledhja e rentës minerare. Bazuar në të ardhurat nga renta minerare për vitin 2014, të cilat vlerësohen rreth 7.8 miliardë LEK, pushtetit vendor do t'i kalojnë rreth 400 milionë LEK, nga 100 milionë LEK që ka marrë për vitin 2013.

Ulja e rentës së mineraleve që përpunohen në vend - Në adresim të kërkesës së Shoqatës së Mineraleve të Shqipërisë të uljes së rentës minerale për mineralin e kromit të përpunuar në vend, dhe me qëllim nxitjen e investimeve direkte vendase dhe të huaja nëpërmjet rritjes së shkallës së përpunimit të këtij minerali në vend, do të propozohet që përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit krom në nënproduktin minerar të jetë në masën sa 2/3 e normës së rentës së mineralit. Aktualisht, struktura e eksportit të kromit mbizotërohet nga minerali i papërpunuar, ku pesha specifike e mineralit të papërpunuar të kromit zë rreth 91% (koncentrati i kromit dhe ferrokromi zënë në total rreth 9%). Rritja e shkallës së përpunimit të këtij minerali në vend që vjen si pasojë e uljes së masës me 1/3 e normës së rentës, pritet të sjell rritjen e të ardhurave të arkëtueshme nga renta minerare. Megjithë efektet negative që do të sjellë kjo masë në të ardhurat nga renta në masën 45.3 milionë LEK, efektet pozitive të pritshme nga ulja e rentës minerare të nënprodukteve të kromit, janë më të larta, në drejtim të inkurajimit të investimeve në industri përpunuese; rritjes së furnizimit me lëndë të parë në vend kundrejt eksportit; rritjes së investimeve kapitale në vend; apo stimulit të vendeve të reja të punës

5.2 POLITIKAT PËR MBËSHTETJEN E BIZNESIT

Për vitin 2015 janë evidentuar disa sektorë prioritarë të ekonomisë, të cilët do të mbështeten me politika fiskale të uljes së barrës tatimore si një element i rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit të tyre.

Përrjashtimi nga taksa e qarkullimit dhe karbonit për sektorin e peshkimit – Do të hiqet taksa e qarkullimit dhe e karbonit për karburantin e anijeve të peshkimit, përmes furnizimit të anijeve të peshkimit me karburant të pa taksuar. Sektori i peshkimit është i përjashtuar nga pagesa e akcizës prej 37 LEK / litri. Për të rritur edhe më tej lehtësirat fiskale për këtë sektor prioritar, është propozuar përjashtimi i sektorit nga taksa e qarkullimit dhe karbonit prej 30 LEK / litri, e cila do të çonte në 67 LEK /litri masën e përjashtimit, kërkesë kjo e industrisë së peshkimit dhe pjesë e Paketës “Bujqësia” e ministrisë përgjegjëse për peshkimin. Heqja e këtyre dy përjashtimeve adreson një kërkesë disa vjeçare të peshkatarëve në vend, për të cilët karburanti zë rreth 80% të kostos së tyre dhe në pamundësi për të marrë furnizim me çmim të ulët të karburantit, janë drejtuar ndër vite në portet italiane apo malazeze. Përrjashtimi nga këto taksa për anijet e peshkimit synon:

- Rritjen e volumit të transaksioneve të biznesit vendas, formalizimi i shitjeve dhe reflektimi real në PBB e vendit;
- Rritjen e të ardhurave në buxhet, si dhe rritje dhe reflektim real i të punësuarve në këtë sektor;
- Uljen e kostove për sektorin, pasi për shkak të kostos së lartë krahasuar me vendet fqinje, furnizimi i karburantit bëhej të paktën 1 herë në muaj në këto vende;
- Përrmirësimin e barazisë në treg ndërmjet operatorëve në kushtet e një formaliteti më të lartë.

Primi në sektorin e sigurimeve – Viti 2015 do të materializojë mbështetjen e Qeverisë ndaj sektorit të sigurimeve, një sektor jetik për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit. Vlen për të theksuar se nga data 1 janar 2015, do të zbatohet përjashtimi nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar të primeve të shkruara për produktet e jo-jetës, (duke sjellë trajtimin e tyre fiskal sipas Direktivës Evropiane), masë kjo me një efekt 500 milionë LEK minus nga të ardhurat nga TVSH-ja, ndërsa vendoset një taksë e re kombëtare, prej 3% mbi to. Efekti në të ardhurat e buxhetit të shtetit për vitin 2015 do të jetë rreth 220

milionë LEK. Efekti neto në të ardhurat nga këto dy taksa do të jetë negativ me rreth 280 milionë LEK, por vlerësohet që këto ndryshime të jenë faktor nxitës për shtim të aktivitetit thelbësisht të përmirësuar të shërbimit të sigurimeve, që ende vuan nga standarde të ulëta krahasuar me BE-në dhe fqinjët.

Taksat Doganore në sektorin e bujqësisë – Bujqësia është trajtuar si sektor prioritar i Qeverisë gjatë vitit 2014 dhe për këtë arsye ky sektor ka pasur një vëmendje të veçantë përsa i përket uljes së kostove të fermerit, nëpërmjet përjashtimeve dhe uljes së taksave të ndryshme. Kështu, në ligjin e ri “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” që hyri në fuqi në gusht 2014, u rikonceptua skema e kompensimit të fermerëve në masën 20% nga 6% që ishte më parë, masë e rëndësishme kjo në uljen me 20% të kostove të fermerit për blerjet e lëndëve të para. Edhe në vitin 2015, ky sektor do të vazhdojë të jetë prioritar, bazuar në masat e përfshira në “Paketa Bujqësia”, e cila është një paketë e plotë masash për nxitjen dhe zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe agrobiznesit, për uljen e kostove dhe rritjen e rentabilitetit të këtyre sektorëve. Ndër këto masa është kalimi nga 2% në 0% i taksave për importin e produkteve që shërbejnë si lëndë të para për industrinë apo blegtorinë si p.sh. gruri, ushqimi për kafshët, zogjtë një ditor, derrat nën 30 kg, viçat nën 160 kg, dhe kalimi nga 10% në 0% i tarifës doganore të miellit dhe të materialit biologjik elitari. Këto reduktime të taksave doganore do të kenë një kosto në buxhetin 2015, e cila llogaritet rreth -232 milionë LEK bashkë me TVSH-në, e cila automatikisht do të ulë po në këtë shumë shpenzimet e biznesit. Gjithashtu kemi pritshmëri dhe për ulje të çmimeve të disa produkteve bazë ushqimore të tilla si: buka apo mishi.

Firot - Ligji aktual për tatimin mbi të ardhurat përcakton se janë shpenzime të panjohura: “humbjet, dëmtimet, firot dhe skarcot gjatë prodhimit, tranzitimit dhe magazinimit, tej normave të përcaktuara në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore“. Ndërkohë nuk ekzistojnë akte nënligjore për përcaktimin e firove në industri të ndryshme, duke krijuar kështu një tension të përhershëm midis administratës tatimore dhe grupeve të biznesit. Për këtë arsye, propozohet që Këshilli i Ministrave të përcaktojë me Vendim të posaçëm masën e njohjes së firove apo humbjeve për qëllime fiskale. Kjo masë i vjen në ndihmë biznesit duke i dhënë mundësi të rrisë shpenzimet e zbritshme për vitin 2015, e cila bën që ti ulet fitimin e tatueshëm. Ndërkohë efekti sasior në buxhet nuk mund të vlerësohet momentalisht.

Amortizimi me vlerën e mbetur – Rifomatimi i amortizimit të aktiveve afatgjata, të cilat pasqyrojnë drejt vlerën e shpenzimeve të njohura të aktiveve. Sikurse firot më lart, edhe adresimi i çështjes së amortizimit do të ketë ndikim negativ në të ardhurat nga tatimi mbi fitimin, por efekt pozitiv në fitimin e bizneseve. Efekti sasior i kësaj mase nuk mund të vlerësohet momentalisht.

Adresimi i çështjes së “firove“ dhe “amortizimit me vlerën e mbetur” kanë përbërë kërkesa disa vjeçare të biznesit, të paadresuara më parë, për arsye se të tilla parashikime fiskale kanë shtrembëruar pasqyrat financiare të biznesit duke ndikuar në një fitim jo të drejtë fiskal. Të tilla shtrembërime kanë nxitur nënraportimet fiskale të biznesit dhe marrja përsipër e rregullimit të këtyre dy çështjeve madhore, pavarësisht se do të shoqërohet me efekte negative në të ardhurat nga tatimi mbi fitimin në buxhet, do të ndikojnë në krijimin e rregullave të ndershme fiskale për biznesin për njohjen e saktë të shpenzimeve reale të biznesit, për aktivitetin e tij dhe investimet në asete.

Heqja e akcizës për bitumin natyral – Me qëllim uljen e kostove të operatorëve ekonomikë të përpunimit të bitumit natyral në vend, Kuvendi miratoi në muajin tetor 2014 ligjin e akcizës, në të cilin hiqet akciza për bitumin natyral në masën 5 LEK /kg. Adresimi i kësaj kërkesë të operatorëve ekonomikë në vend, u bë në përputhje me përafrimin e legjislacionit tonë me atë të BE-së, sipas të cilit bitumi nuk është mall akcize. Efekti në të ardhurat e buxhetit të shtetit vlerësohet minus 1.5 milionë LEK.

Bërja zero për qind e tarifës doganore për naftën bruto – Bërja zero për qind e tarifës doganore për naftën bruto nga 10% që është aktualisht, vjen si mbështetje e qeverisë në uljen e kostove të prodhimit të rafinerive në vend, për t'i dhënë një stimul fiskal këtij sektori, për vitin 2015, në synim rritjen e përpunimit të naftës bruto në vend dhe rritjen e prodhimit vendas për nënproduktet e naftës.

Sektori i pensioneve vullnetare – Një tjetër ndryshim ligjor në ndihmë të taksapaguesve lidhet me përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat personale të kontributeve në fondet vullnetare të pensioneve, që në momentin e kontributit. Aktualisht, mbi 7 mijë anëtarë të fondeve private të pensioneve nuk përfitojnë nga lehtësia fiskale që ofron ligji për pensionet. Kjo ndodh sepse në ligjin për tatimet mbi të ardhurat kontributet për pensionin vullnetar njihen si shpenzime të zbritshme vetëm për ata kontribues të ardhurat vjetore bruto të të cilëve janë poshtë kufirit prej 1,000,050 LEK. Gjithashtu, procedurat tatimore përkatëse nuk parashikojnë që zbritja për qëllime tatimore të kryhet direkt nga punëdhënësi, sikurse ndodh gjerësisht në praktikën e vendeve që ofrojnë nxitje të tilla. Për këtë arsye, aktualisht, investimi në fondin e pensionit vullnetar është alternativa më inferiore e investimit apo e kursimit, sepse nga parimi EET (përjashtim – përjashtim – tatim), i parashikuar në ligjin për pensionet, në fakt zbatohet si TET (tatim – përjashtim – tatim), sipas parashikimeve të ligjit të tatimit mbi të ardhurat. Pra, në realitet, anëtarët e pensionit privat, jo vetëm që nuk përfitojnë nga lehtësirat fiskale, por diskriminohen, duke u tatuar dy herë.

Pothuaj kudo kursimet pensionale taten në mënyrë më të favorshme sesa kursimet për qëllime të tjera dhe EET është sistemi tipik i tatimit për kursimet pensionale në botë. Gjithashtu, shumica e vendeve të BE-së përdorin regjimin EET. Pra, qartazi Shqipëria ka një praktikë tatimore që nuk është në harmoni me praktikën e vendeve të BE-së, madje edhe të vendeve të rajonit, si Maqedonia, dhe nuk nxit rritjen e shkallës së kursimit afatgjatë.

Ulja e taksës doganore për gomat e reja: Goma është nga pjesët më të rëndësishme të sigurisë së automjetit dhe ulja e tarifës doganore të gomave të reja nga 15% në 10% do të ulë diferencën në vlerë të gomave të reja me ato të vjetra, duke ndikuar në këtë mënyrë në uljen e importit të gomave të përdoruara. Efekti negative në të ardhurat nga taksa doganore është 33 milionë LEK.

6. RREZIQET DHE MASAT PËR ZBATIMIN RIGOROZ TË BUXHETIT 2015

6.1 MOSREALIZIMI NË KOHË I INVESTIMEVE PUBLIKE

Qeveria ka marrë një sërë masash për të siguruar realizimin në kohë të tyre, duke filluar nga përgatitjet paraprake gjatë vitit 2014, deri tek alokimi i tyre në ditët e para të vitit 2015. Për vitin 2015 do të ndërmerren masat e mëposhtme për kryerjen në kohë të investimeve publike:

- Sistem monitorimi (*javor/mujor*) i cili do të verifikojë problematikën dhe do të propozojë masat për zgjidhje;
- Monitorimi i veçantë i portofolit të investimeve publike me impakt të gjerë, duke veçuar këtu projektet me impakt të ndjeshëm buxhetor, të cilat do të monitorohen sipas ecurisë së tyre në bazë javore për të siguruar realizimin e tyre në terma financiar dhe rrjedhimisht në plotësimin e objektivave të vendosura nga institucionet e linjës;
- Monitorim i veçantë për investimet prioritare, të cilat janë kostuar dhe buxhetuar në bashkëpunim të ngushtë me zyrat e jetësimit të prioriteteve pranë MZhETS dhe Kryeministrisë;
- Rialokime të fondeve buxhetore nga projektet me performancë të ulët në projektet me performancë më të lartë, duke konsideruar gjithashtu dhe mundësinë e rishikimit të ligjit të buxhetit 2015 për këtë qëllim.

Për pasojë të gjithë institucionet buxhetore kanë përgatitur paraprakisht listën e nevojave të tyre sa u përket investimeve prioritare në muajt e parë të vitit 2015, me synim për të arritur plotësimin e plotë të kushteve dhe afateve për zbatimin në kohë të këtyre investimeve dhe për faktorizimin e tyre në ekonomi.

6.2 VENDIMET GJYQËSORE/ÇËSHTJET E PRONËSISË

Shpenzimet për Kompensimin në Vlerë të ish-pronarëve. Shpenzimet për Kompensimin në Vlerë të ish-pronarëve për periudhën 2015-2017 parashikohen në masën 1.4 miliardë LEK në vit (*nga të cilat 1 miliardë LEK janë të ardhura nga ALUIZNI*). Ndërkohë që fatura e plotë është në proces llogaritje, buxheti i shtetit rëndohet gjatë vitit nga vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Strasburgut, të cilat pothuajse në të gjitha rastet janë në favor të paditësit, me një efekt financiar të konsiderueshëm. Vetëm për një vendim të tillë, në projektbuxhetin e vitit 2015 për Ministrinë e Financave parashikohet një fond në masën 1.2 miliardë LEK (*ekuivalent i 8 milionë EUR*). Në këto kushte, rezulton imediate marrja e masave nga ana e Ministrisë së Drejtësisë në drejtim të rishikimit të skemës aktuale të kthimit dhe kompensimit të pronave, si dhe të finalizimit të një pakete masash konkrete që duhet të marrë dakortësinë e Gjykatës Ndërkombëtare të Strasburgut. Grupi ndërministror që po punon për strategjinë dhe planin e masave, duhet të konsiderojë gjithashtu faktorin kohë për përfundimin e detyrës.

Një problematikë komplekse ka edhe zbatimin e **vendimeve gjyqësore që lidhen me aspekte të tjera** të menaxhimit në institucionet buxhetore dhe kanë kosto të konsiderueshme për buxhetin e shtetit. Miratimi së fundi i një udhëzimi të Këshillit të Ministrave siguron një proces të drejtë, transparent dhe eficient në zbatimin e vendimeve gjyqësore, por njëkohësisht rrit përgjegjshmërinë e institucioneve në mbrojtjen më të mirë dhe profesionale të interesave të shtetit. Roli i Avokaturës së Shtetit në këtë proces është tepër i rëndësishëm dhe do të rritet më tej me rritjen e kapaciteteve në burimet njerëzore dhe bazën ligjore e rregullatore përkatëse.

6.3 AKUMULIMI I DETYRIMEVE TE REJA

Një nga çështjet më problematike në sistemin tonë buxhetor u vërtetua se ishte akumulimi i detyrimeve të prapambetura të krijuara në vite dhe pamundësia e shlyerjes së tyre. Qeveria adresoi me prioritet çështjen e shlyerjes së tyre, por ndërkohë, me asistencën më të specializuar ndërkombëtare, ndërtoi edhe një sistem të plotë të parandalimit të akumulimit të detyrimeve të reja. Aktualisht, nëpërmjet një

udhëzimi të Ministrit të Financave, janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për kontrollin e kontratave shumëvjeçare. Në buxhetin e vitit 2015, për herë të parë, do të miratohen edhe tavanet e shpenzimeve për vitet 2016 dhe 2017 (*shiko Seksionin 6.1*), gjë që do të përforcojë sistemin e kontrollit të anagazhimeve buxhetore. Njëkohësisht, është në proces edhe ndërtimi i një sistemi informatik, pjesë e sistemit të thesarit, që do të shërbejë si një instrument për realizimin e kontrollit të anagazhimeve buxhetore.

6.4 ADMINISTRIMI I TË ARDHURAVE TATIMORE

Viti 2015 do të jetë viti i reformave të rëndësishme në mirë-administrimin tatimor, të cilat do të kenë në fokus të tyre uljen e evazionit fiskal dhe thjeshtëzimit të procedurave tatimore dhe doganore, të cilat do të ndikojnë dukshëm në rritejn e të ardhurave tatimore dhe doganore. Ndër më kryesoret mund të evidentohen.

Sistemi i ri IT - Aktualisht, administrata tatimore është duke zbatuar një reformë të plotë IT-je, e cila në thelb zëvendëson sistemin aktual të vjetëruar të sistemit të IT-së dhe bën rindërtimin e proceseve kyçe të administratës tatimore (si psh: regjistrimin e tatimpaguesve, rimbursimet e taksave, mbledhja e detyrimeve të prapambetura, auditimin, apelimet e taksapaguesve) në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, duke përfshirë edhe standardet e BE-së. Sistemi i ri do të ulë në mënyrë të ndjeshme mashtrimin dhe korrupsionin; do të bëjë edhe më të thjeshtë zbatimin e përjasjeve të manaxhimit të pajtueshmërisë, si dhe ndërmarrjen e iniciativave të reja politike. Ky sistem i ri:

- ✓ *thjeshton procedurat e pagesave të tatimpaguesve;*
- ✓ *lehtëson punën në bankat e nivelit të dytë të lidhura me përpunimin e pagesave të taksave;*
- ✓ *ndihmon në parandalimin e gabimeve gjatë kryerjes së pagesave, redukton shkëmbimet fizike të shkresave, ndërmjet bankave të nivelit të dytë dhe administratës tatimore, të cilat përmbajnë informacion në lidhje me pagesat; si dhe*
- ✓ *jep informacion në kohë reale mbi gjendjen e taksapaguesit. Përveç kësaj, tatimpaguesit nuk do t'i duhet më, që kryerjen e pagesës ta bëjë në një bankë, e cila ndodhet në territorin e asaj drejtorie rajonale tatimore ku ai është regjistruar. Pagesat mund të kryhen në çdo bankë të nivelit të dytë të territorit shqiptar.*

Në mënyrë të drejtpërdrejt, sistemi i ri i IT do të ulë dukshëm kohën dhe kostot administrative të biznesit për të deklaruar dhe paguar taksat, duke ndikuar kështu në përmirësimin e ndjeshëm të renditjes së Shqipërisë në këtë Raport. Në sajë të sistemit të ri të IT do të bëhet e mundur pagesa elektronike e tatimeve (e-payment) një reformë kjo e rëndësishme dhe shumë e kërkuar nga biznesi, e cila deri tashmë nuk ka mundur të bëhet efektive pikërisht për arsye të sistemit të vjetëruar të IT.

Ristrukturimi i administratës tatimore - Reforma do të përfshijë edhe rregullimin e strukturës organizative të administratës tatimore, qoftë në punën në zyrë, ashtu edhe në punën në terren. Në këtë mënyrë personeli do të çlirohet nga detyra të tilla siç është përpunimi i të dhënave IT, duke investuar më tepër në aktivitete që do të sjellin më shumë vlerë të shtuar si: shërbime ndaj taksapaguesve, auditime dhe investigime për zbulimin e mashtrimeve. Do të bëhet i mundur kalimi i punës nga një zyrë rajonale në një

tjetër në mënyrë që stafi të punojë në mënyrë më eficiente, si dhe për të lehtësuar centralizimin në më pak vende të aktiviteteve kyçe si: mbledhja e detyrimeve tatimore.

Menaxhimi i ri i riskut - Administrata tatimore ka filluar përpjekjet të zbatojë, gradualisht gjatë 2-3 vjeçarit të ardhshëm, një qasje moderne të menaxhimit të riskut, e cila do të jetë në të njëjtën linjë me modelin e pajtueshmërisë që është duke u mbështetur nga FMN, OECD dhe KE. Zbatimi i këtij modeli do të ndihmojë administratën tatimore që të kryejë detyrën e saj të menaxhimit të riskut në mënyrë më strategjike. Risia kryesore do të jetë rimbursimi i TVSH vetëm në bazë të analizës së riskut, e cila do të përshpejtojë procesin e rimbursimeve në kohë.

Organizimi i Lotarisë për kuponin tatimor - Gjatë vitit 2015 do të fillojë Lotaria lidhur me kuponin tatimor, nga e cila pritet një rritje e dukshme e interesimit të qytetarëve në tërheqjen e kuponëve tatimore, ç'ka do të sjellë rritje në të ardhurat nga TVSH.

Krijimi i një sporteli të vetëm për zhdoganimet. Sporteli i Vetëm për kontrollet doganore është një sistem që mundëson dhënien e informacionit nga ana e aktorëve të përfshirë në procedura doganore në mënyrë simultane, në të njëjtin vend dhe në formë të standartizuar. Subjektet paraqesin një mori liçencash/lejesh/autorizimesh, të cilat duhet të jenë në përputhje me rregullat kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me qarkullimin dhe tregtimin e mallrave. Përsa u përket elementeve të të dhënave që duhet të përmbajnë këto dokumentacione të nevojshme për zhdoganimin e mallrave, ka një koordinim të vogël mes institucioneve/agjencive të përfshira në proces. Për të dhënë një informacion pothuajse të njëjtë për institucione të ndryshme kompanitë duhet të paraqesin dokumenta të formateve të ndryshëm. Mungesa e standartizimit të të dhënave rezulton në uljen e eficientë dhe besueshmërisë, si për administratën ashtu edhe për sektorin privat. Kjo ndikon në kosto dhe kohë të lartë administrative për importuesit dhe administratën doganore. Zgjidhja e qëndrueshme dhe afatgjatë e këtij problemi do të jetë krijimi i sportelit të vetëm brenda një periudhë tre-vjeçare.

Krijimi i Kadastrës Fiskale, e cila do të evidentojë çdo pasuri të paluajtshme bashkë me vlerën e tregut në funksion të miradministrimit të takës së pasurisë. Krijimi i kësaj Kadastrë do të shoqërohet me rishikimin e sistemit të taksimit të pasurisë së paluajtshme duke kaluar nga taksë fikse për m² në përqindje mbi vlerën e tregut. Sipas vlerësimeve të FMN, kjo reformë do të sjellë rritje të të ardhurave të tatimit mbi pronën nga 0.13% të PBB-së në 0.55% të PBB-së.

Krijimin e “Database Kombëtare” si instrument i analizës së riskut në sistemin doganor, i cili do të minimizojë përdorimin e çmimeve të referencës.

Rritja e efektivitetit të mbledhjes së taksave përmes bashkërendimit dhe bashkëpunimit në **shkëmbimin e informacionit** midis dy Administratave Fiskale.


Aktualisht, Ministria e Financave ka disa **kontrata koncesionare** me operatorë privatë të lidhur në funksion të rritjes së të ardhurave tatimore dhe doganore. Këto kontrata janë duke u rishikuar me synimin e vlerësimit të efektshmërisë së zbatimit të tyre në funksion të arritjes së qëllimit për të cilin janë lidhur.

Përpos përmirësimeve administrative të listuara më sipër, një fokus i rëndësishëm për vitin 2015 do të vazhdojë të ketë **rritja e kapaciteteve të administratës tatimore dhe doganore** nëpërmjet trajnimit të

përhershëm të stafëve të dy administratave në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj tatimpaguesve. Deri tashmë, janë trajtuar nga Akademia e Trajnimeve të Administratës Tatimore dhe Doganore rreth 510 punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të Doganave dhe për tre muajt e mbetur të vitit do të bëhen trajnime intensive për 1540 punonjës të tjerë në fushat kryesore ku janë bërë ndërhyrje të rëndësishme legislative, si për shembull për Kodin e Ri Doganor, për ligjin e ri për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, për akcizën, etj. Për vitin 2015, janë parashikuar trajnime për 1500 punonjës tatimorë dhe doganorë.

6.5 MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

Për vitin 2015 dhe në vijim, objektivi kryesor i Menaxhimit të Borxhit Publik është përmirësimi i strukturës dhe rritja e qëndrueshmërisë së borxhit duke synuar sigurimin e huamarrjes së re nëpërmjet instrumentave afatgjatë dhe ripërsëritjen e instrumentave ekzistues. Zbatimi me sukses i kësaj strategjie garanton rritjen e jetëgjatësisë së borxhit, duke thelluar raportin midis instrumentave afatgjatë dhe afatshkurtër deri në 58% me 42% në fund të vitit 2016, duke ulur kështu ndjeshëm riskun e ri-financimit dhe riskun e normave të interesit.



Në të njëjtën kohë synohet edhe ruajtja e balancës midis kostos dhe riskut, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron tregu i brendshëm në momente të caktuara, nëpërmjet fleksibilitetit të kalendarit të emetimeve. Realizimi i objektivave të mësipërme synon rritjen e jetëgjatësisë së portofolit të borxhit të brendshëm. Në këtë kuadër, i një rëndësie të veçantë është edhe rifinancimi i Eurobond-it të emetuar në vitin 2010, nëpërmjet daljes dhe shfrytëzimit të oportuniteteve në tregun ndërkombëtar të instrumentave financiare. Emetimi i këtij instrumenti nuk ndikon përse i përket nivelit të stokut të borxhit, por emetimi me sukses do të ishte një garanci më shumë përse i përket përmirësimit të strukturës së borxhit dhe në të njëjtën kohë ri-afirmimit të Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Ministria e Financave ka vlerësuar prej një kohë të gjatë dhe ka qënë në mënyrë të vazhdueshme në komunikim me tregun dhe pjesëmarrësit e tij, duke synuar përgatitjen dhe njohjen e tregut në avancë, për ti shërbyer një rezultati pozitiv në emetimin e Eurobondit dhe kredencialeve të vendit.

Përse i përket mbajtësve të borxhit për vitin 2015, pritshmëritë janë pozitive në kuadër të diversifikimit të portofolit të borxhit. Gjatë vitit të ardhshëm pritet një rënie në stokun e borxhit të mbajtur nga bankat kryesore dhe një rishpërndarje e kësaj peshe tek institucionet e tjera bankare dhe jo bankare.

Gjatë vitit 2015 pritet që të ketë një rritje të normave të interesit për instrumentat financiare shtetërore. Rritje më të lartë pritet që të ketë në segmentin e instrumentave afatgjata, për shkak të ristrukturimit të portofolit të investitorëve (kryesisht sektori bankar) dhe orientimit drejt instrumentave afatshkurtra, në kuadër të uljes së ekspozimit ndaj riskut dhe direktivave nga bankat mëma. Gjithashtu edhe huazimi në monedhën Euro pritet që të shtrenjtohet, pasi parashikimet flasin për një rritje të Euribor-it gjatë vitit 2015. Për sa më sipër dhe për shkak të shtesës në stok, shërbimi i borxhit gjatë vitit të ardhshëm pritet që të jetë më i lartë krahasuar me vitin aktual.

Lidhur me tregun të jashtëm, huamarrja e huaj do të bazohet në financimet e pritshme të projekteve ekzistuese, si edhe të projekteve të reja për të cilat Qeveria është angazhuar me kreditorët. Gjithashtu, financimi i huaj pritet të plotësohet nga financimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, sipas marrëveshjes për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Është duke u vlerësuar edhe mundësia që gjatë vitit 2015 të emetohet dhe një instrument i ri (Policy Based Guarantee) nga Banka Botërore me qëllim uljen e financimit të brendshëm. Ky instrument i kombinuar me politikat e Qeverisë për shlyerjen 100% të detyrimeve të prapambetura, të cilat përmirësojnë nivelin e kredive problematike (NPL) do të krijonte kushte të favorshme për kreditimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të biznesit shqiptar.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe garancive të brendshme për sektorët e vlerësuar si prioritarë (sektori i energjisë), të cilat pritet që të rriten në 15.5 miliardë LEK gjatë vitit 2015.

Ministria e Financave, është duke punuar gjithashtu për të përmirësuar kuadrin ligjor lidhur me rritjen e fleksibilitetit të huamarrjes me instrumenta financiare me qëllim që shtetit shqiptar ti jepet një qasje në tregjet financiare ndërkombëtare duke synuar në uljen e kostos së huamarrjes shtetërore.

7. CILËSIA E FINANCAVE PUBLIKE

7.1 PLANIFIKIMI BUXHETOR AFATMESËM

Për herë të parë, ligji i buxhetit të vitit 2015 përfshin edhe një parashikim të tavaneve buxhetore mbi bazë programesh buxhetore për periudhën buxhetore 2016-2017 (*Tabela 1 e projektligjit*). Kjo risi, jo vetëm që konsolidon më tej procesin e buxhetimit afatmesëm, por bën të mundur edhe disiplinimin e parashikimeve të detyrimeve kontraktuale që i zgjasin efektet e tyre financiare përtej një viti buxhetor. Në këtë mënyrë, çdo njësi shpenzuese është e detyruar të planifikojë kontrata shumëvjeçare në atë nivel që i lejon tavani buxhetor i përcaktuar për tre vitet e ardhshme në ligjin vjetor të buxhetit. Për të garantuar respektimin dhe kontrollin automatik të këtyre limiteve, Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) parashikohet të modifikohet përgjatë fundit të vitit 2014 deri në fillim të vitit 2015. Synimi final është që të eliminohet çdo mundësi për krijim detyrimesh kontraktuale të reja, të cilat nuk janë të mbuluara me fondet përkatëse buxhetore.

7.2 BUXHETIMI MBI BAZË PERFORMANCE

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të përgatisin kërkesat e tyre buxhetore

afatmesme konform rregullave dhe procedurave të frymëzuara nga praktikat më të mira në fushën e buxhetimit mbi bazë performance. Përgjatë vitit 2015 synohet që, krahas monitorimit dhe raportimit të saktë dhe rigoroz të treguesve të performancës të specifikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2015-2017 nga ana e njësisve të qeverisjes qendrore, të përmirohet më tej cilësia e përzgjedhjes së këtyre treguesve në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2016 - 2018.

Gjithashtu, me mbështetjen e donatorëve të huaj, do të mundësohet që në vitin 2016 të futet në funksion të plotë një sistem i ri informatik i Menaxhimit të Financave Publike (AFMIS), i cili do të integrojë të gjitha sistemet aktuale që shërbejnë për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit. Zbatimi i plotë i këtij sistemi të integruar do të mundësojë një hop cilësor në planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit mbi baza programore dhe performance.

7.3 REFORMA NË MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE

Shqipëria ka hyrë në një proces reformimi të menaxhimit të financave publike që synon zhvendosjen e fokusit nga inputet tek rezultatet. Kuadri konceptual dhe legal për këtë qëllim është i përcaktuar me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr.10296 datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Ekziston një plan 5-vjeçar për zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin (MFK) për periudhën 2011-2016, i cili synon të testojë aspekte të ndryshme të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, të caktuara si pilot, përgjatë një cikli të plotë buxhetor. Rezultatet e këtij projekti pilot do të përdoren për të shtrirë zbatimin e rregullave dhe procedurave të reja të MFK në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, deri në fund të afatit të këtij plani e më tej.

Reforma në Menaxhimin e Financave Publike do të bashkërendohet me Reformën e Administratës Publike, e cila po përgatitet nga Departamenti i Administratës Publike. Synimi është, që nëpërmjet politikave të rekrutimit dhe promovimit mbi bazë meritash dhe performance në administratën publike, të forcohen elementët e besimit dhe ndershmërisë mbi të cilat mbështetet përgjegjshmëria menaxheriale në sektorin publik. Reforma në Menaxhimin e Financave Publike do të zbatohet në harkun kohor prej 7 vitesh (2014 - 2020) dhe do të bazohet në gjashtë shtylla: (i) Kuadër Fiskal i qëndrueshëm dhe i kujdesshëm; (ii) Planifikim dhe buxhetim i mirë-integruar dhe eficient i shpenzimeve publike; (iii) Ekzekutim eficient i buxhetit; (iv) Raportim transparent i financave publike; (v) Kontroll i brendshëm efektiv; (vi) Mbikëqyrje e jashtme efektive e financave publike.

7.4 REFORMA E ENERJISË

Sektori energjetik në Shqipëri është përballur me një mori problemesh strukturore dhe financiare gjatë viteve të fundit. Me qëllim adresimin e disa problemeve të natyrës emergjente, qeveria shqiptare ka ndërmarrë disa masa për të mundësuar përmirësimin e situatës së rënduar financiare të tre operatorëve të sistemit energjetik. Humbja mesatare e vitit 2013 ka qenë rreth 45% e energjisë totale të futur në rrjet, ndërkohë që objektivi i vitit 2014 (40% mesatarja vjetore) pritet të tejkalohet duke u ulur në 39%. Vlen për t'u theksuar se reforma e thellë e këtij sektori strategjik kërkon kohë, burime financiare të konsiderueshme, si dhe mbështetje të vazhdueshme institucionale. Efektet e pritshme në periudhën afatmesme dhe afatgjatë përmbledhen në dy shtylla kryesore të shoqëruara me masat respektive si më poshtë:

- **Rritja e të ardhurave të sektorit:**

- Nëpërmjet uljes konstante të humbjeve në sektorin e shpërndarjes mesatarisht me 5% në vit. Vlen për t'u theksuar këtu se Qeveria tashmë i ka shpallur luftë vjedhjes së energjisë elektrike, duke përcaktuar një plan urgjent masash për reduktimin dhe eliminimin e këtij fenomeni të përhapur ndër vite. Zbatimi i këtij plani do të vijojë të intensifikohet dhe më shumë gjatë vitit 2015.
- Ristrukturim i çmimit të blerjes së energjisë prej HEC-ve koncesionare.
 - ✓ *Ristrukturim i tarifave për konsumatorët familjarë;*
 - ✓ *Ristrukturim i tarifave për bizneset.*
- Rritja e arkëtimeve prej debitorëve dhe zvogëlim i detyrimeve të prapambetura;
- Subvencionim i drejtpërdrejt për shtresat në nevojë prej buxhetit të shtetit;
- Arkëtim i detyrimeve të prapambetura prej institucioneve dhe shoqërive publike.

Një vend të veçantë në këtë reformë do të ketë edhe riparimi dhe meremetimi i turbinave të Hidrocentraleve të Kaskadës së Drinit, në kuadër të projektit të Bankës Botërore në sistemin energjetik, duke riparuar për herë të parë turbinat e HEC-ve të mëdha të Drinit.

- **Shërbim më i mirë ndaj qytetarëve:**

- Krijimi i kushteve për përdorim më të gjerë të burimeve të rinovueshme:
 - ✓ *Garantim i aksesit në rrjet;*
 - ✓ *Prioritet i dispeçerimit të energjisë prej burimeve të rinovueshme;*
 - ✓ *Lehtësim procedurash autorizimi, dhe përjashtimi i detyrimit për pajisje me licencë për burimet e vogla deri në 1 MW.*
- Krijimi i kushteve për zhvillimin e burimeve të reja prodhuese në përputhje me kushtet mjedisore:
 - ✓ *Respektim i kushteve mjedisore për burimet e reja, dhe monitorim i respektimit të tyre prej burimeve tashmë në shfrytëzim;*
 - ✓ *Përcaktimi i kriterit mjedisor si kusht themelor në zhvillimin e burimeve prodhuese;*
 - ✓ *Zbatimi i standardeve bashkëkohore në fuqi.*

7.5 REFORMA E PENSIONEVE

Në zbatim të ligjit nr. 104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, gjatë vitit 2015 do të intensifikohen përpjekjet për përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të skemës së pensioneve, duke synuar minimizimin e subvencionit buxhetor. Synohet që të përsosen me tej procedurat dhe proceset e mbledhjes së kontributeve, si dhe shpërndarjes së drejtë të tyre në formën e përfitimeve, aty dhe atëherë kur lind e drejta. Gjithashtu, synohet garantimi i mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elemente të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme. Do të fillojë për herë të parë të zbatohet Pensioni Social, i cili parashikohet t’u akordohet qytetarëve shqiptarë, mbi moshën 70 vjeç, të cilët nuk kanë të ardhura të tjera të përfituara nga pasuritë, trashëgimitë, të ardhura nga investimet, etj. Në

vitet e para, numri i përfituesve që i përket kësaj kategorie parashikohet të jetë rreth 5,000 persona me një kosto vjetore prej rreth 400 milionë LEK në vit.

7.6 SHLYERJA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA DHE PARANDALIMI I KRIJIMIT TË DETYRIMEVE TË REJA

Nisur nga situata e vështirë në të cilën u gjendën financat publike, në shtator 2013 qeveria e re filloi punën me identifikimin e problematikave, ku spikasnin detyrimet e konsiderueshme financiare nga institucionet buxhetore dhe pamundësia e shlyerjes së tyre me buxhetin aktual. Detyra e parë ishte identifikimi dhe vlerësimi i tyre. Për këtë arsye në muajin tetor 2013 u kontraktua një shoqëri e pavarur ndërkombëtare për të ndërmarrë një proces vlerësimi në lidhje me kontratat qeveritare të pashlyera deri në fund të muajit gusht 2013. Nga vlerësimet paraprake, detyrimet e përgjithshme financiare të prapambetura të qeverisjes qendrore deri në dhjetor 2013 u parashikuan afërsisht 72.6 miliardë LEK ose 5.3 për qind e PBB-së. Në vitin 2014, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura planifikohen të shpenzohen 35 miliardë LEK, ndërkohë që për vitin 2015 planifikohen të shlyhen rreth 20 miliardë LEK detyrime të prapambetura.





Procesi i deritanishëm i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura i ka dhënë impakt pozitiv zhvillimit ekonomik të vendit, duke marrë në konsideratë që pjesa dërmuese e këtyre detyrimeve ka qenë ndaj bizneseve dhe kompanive të mëdha. Bizneset dhe kompanitë private, nëpërmjet këtij procesi kanë mundur të shlyejnë detyrimet dhe pagesat që kanë pasur ndaj furnitorëve, punonjësve dhe bankave. Shlyerja e detyrimeve ndaj kompanive, ka pasur efekt edhe në shlyerjen e detyrimeve fiskale që këto të fundit kanë pasur ndaj administratës tatimore, detyrime të cilat kanë qenë të konsiderueshme dhe i janë kthyer buxhetit të shtetit në formë të ardhurash, për të shërbyer më pas për investime dhe shërbime të ndryshme. Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e pagesave të kryera në kuadër të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, kompanitë përfituese e kanë përdorur për vazhdimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të aktivitetit, ç'ka sjell efekte pozitive edhe në rritjen e punësimit nga këto kompani.

Zhvillimi dhe zbatimi i strategjisë për eliminimin e pjesës së detyrimeve të prapambetura dhe ndërmarrja e masave për të parandaluar akumulimin e mëtejshëm në të ardhmen është një hap i rëndësishëm për të rikthyer ekonominë të një rritje e fuqishme në të mirë të të gjithë qytetarëve brenda një periudhe afatmesme dhe afatgjatë, si dhe për të ndërtuar një marrëdhënie të re partneriteti dhe besueshmërie me qytetarët dhe kompanitë e ndryshme.





8. SHTOJCAT ILUSTRUESE



8.1 TREGUESIT E PËRZGJEDHUR MAKROEKONOMIKË DHE FISKALË

Kritja reale e PBB ne vendet e rajonit (ne %)	2009	2010	2011	2012	2013	T1-2014	T2 -2014
Shqipëria	3.4	3.7	2.5	1.6	1.4	1.7	-0.6
Maqedonia	-1.0	2.8	3.0	-0.4	2.2	3.5	4.3
Mali i ZI	-5.7	2.5	3.2	-2.5	3.3	1.5	0.3
Serbia	-3.1	0.6	1.4	-1.0	2.6	0.1	-1.1
Turqia	-4.8	9.2	8.8	2.1	4.1	4.7	2.1
Bosnja dhe Hercegovina	-2.7	0.8	1.0	-1.2	2.1	2.7	:
Kosova	3.6	3.3	4.4	2.8	3.4	:	:



Tregtia e jashtme	Eksportet Jan-Gusht 2014 / 2013		Importet Jan-Gusht 2014 / 2013	
	Rritja (në %)	Kontributi në rritje (në pikë %)	Rritja (në %) mujore	Kontributi në rritje (në pikë %)
Ushqime, pije, duhan	10.9	0.6	-0.8	-0.1
Minerale, lëndë djegëse, en.elektrike	-8.1	-3.4	6.3	1.1
Produkte kimike dhe plastike	20.3	0.2	3.4	0.5
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	-7.2	-0.1	32.7	0.7
Prodhime druri dhe letre	25.5	0.7	11.6	0.5
Tekstile dhe këpucë	25.3	7.2	19.4	2.0
Materiale ndërtimi dhe metale	10.9	1.5	9.3	1.1
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	-2.8	-0.1	8.3	1.5
Të tjera	18.4	0.3	21.2	0.6
Gjithsej	7.0	7.0	7.9	7.9





Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
					Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8
Inflacioni (mesatar)	%	3.5	2.0	1.9	1.9	2.6	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	2.3	1.0	0.8	1.4	2.5	2.8	3.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	100.9	108.2	105.7	105.0	105.0	105.0	105.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	140.5	139.0	140.3	140.0	140.0	140.0	140.0
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit te Fuqisë Blerese	Lek / USD	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5
Rritja reale e PBB	%	2.5	1.6	1.4	2.1	3.0	4.0	4.5
PBB	Lek miliardë	1,300.6	1,335.5	1,365.6	1,413.4	1,492.1	1,596.0	1,718.1
PBB	USD miliardë	12.9	12.3	12.9	13.5	14.2	15.2	16.4
PBB	Euro miliard	9.3	9.6	9.7	10.1	10.7	11.4	12.3
PBB për banor	Lek mijë	457.5	474.3	489.9	507.0	535.2	572.5	616.3
PBB për banor	USD	4,534.1	4,384.1	4,635.3	4,828.7	5,097.6	5,452.8	5,869.8
PBB për banor	Euro	3,255.8	3,412.7	3,492.4	3,621.5	3,823.2	4,089.6	4,402.3
PBB për banor	USD-PPP	10,064.5	10,434.0	10,776.8	11,153.8	11,775.0	12,595.5	13,558.6
Norma e papunësisë	%	14.3	14.1	17.1	17.5	16.5	15.3	13.7
Të ardhurat totale	% të PBB	25.4	24.7	24.0	26.0	27.5	27.6	27.7
Shpenzimet totale	% të PBB	28.9	28.2	28.9	31.2	31.5	30.6	29.0
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-3.5	-3.4	-4.9	-5.2	-4.0	-3.0	-1.3
Bilanci primar fiskal	% të PBB	-0.4	-0.3	-1.7	-2.4	-0.5	0.4	2.0
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	1.9	1.2	-0.1	-1.4	1.2	2.0	3.9
Huamarrje totale neto	% të PBB	3.5	3.5	4.1	5.2	4.0	3.0	1.3
Borxhi Publik Total	% të PBB	59.4	62.1	70.0	70.9	70.6	68.5	65.5
<i>Borxhi publik i qeverise se pergjithshme</i>	% të PBB	55.7	58.1	61.0	64.1	64.7	63.5	60.3
<i>Borxhi publik jashte treguesve fiskale</i>	% të PBB	3.7	4.0	9.0	6.8	5.9	5.0	5.2

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, FMN, BB

8.2 ZHVILLIMET FISKALE GJATË 9-MUJORIT 2014

Buxheti i konsoliduar - Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 9-mujore arritën në 266.7 miliardë LEK, ose 31 miliardë LEK më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë, me një rritje prej 13.2%.

E M Ē R T I M I	Në milion lekë			
	Fakt	Fakt	Diferenca	
	2013	2014	Fakt 2014 Fakt 2013	% kundrejt Fakt 2013
TOTALI TË ARDHURAVE	235,668	266,736	31,068	13.2%
Të ardhura nga ndihmat	3,552	7,457	3,905	109.9%
Të ardhura tatimore	214,664	243,289	28,625	13.3%
Nga Tatimet dhe Doganat	162,167	186,643	24,476	15.1%
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	79,103	91,925	12,822	16.2%
Tatimi mbi Fitimin	11,552	16,109	4,557	39.4%
Akcizat	25,405	29,297	3,892	15.3%
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	21,700	20,476	-1,224	-5.6%
Taksa Nacionale dhe të tjera	20,344	24,587	4,243	20.9%
Taksa Doganore	4,063	4,249	186	4.6%
Të ardhura nga Pushteti Vendor	8,096	9,693	1,597	19.7%
Taksë mbi Pasurinë(ndertesat)	1,981	2,890	909	45.9%
Taksë mbi Biznesin e vogël	1,513	1,540	27	1.8%
Taksa Lokale	4,602	5,263	661	14.4%
Të ardhura nga fondet speciale	44,401	46,953	2,552	5.7%
Sigurimi Shoqëror	37,895	40,853	2,958	7.8%
Sigurimi Shëndetsor	4,972	5,990	1,018	20.5%
Të ardhura për kompensim në vlerë të	1,534	110	-1,424	-92.8%
Të ardhura Jotatimore	17,452	15,990	-1,462	-8.4%
Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	4,293	1,951	-2,342	-54.6%
Të ardhura nga Inst.Buxhetore	7,824	8,168	344	4.4%
Dividenti	927	1,381	454	49.0%
Tarifat shërbimeve	2,321	2,396	75	3.2%
Të tjera	2,087	2,094	7	0.3%

Burimi: Ministria e Financave

- Të ardhurat nga Grantet arritën në 7.4 miliardë LEK ose 3.9 miliardë më shumë se 9-mujori 2013;
- Të ardhurat nga tatimet dhe doganat janë rreth 186.6 miliardë LEK, ose 24.4 miliardë LEK më shumë se 9-mujori 2013, me një rritje prej 15 për qind më shumë krahasuar me një viti më parë;
- Të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 9.7 miliardë LEK ose rreth 1.6 miliardë LEK më shumë se 9-mujori 2013, me rritje vjetore prej 20 për qind me shumë;
- Të ardhurat nga fondet speciale arritën 46.95 miliardë LEK, ose 2.55 miliardë LEK më shumë se 9-mujori 2013, me një rritje vjetore 6 për qind;
- Të ardhurat jo-tatimore kanë qenë për këtë periudhë rreth 16 miliardë LEK, ose 1.4 miliardë LEK më pak se 9-mujori 2013, me rënie vjetore prej -8 përqind.

Shpërndarja e të ardhurave sipas burimit - Në periudhën janar-shtator 2014 të ardhurat tatimore përbëjnë rreth 91.2 për qind nga 91.4 për qind të të ardhurave në buxhetin e konsoliduar në periudhën e vitit të kaluar, grantet rreth 2.8 për qind nga 1.2 për qind vitin e kaluar, dhe të ardhurat jo-tatimore 6 për qind nga 7.4 për qind të totalit në buxhetin e vitit 2013.

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat - Për 9-mujorin 2014, ato kanë rritur peshën e tyre në totalin e të ardhurave të buxhetit të shtetit. Kështu për 9-mujorin 2013, të ardhurat nga tatimet dhe doganat përbënin 68.8 për qind të totalit të të ardhurave të buxhetit të shtetit, ndërsa për 9-mujorin 2014 janë rritur me 1.2 për qind, duke përbërë kështu 70 për qind. Sipas agjencive të mbledhjes, administrata doganore ka mbledhur 110.4 miliardë LEK, ose 12.7 miliardë LEK më shumë se 9-mujori 2013, me një rritje vjetore prej 13.1 për qind. Administrata tatimore ka mbledhur 121 miliardë LEK, ose 15.9 miliardë LEK më shumë se 9-mujori 2013, me një rritje vjetore prej 15.2 për qind.

TË ARDHURAT NGA TATIMET DHE DOGANAT PËR JANAR-SHTATOR 2014				
<i>Të dhena progresive (në milion Lekë)</i>				
E M Ë R T I M I	Fakt	Fakt	Diferenca	
	2013	2014	Fakt 2014 Fakt 2013	Fakt 2014 Fakt 2013
Taksë doganore	4,064	4,249	185	4.6%
TVSH	62,354	71,477	9,123	14.6%
Akcizë	25,149	29,295	4,146	16.5%
Të tjera (Renta)	6,074	5,377	-697	-11.5%
Totali i doganave	97,641	110,398	12,757	13.1%
TVSH	16,752	20,448	3,696	22.1%
Akciza	259	1	-258	-99.6%
Tatim mbi fitimin	11,554	16,109	4,555	39.4%
Tatimi mbi të ardhurat personale	21,694	20,476	-1,218	-5.6%
Taksa nacionale	14,272	19,210	4,938	34.6%
Totali i tatimeve	64,531	76,244	11,713	18.2%
Kontributet e mbledhura nga DP	40,572	44,824	4,252	10.5%
Totali i Përgjithshëm i DPT	105,103	121,068	15,965	15.2%

Burimi: Ministria e Financave

ANALIZA SIPAS TË ARDHURAVE

Tatimet mbi konsumin: Tatimi mbi Vlerën e shtuar - Nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar janë mbledhur gjithsej për 9-mujorin 91.9 miliardë LEK ose 16.2 për qind më shumë se një vit më parë, nga të cilat 77.8 për qind është TVSH e mbledhur në import dhe 22.35 për qind TVSH e mbledhur brenda vendit, duke ndryshuar raportin e varësisë së të ardhurave nga TVSH import/e brendshme me 1,1 për qind. Për 9-mujorin 2013, të ardhurat nga TVSH në import përbënin 78.8 % të TVSH totale dhe TVSH e brendshme përbënte 21.2 për qind. Kjo lëvizje e vogël drejt rritjes së TVSH së brendshme tregon rritje të qarkullimit të brendshëm të mallrave dhe shërbimeve.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar në import

- TVSH e mbledhur në import për 9-mujorin 2014 është 71.4 miliardë LEK ose 9.1 miliardë LEK më shumë se 9-mujori 2013. Vlera e importeve është rritur me 11 për qind në krahasim me 9-mujorin 2013, ndërsa sasia e importeve është rritur me 4.2 për qind.



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

- Përgjatë gjithë muajve të vitit 2014, rritja nga TVSH në import ka qënë konstante dhe e fortë, çfarë tregon për një performacë të mirë të administratës doganore, duke marrë këtu në konsideratë edhe faktin se Paketa Fiskale 2014, si dhe gjatë vitit 2014, janë ndërmarrë politika përjashtuese nga pagesa e TVSH në funksion të zhvillimit të sektorëve të veçantë të ekonomisë, në përputhje me programin e Qeverisë.
- Minuset e krijuara nga këto politika jo vetëm që nuk kanë ndikuar në uljen e të ardhurave nga TVSH në import, por në saj të mirëadministrimit doganor është arritur mbulimi i këtyre efekteve negative dhe është arritur një mbi-performancë për këtë zë.

Kështu, vetëm për 9-mujorin 2014, janë dhënë 3.5 miliardë LEK përjashtime nga TVSH në import nga 1.1 miliardë LEK përjashtime të akorduara në vitin 2013, pra 2.4 miliardë LEK më shumë. Nga ky total, 2.25 miliardë LEK TVSH i janë lënë “cash” biznesit si rezultat i përjashtimit / shtyrjes nga TVSH e makinerive dhe pajisjeve me synim rritjen e industrializimit të sektorëve të prodhimit në vend dhe uljes së kostove të investimit. Ndërsa rreth 1.2 miliardë LEK përjashtime nga TVSH e barnave janë dhënë për periudhën prill - shtator 2014, në reflektim të qartë të programit të qeverisë për heqjen e TVSH së barnave me synimin uljen e çmimeve të ilaçeve për pacientët.

Tabela : Përjashtimet/shtyrje TVSH

	TVSH e përjashtuar për Makineritë dhe Pajisjet	TVSH e Shtyrë	TVSH e llogaritur për Barnat pas hyrjes në fuqi të ndryshimit ligjor	TVSH e Përjashtuar për Importin e Stolive prej Floriri
Janar	84,231	37,412	0	4,041
Shkurt	87,801	26,476	0	10,916
Mars	79,985	76,034	0	9,474
Prill	240,942	64,509	282,746	2,518

Maj	120,370	157,853	192,051	14,466
Qershor	156,804	132,446	223,891	160
Korrik	231,562	68,667	195,660	11,448
Gusht	110,095	46,424	157,165	7,861
Shtator	171,601	106,007	145,652	9,787
Progresiv 2014	1,535,542	715,829	1,197,165	70,673
Progresiv 2013	483,941	582,461	0	44,369
Diferenca	1,051,601	133,367		26,304
Diferenca në %	217	23		59

Për 9-mujorin 2014 TVSH e brendshme arriti në shumën 20.4 miliardë LEK ose 3.7 miliardë LEK më shumë se 9-mujori 2013. Në këtë 9-mujor, TVSH është duke arritur nivelin e TVSH së brendshme e planifikuar të vitit 2014. Performanca pozitive në këtë zë ka ardhur si rezultat i punës së mirë të administratës tatimore në mirë-administrimin tatimor. Në bazë të të dhënave të 8-mujorit 2014 nga administrata tatimore, pothuajse të gjithë sektorët e ekonomisë kanë performuar me rritje nga TVSH-ja, në krahasim me 8-mujorin 2013, të tillë si:

- sektori i ndërtimit me një rritje 14.6 %;
- sektori i transportit me rritje prej 40.3%;
- sektori i tregtisë me rreth 287.7%; rritje kjo e cila ka ardhur kryesisht në bazë të punës së mirë administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale nga tatimpaguesit;
- sektori i shërbimeve me rritje 34.8%;
- Rënie të dukshme ka pasur sektori i prodhimit me minus 86.4 %.

Nga muaji shkurt 2014 filloi zbatimin procedura e re e rimbursimit nëpërmjet sistemit të thesarit të shumave të TVSH, e cila siguron korrektesën në zbatimin e afateve ligjore për rimbursimin e TVSH me synimin e moskrijimit të detyrimeve të prapambetura. Konkretisht, për periudhën në raportim, shuma e rimbursimit të TVSH-së ka arritur në 5.9 miliardë LEK. Për 9-mujorin 2014 janë rreth 13,377 tatimpagues të TVSH nga 12,003 tatimpagues që kanë qenë në 9-mujorin 2013, me një rritje prej 11.4 për qind të numrit të tatimpaguesve të TVSH ose thënë ndryshe, 1,377 subjekte janë formalizuar gjatë kësaj periudhe.

Tatimet mbi konsumin: Akciza - Të ardhurat gjithsej nga Akciza për periudhën janar – shtator arritën në rreth 29.3 miliardë LEK; 13 për qind më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013. Nga mallrat e forta rezultojnë me rënie të ndjeshme kundrejt 9-mujorit të një viti më parë, cigaret dhe birra, përkatësisht me -8.8 % dhe -8.2 % dhe me rritje karburantet dhe kafja, përkatësisht me 9.6% dhe 4.7%. Ulja e importeve të birrës është e shoqëruar me dukurinë e rritjes së prodhimit vendas, ku vlen të përmendet ulja e importeve të birrës dhe e rritjes njëkohësisht të prodhimit vendas për këtë artikull.



Tabela : Importi i mallrave të forta, për periudhën janar-shtator 2014


Produktet	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Karburante	335,410				313,726	343,902

		362,327	309,277	313,387		
Cigare	3,279	3,056	2,263	2,555	2,291	2,089
Kafe	5,050	4,428	4,915	5,946	5,223	5,472
Birrë	29,708	28,847	25,338	24,134	22,640	20,777
% e rritjes						
Karburante		8.02%	-14.64%	1.33%	0.11%	9.62%
Cigare		-6.81%	-25.95%	12.90%	-10.34%	-8.81%
Kafe		-12.31%	10.99%	20.97%	-12.16%	4.76%
Birrë		-2.90%	-12.17%	-4.75%	-6.19%	-8.23%

Ulja e importeve të cigareve për 9-mujorin 2014 është i argumentuar në kuadër të rritjes së importeve në muajin e fundit të vitit 2013, në masën 174%, krahasuar me dhjetor 2012, duke krijuar stok për muajt e parë të vitit 2014, si rezultat i lançimit të Paketës Fiskale 2014, me rritje të akcizës së cigareve.

Grafikët e mëposhtëm japin një përmbledhje të importeve dhe prodhimit vendas të produkteve të akcizës.





Gjithashtu, në analizën e të ardhurave nga akciza duhet të argumentojmë se në uljen e tyre ndikim ka pasur edhe “akciza e sektorit hidrokarbur”. Nga 1 prill 2014, hyri në fuqi dispozita ligjore e heqjes së përjashtimit nga akciza e produkteve energjitike të përdorura për nevojat e veta nga sektori hidrokarbur. Nga heqja e këtij përjashtimi, u vlerësua rreth 3.5 miliardë LEK të ardhura shtesë në totalin e të ardhurave nga akciza. Mirëpo, për periudhën prill – shtator 2014, nga kompania Bankers janë paguar vetëm 538 milionë ose minus 1.8 miliardë LEK nga parashikimi i periudhës.

Taksimi i tregtisë ndërkombëtare: Taksa doganore - Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën janar – shtator 2014 janë rreth 4.2 miliardë LEK dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013, të ardhurat nga kjo taksë janë rritur me 6 për qind. Rritja e të ardhurave nga taksa doganore është e shoqëruar me argumentin e rritjes së importeve dhe të ardhurave nga TVSH, për arsye se niveli mesatar i taksimit, për shkak të zbatimit të Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë është ulur nga 1.4 për qind në 1.3 për qind.

Taksimi i të ardhurave: Tatimi mbi të Ardhurat Personale - Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 20.5 miliardë LEK për periudhën janar-shtator, ose 1.2 miliardë LEK më pak se 9-mujori 2013, me një ulje vjetore prej -5.6 për qind. Ky zë ka ecur mirë për periudhën 8-mujore 2014 me një minus prej vetëm 0.33 miliardë LEK. Ecuria e mirë e këtij tatimi bazohet në faktin se më këtë zë përfshihen disa taksa, ku më e rëndësishmja dhe më me peshë në totalin e kësaj takse, është tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi. Nga 1 janar 2014, tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi u ul për rreth 97 % të totalit të të punësuarve në rang vendi, politikë kjo e cila solli një kosto negative në të ardhurat nga kjo takse, të vlerësuara me minus 1.5 miliardë LEK (tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi). Nga të dhënat e 8-mujorit 2014, konstatohet se efekti negativë në të ardhura është më i thellë, sepse vetëm për 8-mujor, janë krijuar minus 1,5 miliardë LEK nga kjo taksë në krahasim me të ardhurat e 8-mujorit 2013, që duke shtuar edhe minusin e vlerësuar prej -1.5 miliardë LEK vjetor, konstatohet se efekti negativ nga kjo masë është shumë i madh. Kjo ulje në të ardhura shihet kryesisht tek të ardhurat e sektorit publik, për të cilët paga mesatare është 56 mijë LEK, çka do të thotë se norma efektive e tatimit mbi pagën për këtë kategori të punësuarish është më e

vogël se 10%, pra 1.8 miliardë LEK të ardhura më shumë janë akorduar për të gjithë punonjësit e administratës publike në saj të politikës qeverisëse për ulje e tatimit mbi pagën.

Ndërsa, nëse shohim të dhënat e tatimit mbi pagën për sektorin privat, konstatohet se janë rritur të ardhurat me vetëm 174 milionë LEK për 8-mujorin 2014/8-mujorin 2013. Kjo për arsye, se taksa progresive është shoqëruar me fenomenin e nëndeklarimit të pagesës reale në sektorin privat për efekt të pagimit të një taksë më të ulët. Përgjatë 8 muajve të parë të vitit 2014, vërehet se pavarësisht nga ulja në të ardhura e kësaj takse, në saj të mirëadministrimit tatimor, të gjithë zërat e tjerë të tatimit mbi të ardhurat personale kanë pasur një trend rritës në krahasim me 8-mujorin 2013, të tilla si: tatimi mbi dividendin dhe aksionet është rritur me 6.8% për 8-mujorin 2014, në krahasim me 8-mujorin 2013.

Krahasimi i te Ardhurave *nga D. Përgjithshme e TATIMEVE per periudhen 08-Mujore 2014*

Njesia ne 000 L

	Periudha 08 - M U J O R E			
	FAKTET		Diferenca 2014 - 2013	
	2013	2014	+ ose -	Pergjindje
TATIMI mbi te ARDHURAT PERSONALE	19,422,538	18,294,340	(1,128,199)	-5.8%
<i>Nga i cili:</i>				
<i>Nga te punesuarit e Sektorit Publik</i>	6,132,724	4,410,987	(1,721,737)	-28.1%
<i>Nga te punesuarit e Sektorit Privat</i>	5,820,762	5,995,517	174,755	3.0%
<i>Tatim mbi te Ardhurat nga Interesat :</i>	2,322,011	1,851,516	(470,495)	-20.3%
<i>Tatim mbi te Ardhurat nga Qerate dhe Enfiteoza :</i>	713,776	734,337	20,561	2.9%
<i>Tatim mbi Fituesit e Lodra ve te Fatit</i>	15,086	67,095	52,009	344.8%
<i>Tatim mbi A.Personale Biznesi Vogel me xhiro 2-8 mln leke</i>	166,147	192,001	25,854	15.6%
<i>Te tjera Tatime mbi te Ardhurat ne Burim</i>	1,789,089	1,934,363	145,273	8.1%
<i>Tatimi mbi te ardhurat nga Dividentet dhe Aksionet</i>	1,959,426	2,092,872	133,446	6.8%
<i>Tatim mbi te Drejten e Autorit dhe Pronesise Intelektuale</i>	0	0	0	0.0%
<i>Tatimi mbi Shitjen e Pasurise se Paluajtshme (nga individet)</i>	449,595	923,354	473,758	105.4%
<i>Tatimi mbi Trashegimine dhe Dhurimin</i>	0	0	0	0.0%
<i>Tatimi mbi Deklaraten Individuale Vjetore te te ardhurave</i>	53,922	92,299	38,377	71.2%

Kështu:

- Të ardhurat nga tatimet në burim janë rritur me 8.1% për 8-mujorin 2014 në krahasim me 8-mujorin 2013;
- të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme janë rritur me 105.4% për 8-mujorin 2014 në krahasim me 8-mujorin 2013, rritje kjo e ndikuar nga post ligji i faljes, i cili përfshiu rivlerësimin e pasurisë;
- ndërsa tatimi mbi interesat është ulur me -20.3% në krahasim me të dhënat e vitit të kaluar, si rezultat kjo edhe i rënies së normave të interesit.

Taksimi i të ardhurave nga biznesi – Për 9-mujorin 2014, të ardhurat nga tatim fitimi dhe tatimi i thjeshtuar nga biznesi i vogël arritën në 17.6 miliardë LEK, që përbën vetëm 7.2 për qind të të ardhurave tatimore në total. Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 9-mujorin 2014 arritën në rreth 16.1 miliardë LEK nga 11.5 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rritje prej 39.4 për qind, 7.9% më pak se plani i periudhës janar-shtator 2014. Tatimi mbi fitimin ka pasur politikë fiskale gjatë vitit 2014 me rritje të normës së tatimit mbi fitimin nga 10% në 15%, duke

filluar nga 1 janar 2014. Në bazë të të dhënave të 9-mujorit 2014, kjo taksë ka ecur sipas planifikimit dhe vlerësimeve fillestare të impaktit të reformës. Të gjithë sektorët e ekonomisë kanë ecur mirë me këtë zë, me përjashtim të sektorit shtetëror. Planifikimi fillestar për një rritje prej 7 miliardë LEK nga rritja e normës së tatimit mbi fitimin është në trend realizimi. Mosrealizimi i periudhës prej rreth 1 miliard LEK ka ardhur nga dy kompanitë e mëdha KESH dhe CEZ (aktualisht OSHEE), të cilat vitin e kaluar kanë paguar tatim fitimin po në masën rreth 1 miliard LEK (500 milionë LEK ka paguar KESH dhe 556 milionë LEK ka paguar CEZ (OSHEE)). Ndërsa për 8-mujorin 2014, KESH nuk ka paguar tatim fitimin, ndërsa OSHEE ka paguar vetëm 157 milionë LEK. Duhet theksuar se në këtë zë, për 8-mujorin 2014 është rritur numri i tatimpaguesve me rreth 911 tatimgues të rinj të TF, në sajë të përmirësimeve administrative të administratës tatimore.

Të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël arritën 1.5 miliardë LEK, me një rritje prej 190% më shumë se planifikimi i periudhës dhe në të njëjtin nivel me 9-mujorin 2013. Kjo mbi-performancë e të ardhurave nga ky zë ka ardhur si rezultat i reformës që Qeveria ndër morri në 1 janar të këtij viti, ku u hoq tatimi mbi biznesin e vogël (taksë vendore) dhe tatimi mbi të ardhurat personale në masën prej 10% u zëvendësua me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin në masën 7.5% ose sa $\frac{1}{2}$ e tatimit të ri mbi fitimin. Sipas parashikimeve, u vlerësua nga këto ulje të taksave për biznesin e vogël, efekti neto do të ishte minus 800 milionë LEK në të ardhurat e pushtetit vendor. Me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të pushtetit vendor, në buxhetin e vitit 2014, u shtuan 800 milionë LEK, në formën e transfertave të pakushtëzuara për pushtetin vendor.

Përpos kësaj reforme të ndryshimit të taksave, ndryshoi dhe administrimi i kësaj takse, i cili i kaloi Administratës Tatimore Qendrore. Në saj të këtyre ndryshimeve të rëndësishme, rezultatet e 9 muajve të parë të këtij vitit tregojnë për një rritje të dukshme jo vetëm të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogël, por edhe të taksave të tjera lokale. Kjo është tërësisht e lidhur me rritjen e kapaciteve njerëzore të njësive të qeverisjes vendore në rritjen e performancës së tyre në mbledhjen e taksave vendore, të cilat për herë të parë janë realizuar sipas parashikimeve fillestare.

Taksimi i pasurisë - Për qëllime analize, këtu përfshijmë tatimin mbi ndërtesat dhe mbi tokën bujqësore. Për 9-mujorin taksat mbi pasurinë arrijnë në 2.9 miliardë LEK nga 2.8 miliardë LEK të parashikuara dhe 46 për qind më të larta se një vit më parë. Kjo taksë ka përbërë një ndër taksat më të keqperformuara në sistemin tatimor të pushtetit vendor dhe mbiperformanca e kësaj takse për 9-mujorin e 2014 lidhet jo vetëm me rritjen e taksës së ndërtesës për bizneset si pjesë e Paketës Fiskale 2014, por edhe me rritjen e kapaciteve të pushtetit vendor në mbledhjen e taksave të veta, kapacitete këto të krijuara nga mosmbledhja më e taksës së biznesit të vogël dhe fokusimi i punës së administratës tatimore të pushtetit lokal tek mbledhja e taksave vendore.

Lloji i te Ardhurave	FAKTET			
	2013	2014	Dif 2014/2013	Në % 2014/2013
TATIMI per LODRAT EFATIT DHEKAZINOTE	2,304,193	3,446,985	1,142,792	49.6%
Takse per Regjistrimin e Lodra ve te Fatit, Llotarive etj.	11,400	16,800	5,400	47.4%
Takse per Perdorimin e Aparateve Telefonike	0	0	0	
Takse per Lejen e Ushtrimit te Veprimtarise se Peshkimit	7,501	11,899	4,398	58.6%
Takse e Karbonit per benzinen, benzolin dhe gazoilin	1,404,614	1,544,261	139,646	9.9%
Takse per Ambalazhet Plastike te lengjeve te ambalazhuara	528,707	107,889	(420,818)	-79.6%
Takse e perdorimit Truallit Shteteror nga Individet	1,026	3,168	2,142	208.8%
Takse e perdorimit T. Shteteror nga Persona Juridik Tregtar	256	205	(51)	-19.8%
Takse e ambalazheve njeperdorimshe te plastikes e qelqit (dc	184,940	899,198	714,258	386.2%
Takse e mjeteve te Perdorura te Transportit	2,880,000	2,036,682	(843,318)	-29.3%
Takse Portuale	397	516	120	30.2%
Taksa e Akteve dhe e Pulles	335,266	233,261	(102,005)	-30.4%
Taksa e Rentes Minerare, Karieres + Shfryt. L. Drusore	566,786	874,383	307,597	54.3%
Taksa per Shfrytezimin e Nentokes	0	0	0	
Takse per Veprimet Gjyqsore dhe Ligjore:	203,592	677,849	474,257	232.9%
TAKSA e Qarkullimit	2,631,977	7,002,633	4,370,656	166.1%
Totali	11,060,654	16,855,730	5,795,076	52.4%

Taksat nacionale - Të ardhurat nga taksat nacionale në total për periudhën janë 24.6 miliardë LEK ose 4.2 miliard LEK më shumë se 9-mujori 2013, me një rritje vjetore prej 20.9 për qind. Të ardhurat nga Taksat nacionale ndahen në dy grupime: të ardhura nga taksa nacionale, që i mbledh administrata tatimore dhe të ardhurat nga renta minerale në eksport që i mbledh administrata doganore. Të ardhurat nga taksa nacionale, i planifikohen planit total të të ardhurave të administratës tatimore, por në fakt, me përjashtim të rentës dhe taksës së lojrave të fatit, të gjithë taksat e tjera mbledhen nga agjentë të ndryshëm tatimorë, të cilët i derdhen më pas tek administrata tatimore. Kështu, në këtë grup të ardhurash, rritje të dukshme kanë të ardhurat nga taksa nacionale, që mbledhen nga vet administrata tatimore, jo nëpërmjet agjentëve, të cilat evidentojnë edhe fokusin e përqendrimit të administratës tatimore në sektorët respektivë, të tillë si lojërat e fatit, të cilat janë rritur me 49 % dhe renta minerale që shitet brenda vendit, me një rritje prej 307%.

Të ardhurat nga renta minerare në eksport për 9-mujor 2014 janë realizuar në masën 5.3 miliardë LEK, ose rreth 670 milionë LEK më pak se 9-mujor 2013, me një ulje vjetore prej 11.5%. Rënia e të ardhurave nga renta minerare në eksport është ndikuar nga ulje të eksporteve të produkteve minerare, si dhe rënie të çmimeve. **Ky mosrealizimi i rentës minerare** është tërësisht i lidhur me performancën e industrisë nxjerrëse përpunuese që varet nga faktorë rregullatorë të brendshëm, cilësia e produktit të shitur dhe konjunkturave të tregut ndërkombëtar.

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore - Të ardhurat nga fondet speciale për periudhën janar – shtator 2014 arritën në 46.95 miliardë LEK, ose 3.9 miliardë LEK më shumë se 9-mujori 2013, me një rritje vjetore prej 14.2 %. Ky grup të ardhurash përbën rreth 19.3 për qind të të ardhurave tatimore gjithsej për këtë periudhë. Nga totali i fondeve speciale, rreth 46.8 miliardë LEK janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 110 milionë LEK të ardhura për kompensimin në vlerë të pronarëve. Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 40.8 miliardë LEK dhe nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 6 miliardë LEK. Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në totalin e tyre kanë pasur një ecuri pozitive të të ardhurave për 9-mujorin e parë të vitit 2014. Performanca e të ardhurave të kontributeve shoqërore është e lidhur me përmirësimin administrativ nga administratat tatimore

në rritjen e numrit të kontribuesve në skemë, në sajë të përmirësimit të shërbimit ndaj tatimpaguesve dhe rritjes së vizitave fiskale. Kështu, referuar të dhënave të administratës tatimore, për muajin gusht 2013, numri mesatar i kontribuesve ka qenë 442,086, ndërsa për gusht 2014 ka qenë 477,358, pra janë 35,272 kontribues të rinj në skemë.


Të ardhura të tjera vendore - Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën janar-shtator arritën 9.7 miliardë LEK nga 7.6 miliardë LEK të planifikuara, ndërsa kundrejt 9-mujorit të vitit 2013 të ardhurat janë rritur me rreth 20 për qind. Taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogël dhe taksat mbi pasurinë të cilat përmenden më sipër) kanë mbledhur rreth 5.3 miliardë LEK nga 4 miliardë LEK të parashikuara.

Të ardhura jo tatimore - Të ardhurat jo tatimore përbëjnë 6 për qind të totalit të të ardhurave. Kategoritë më të rëndësishme të këtij grupi janë: transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë, të ardhura nga dividendi, tarifat e shërbimeve dhe të ardhurat nga institucionet buxhetore. Për 9 mujorin 2014 të ardhurat jo tatimore janë 16 miliardë LEK, me rënie kundrejt periudhës së vitit 2013 me -8 për qind. Kontributin kryesor për këtë rezultat duket se e ka dhënë transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë.

8.3 ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN JANAR-GUSHT 2014

Zbatimi i buxhetit të shtetit në kohë dhe në respekt të autorizimeve ligjore, përveçse një faktor orientues, kontribuon dhe nxit ekonominë nëpërmjet realizimit të shpenzimeve publike. Në këtë kuadër, realizimi efektiv dhe në kohë i shpenzimeve buxhetore, sipas planit të dakordësuar edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar është një prioritet i qeverisë. Zbatimi i buxhetit për periudhën janar - gusht 2014, reflekton performancën e rritur të administratave tatimore dhe doganore, duke kontribuar kështu në stabilitetin e shpenzimeve publike. Në ndryshim nga vitet e kaluara shpenzimet buxhetore të këtij viti karakterizohen nga një qëndrueshmëri si pasojë e një parashikimi më realist i të ardhurave publike. Rishikimi i buxhetit të vitit 2014, në ndryshim nga vitet e fundit, është i vetmi buxhet që karakterizohet nga një rritje e të ardhurave prej rreth 3 miliardë LEK, të cilat shkojnë në reduktim të deficitit buxhetor.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, në fund të muajit gusht 2014, arritën në rreth 267.3 miliardë LEK, nga 297.9 miliardë LEK të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në 89.7 për qind të parashikimit të periudhës, ose me një mosrealizim prej 30.5 miliardë LEK. Krahasuar me planin vjetor, këto shpenzime janë realizuar 58.6 për qind, ndërsa kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, shpenzimet buxhetore rezultojnë 2.2 miliardë LEK më shumë ose rreth 0.8 për qind më të larta.



Në vijim të masave të marra nga Qeveria për stabilizimin e financave publike, prioritet ka qenë edhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura ndaj biznesit privat. Për periudhën në fjalë janë paguar 25.9 miliardë LEK detyrime të prapambetura, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e ekonomisë dhe sistemin bankar.

Me buxhetin e periudhës janar-gusht 2014, ndër të tjera janë realizuar:

Në fushën e arsimit:

- Reforma në arsimin e lartë është përqendruar në monitorimin dhe vlerësimin ligjor të arsimit publik dhe privat, si dhe hartimin e kuadrit ligjor “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”.
- Është mundësuar rritja me 3-5% e numrit të fëmijëve që frekuentojnë arsimin parashkollor.
- Janë krijuar kushte për transportin e rreth 30.000 nxënësve që mësojnë në një distancë prej më shumë se 2 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, si dhe rreth 11.000 mësuesve që punojnë në më shumë se 5 km larg nga vendbanimi i tyre.
- Janë rimbursuar shpenzimet e blerjes së teksteve shkollore për rreth 120 mijë nxënës ose për rreth 25% të totalit të nxënësve.
- Janë krijuar kushtet për zhvillimin e maturës shtetërore të rreth 45,000 maturantëve, me një standard të ri sigurie dhe cilësie.
- Janë dhënë bursa ushqimore për rreth 3,500 nxënës me aftësi të kufizuara dhe për nxënësit që vijnë nga familjet në nevojë, si dhe për 8,000 studentë me aftësi të kufizuara dhe nga familjet në nevojë.
- Është financuar:
 - Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rreth 100 objekteve arsimore;
 - Ndërtimi i 46 mjediseve sportive në të gjithë vendin;
 - Bashkëfinancuar ndërtimi i stadiumit “Elbasan Arena”;
 - Ndërtimi i Parkut Olimpik të Tiranës;
 - Projekti e-learning dhe tableta për nxënësit.

Në fushën e shëndetësisë:

- Është kryer kostimi i 10 paketave për sëmundjet më të rëndësishme të zemrës dhe veshkave, duke bërë të mundur financimin e pacienteve edhe në spitalet private;
- Është hequr TVSH për medikamentet dhe materialet mjekësore;
- Është dyfishuar fondi për mjekimin kemioterapik në Shërbimin e Onkologjisë;
- Janë blerë pajisje për modernizimin e kardiokirurgjisë;
- Është blerë një CT skaner për Spitalin e Traumës;
- Është kryer për herë të parë pas 25 vjetësh dezinfektimi i zonave ligationore të vendit;
- Është realizuar një ndërhyrje e rëndësishme në infrastrukturën e disa spitaleve si:
 - *Ndërtimi i ri i Spitalit Psikiatrik në Vlorë;*
 - *Kompletimi dhe shndërrimi i ish-Sanatoriumit në Spital Universitar;*
 - *Ndërhyrje në patologjinë e barrës në Maternitetin “Koço Gliozheni”.*

Në fushën e rendit dhe mbrojtjes:

- Rritja e pagave të forcave policore për rreth 1 miliard LEK, gjë e cila ka efekte të drejtpërdrejta në rritjen e sigurisë për qytetarin dhe biznesin.
- Janë mundësuar operacione në zona të ndryshme për luftimin e krimit të organizuar dhe të lëndëve narkotike si p.sh. operacionet në Lazarat dhe Shkodër.
- Mbështetja e strukturave të shërbimit policor me mjete dhe pajisje të ndryshme për një vlerë rreth 370 milionë LEK.
- Është investuar në modernizimin e shërbimit të gjendjes civile.
- Mbështetje me mjete dhe pajisje për forcat e armatosura (helikopterë).

Në fushën e infrastrukturës dhe transportit:

- Për periudhën 8-mujore janë investuar mbi 1 miliardë LEK në projektet e sinjalistikës në të gjithë akset kombëtare.
- Kanë vijuar punët në projektet e mëdha kombëtare të ndërtimit dhe rikonstruksionit të rrugëve.
- Sektori i ujësjellës kanalizimeve po i nënshtrohet një reforme të thellë strukturore me synim rritjen e efikasitetit të sektorit.

Në fushën e energjisë

- Zgjidhja e mosmarrëveshjes me CEZ sh.a., duke realizuar edhe kalimin e kuotave të aksioneve në favor të qeverisë shqiptare.
- Janë reduktuar problematikat e menaxhimit të energjisë (furnizimi, humbjet etj.)
- Janë implementuar projekte që promovojnë përdorimin me efikasitet të energjisë.
- Janë kryer studime gjeofizike për ripërcaktimin e rezervave të naftës dhe të gazit në përputhje me standardet e BE-së.
- Është miratuar strategjia e shlyerjes me kompensim të detyrimeve të energjisë elektrike ndërmjet institucioneve publike.
- Është realizuar mbikëqyrja dhe monitorimi i aktivitetit mineral që ka mundësuar përmirësimin e performancës të subjekteve minerare në kuadër të shfrytëzimit efektiv të

rezervave minerare, kryesisht në objektet e kromit, rërat dhe zhavorret bituminoze gëlqerore. Ka vijuar puna për digjitalizimin e të dhënave minerare


Në fushën e turizmit dhe strehimit:

- Nxitja dhe zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm nëpërmjet licencimit, standardizimit, certifikimit të shërbimeve turistike dhe luftës kundër informalitetit vijojnë të jenë prioritete.
- Janë zhvilluar fushata informuese dhe promovuese për imazhin e ri të Shqipërisë turistike.
- Është krijuar Agjencia Kombëtare e Bregdetit.
- Është investuar për:
 - *Projektet e investimeve për rehabilitimin e qendrave të qyteteve;*
 - *Gjelbërimin e zonave bregdetare nëpërmjet mbjelljes së ullinjve;*
 - *Gjelbërimin e rrugës Durrës-Vlorë, dhe sidomos*
 - *Projekti i Lungomare-s në Vlorë,*
- Në funksion të strehimit social është investuar për banesat e grupeve të disavantazuara rome dhe egjiptiane në bashkitë e Lezhës, Përmetit dhe Lushnjës.


Në fushën e zhvillimit të bujqësisë

- Në programin e zhvillimit rural, vijon mbështetja për prodhimin bujqësor, blegtoral, dhe agroindustrial.
- Janë rritur sipërfaqet e mbjella bujqësore dhe po ndërtohen 12 rrugë rurale deri në fund të vitit 2014.
- Vijojnë fushatat e gjurmimit dhe vaksinimit dhe masat e tjera parandaluese kundër sëmundjeve të transmetueshme nga kafshët.
- Është përmirësuar infrastruktura e kullimit dhe ujitjes


Shpenzimet korrente në fund të muajit gusht 2014, kanë arritur në 214.6 miliardë LEK. Krahasuar me planin vjetor këto shpenzime janë realizuar 61.4 për qind, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, këto shpenzime rezultojnë 2.4 miliardë LEK më të ulta ose rreth 1.1 për qind më pak.




Shpenzimet e Personelit, përfaqësojnë 21.9 për qind të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara gjatë periudhës janar - gusht 2014, rezultojnë pothuajse në nivelin e parashikimit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë shpenzimet e personelit rezultojnë 606 milionë LEK më të larta, ose 1.3 për qind më shumë.




Shpenzimet për paga janë rreth 1 për qind më të larta se një vit më parë ose 391 milionë LEK më shumë, ndërkohë që shpenzimet për kontributet për sigurimet shoqërore janë 215 milionë LEK më shumë ose 3.4 për qind më të larta, se një vit më parë. Ndërkohë që shpenzimet për pagat rezultojnë 0.4 për qind nën nivelin e parashikimit të periudhës, shpenzimet për sigurimet shoqërore janë realizuar 1.7 për qind nën këtë nivel, duke qenë në të njëjtën kohë përkatësisht shpenzimet për paga 65.5 për qind e planifikimit vjetor dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore 64.6 për qind e këtij planifikimi.




Shpenzimet për interesa përfaqësojnë rreth 12.4 për qind të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara gjatë periudhës janar-gusht 2014, rezultojnë me një kursim kundrejt parashikimit të periudhës, prej rreth 2.6 miliardë LEK, rrjedhojë kjo e kursimit për rreth 2.1 miliardë LEK në interesat e brendshme dhe rreth 500 milionë LEK në interesat e jashtme. Kundrejt planit vjetor interesat janë realizuar në rreth 57.2 për qind, ndërsa krahasuar me një vit më parë ato rezultojnë rreth 1.8 miliardë LEK më të ulta ose rreth 6.4 për qind më pak.



Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes gjatë periudhës janar - gusht 2014 arritën në 17.7 miliardë LEK, duke qenë rreth 2.2 miliardë LEK nën nivelet e parashikuara. Në të njëjtën kohë ato rezultojnë 50.6 për qind të planit vjetor.




Shpenzimet për subvencione në fund të muajit gusht 2014 arritën në 824 milionë LEK ose 145 milionë LEK më pak se parashikimi, duke arritur në 51.5 për qind të planit vjetor. Krahasuar me vitin e kaluar këto shpenzime rezultojnë 192 milionë LEK më të ulta ose 18.9 për qind më pak.




Shpenzimet për fonde speciale gjatë periudhës janar - gusht 2014 rezultojnë rreth 670 milionë LEK më shumë apo rreth 0.8 për qind mbi nivelin e parashikimit të periudhës. Kundrejt planit vjetor shpenzimet për fondet speciale janë realizuar në nivelin 65.8 për qind, nga të cilat sigurimet shoqërore janë realizuar 65.4 për qind të planit vjetor, sigurimet shëndetësore 68.4 për qind dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve 80.9 për qind të këtij plani. Krahasuar me një

vit më parë shpenzimet për sigurimet shoqërore rezultojnë 3.6 miliardë LEK më të larta ose 5.7 për qind më shumë, ndërsa shpenzimet për sigurimet shëndetësore rezultojnë 3.2 miliardë LEK më të larta, ose 17.1 për qind më shumë. Shpenzimet për kompensimin e pronarëve në fund të muajit gusht 2014 rezultojnë 306 milionë LEK nën parashikimin e periudhës. Krahasuar me një vit më parë këto shpenzime rezultojnë 590 milionë LEK më shumë ose 83.8 për qind më të larta.




Shpenzimet e pushtetit vendor zunë 8 për qind të shpenzimeve korrente. Për periudhën janar-gusht 2014 ato kanë arritur në 17 miliardë LEK, nga 21.2 miliardë LEK të planifikuara për këtë periudhë të vitit 2014, duke rezultuar me një kursim prej rreth 4 miliardë LEK ose rreth 19 për qind nën parashikimin e periudhës. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime kanë arritur 51.7 për qind të tij. Krahasuar me një vit më parë këto shpenzime rezultojnë 2.2 miliardë LEK më të ulta ose 11.5 për qind më shumë.



Pagesa e papunësisë është realizuar në rreth 90 për qind të parashikimit të periudhës, ose 65.2 për qind e parashikimit vjetor. Ky zë i shpenzimeve rezulton të jetë rreth 107 milionë LEK më shumë ose rreth 19.6 për qind më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Ndihma ekonomike gjatë periudhës janar - gusht 2014 rezulton rreth 927 miliardë LEK më shumë ose rreth 6.8 për qind mbi parashikimin e periudhës, duke qënë në të njëjtën kohë rreth 77

për qind e planit vjetor. Kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë ndihma ekonomike rezulton rreth 775 miliardë LEK më shumë ose rreth 5.6 për qind më e lartë.




Kompensimi për të prindjekurit politike, në fund të muajit gusht 2014, arriti 267 milionë LEK, ose 633 milionë LEK më pak se parashikimi i periudhës, duke qenë në të njëjtën kohë rreth 24 për qind e planit vjetor. Kundrejt një viti më parë këto shpenzime rezultojnë rreth 2.6 miliardë LEK më të ulta.

Shpenzimet kapitale deri në fund të muajit gusht 2014 janë realizuar në rreth 40 për qind të planit vjetor. Brenda këtyre shpenzimeve, investimet me financim të brendshëm janë realizuar në masën 59.3 për qind, ndërkohë që investimet me financim të huaj janë realizuar në masën 78.3 për qind të parashikimit të periudhës tetë mujore. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar investimet e brendshme rezultojnë rreth 16.8 miliardë LEK më të ulta ose rreth 62.2 për qind më pak, ndërkohë që investimet me financim të huaj rezultojnë rreth 4.5 miliardë LEK më të ulta ose rreth 21.3 për qind më pak. Për rrjedhojë, investimet në total në fund të muajit gusht 2014 janë rreth 44.2 për qind më të ulta ose rreth 21.3 miliardë LEK më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Struktura e investimeve kapitale të realizuar gjatë periudhës janar-gusht 2014 është rreth 38 për qind nga financimi i brendshëm dhe rreth 62 për qind nga financimi i huaj.



8.4 SHPJEGIME MBI TRANSFERTËN E PAKUSHTËZUAR E PUSHTETIT VENDOR

Çështjet bazë që lidhen me transfertën e pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore janë:

- *Përcaktimi i madhësisë së transfertës, dhe*
- *Kriteret e formulës për shpërndarjen ndërmjet bashkive, komunave dhe qarqeve.*

Nga eksperiencia e deritanishme, shumica bazë e transfertës së përgjithshme, në përgjithësi ka ndjekur rritjen e buxhetit të përgjithshëm. Në vitin 2015, konstatohet një ndryshim në lidhje me transfertën e qeverisjes vendore e cila kushtëzohet nga disa elementë shtese si: 1) reforma territoriale dhe periudha e tranzicionit, deri në hyrjen në fuqi të ndarjes së re administrative, 2) politikat e kufizimit të shpenzimeve të ndjekura nga qeveria në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Gjithsesi, pavarësisht elementëve të sipërcituar, në përcaktimin e madhësisë së transfertës, janë marrë në konsideratë: funksionet transferuar tek njësitë e qeverisjes vendore, fondet respektive për to, si dhe rregullimet specifike mbi bazë vjetore, bazuar në transferimin e taksave. Specifikisht për vitin 2015, transfertat e pakushtëzuar do të vazhdojnë të ndahet në 373 NJQV, sipas kriterëve të mësipërme, por duke rifreskuar të dhënat për popullsinë, kapacitetet fiskale dhe tregues të tjerë të varfërisë.

Transferta e Pakushtëzuar 2005-2015

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Totali i Transfertës së pakushtëzuar	7,3	8,3	9,0	10,5	12,9	11,3	11,1	11,2	11,7	12,6	11,9
Shpërndarë për Bashkitë dhe Komunitat	6,5	7,5	8,1	9,5	11,8	10,2	10,1	10,1	10,6	11,4	10,8
Shpërndarë për Qarqet	0,6	0,1	0,8	0,9	1,1	0,9	0,9	1,0	1,0	1,1	1
Kompensimi	0,2	0,1	0,0	0,0	0,1	0,1	0,1	0,1	0,2	0,2	0,15
Kompensimi në % kundrejt totalit	2,1%	0,8%	0,4%	0,3%	0,6%	1,1%	1,0%	1,0%	1,5%	1,4	1,3

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2015

Emërtimi	Njësia	Viti 2015
1. Fondi i Transfertës së Pakushtëzuar të Përgjithshme	000/LEK	12.455.000
2. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve	000/LEK	12.189.000
Totali i Transfertës	000/LEK	24.644.000

Përmirësimi i formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2015

- Të dhënat e popullsisë për vitin 2015, janë marrë nga “Regjistri themeltar i shtetasve” i Gjendjes Civile, e konkretisht të dhënat për muajin shtator 2014.
- Në transfertën e pakushtëzuar janë përfshirë:
 - *Fonde për administrimin e konvikteve të arsimit parauniversitar;*
 - *Fonde për administrimin e katër qendrave të shërbimit të kujdesit social.*
- Të ardhurat nga biznesi i vogël dhe taksa e automjeteve të përdorura për efekt të kapacitetit fiskal janë llogaritur nga të dhënat faktike të vitit 2013.
- Niveli minimal për frymë, për vitin 2015 do të jetë:
 - *për bashkitë, 2.960 LEK/frymë,*
 - *për komunat 2.000 LEK/frymë.*
- Bashkitë Berat dhe Gjirokastrë, që bëjnë pjesë në UNESCO janë trajtuar me një koeficient favorizues financimi.

Për vitin 2015, parashikohet që të ardhurat e pushtetit vendor të jenë 41.2 miliardë LEK.

Në milion LEK

	Emërtimi	Vitet	
		2014	2015
I	Shpenzimet e Pushtetit Vendor	33.129	41.207
	Financuar nga:		
1	Buxheti i shtetit	19.156	24.644
	Nga i cili		
1,1	<i>Transferta e Pakushtëzuar</i>	13.356	12.455
2	Taksa të ndara (rentë minerare)	800	400
3	Burimet Vendore	10,673	13.563
	Nga të cilat:		
3.1	<i>Taksat dhe tarifatat vendore</i>	5.931	8,066
3.2	<i>Taksa mbi pasurinë</i>	3.542	4.017
3.3	<i>Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël</i>	1.200	1.480
4	Të ardhura jo tatimore	2.500	2.600

Për vitin 2014, shifrave të tabelës së mësipërme u shtohet edhe transferta me burim të huaj (FSHZH) që investohet tërësisht për infrastrukturë vendore, si dhe fondet për zhvillimin e rajoneve të ministrive të linjës. Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore parashikohet të jenë rreth 18.5 për qind më të larta se ato të vitit 2014 ose 2.6 miliardë LEK më shumë se një vit më parë. Ky buxhet, ndërsa rrit mundësinë për të ardhura më të mëdha vendore, përfaqëson një reformë me risqe minimale. Buxheti është i bazuar në përvojat e fituara të njësisve të qeverisjes vendore në administrimin e taksave vendore dhe mbështetet në një bazë taksash solide e me të ardhura në rritje, brenda një parashikimi të përgjithshëm të rritjes ekonomike. Ky buxhet motivon zyrtarët vendorë për të kontribuar në përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave, duke përfshirë nxitjen e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet administratave tatimore qendrore dhe vendore.

8.5 ECURIA E BORXHIT PUBLIK PËR PERIUDHËN JANAR-GUSHT 2014

Ecuria e stokut të borxhit publik - Borxhi publik i Qeverisë Qëndrore në fund të muajit shtator 2014, vlerësohet të jetë 960,801 milion LEK ose 68.05% i PBB. Ky borxh përbëhet nga borxhi i brendshëm dhe i jashtëm që janë vlerësuar përkatësisht 39.30% dhe 28.74% i PBB. Ndërkohë, ky borxh deri në fund të vitit 2014 pritet që të arrijë në nivelin 70.07% ose 72.65% në raport me PBB duke përfshirë edhe detyrimet e prapambetura. Peshën më të madhe për sa i përket rritjes do ta ketë borxhi i brendshëm. Në tabelën e mëposhtme paraqitet ecuria e përbërjes së borxhit publik të Qeverisë Qëndrore nga viti 2010, ndërkohë që është përfshirë edhe parashikimi për fundin e vitit 2014.

Në milion LEK	2010	2011	2012	2013	Shtator 2014	Dhjetor 2014 (Prsh)
Stoku Borxhit Gjithsej (I+II)	715,371.01	772,516.93	827,980.79	884,692.28	960,801.24	989,379.39
I.Stoku Borxhit Brendshëm	407,371.80	438,582.00	470,358.47	520,786.36	554,934.19	580,185.80
-shtetëror	401,821.00	429,924.80	454,695.37	500,868.36	533,820.35	551,977.80
-garantuar	5,550.80	8,657.20	15,663.10	19,918.00	21,113.84	28,208.00
II. Stoku Borxhit Jashtëm	307,999.21	333,934.93	357,622.32	363,905.92	405,867.05	409,193.59
-shtetëror	268,124.46	294,275.97	319,832.52	332,499.72	376,267.73	380,302.75
-garantuar	39,874.75	39,658.96	37,789.80	31,406.20	29,599.33	28,890.84
PBB	1,222,462	1,282,300	1,326,000	1,358,000	1,412,000	1,412,000
Stoku Borxhit Gjithsej/PBB	58.52%	60.24%	62.44%	65.15%	68.05%	70.07%
Stoku Borxhit Brendshëm/PBB	33.32%	34.20%	35.47%	38.35%	39.30%	41.09%
Stoku Borxhit Jashtëm/PBB	25.19%	26.04%	26.97%	26.80%	28.74%	28.98%
Stoku Borxhit Gjithsej+ Arrears/PBB				70.41%	71.27%	72.65%

Politika për financimin e deficitit të buxhetit ka çuar në plotesimin e nevojave për huamarrje të brendshme në tregun vendas gjatë vitit 2014. Konkretisht, në fund të muajit shtator huamarrja e brendshme rezultoi në 32.95 miliardë LEK ose 72% të totalit të financimit me huamarrje të brendshme të planifikuar për vitin 2014. Ndërkohë, nëse i referohemi rishikimit të buxhetit për vitin 2014, huamarrja e brendshme u rrit me 5.3 miliardë LEK duke bërë që realizimi i financimit të brendshëm të përllogaritet në nivelin e ri prej 65%.

Financimi gjatë vitit 2014 është realizuar kryesisht nëpërmjet emetimit të obligacioneve dhe raporti ndërmjet instrumentave afatgjatë dhe atyre afatshkurtër të titujve qeveritare vlerësohet në nivelet 78 me 22%. Huamarrja gjatë këtij viti nuk është realizuar plotësisht nëpërmjet instrumentave afatgjatë për shkak të vështirësive të hasura në treg si rrjedhojë e perceptimit të riskut kundrejt instrumentave me afat të gjatë maturimi, kryesisht nga ana e institucioneve bankare.

milion LEK	Mars 2014	Qershor 2014	Shtator 2014
Financimi i Deficitit	8,659.80	21,419.10	32,952.71
Instrumenta Financiare Gjithsej	8,659.80	21,419.10	32,952.71
Bono Thesari Gjithsej	2,116.30	10,413.90	7,310.07
-Bono Thesari Lekë	2,116.30	10,413.90	8,550.93
-Bono Thesari Euro	0.00	0.00	-1,240.86
Obligacione Gjithsej	6,543.50	11,005.20	25,642.65
Obligacione Lëkë	6,543.50	11,005.20	20,311.85
- Oblig.e qeverise 2 vjecare	1,118.90	1,846.00	-508.45


- Oblig.e qeverise 3 vjecare	-1,867.40	-1,170.50	-377.00
- Oblig.e qeverise 5 vjecare	1,329.00	-170.30	924.70
- Oblig.e qeverise 7 vjecare	3,963.00	6,897.70	10,562.40
- Oblig.e qeverise 10 vjecare	2,000.00	3,602.30	9,710.20
Obligacione Euro	0.00	0.00	5,330.80

Huamarrja e re në periudhën janar-shtator të vitit 2014 pavarësisht ndryshimeve në peshat e instrumentave të përdorur për financimin e deficitit, nuk ka shkaktuar ndryshime të mëdha në strukturën e borxhit të brendshëm. Por, përveç sa më lartë vlen të theksohet që portofoli mbetet ende i ekspozuar ndjeshëm ndaj riskut të rifinancimit dhe se struktura e tij kërkon përmirësime të mëtejshme në zgjatjen e jetëgjatësisë së portofolit. Gjatë vitit 2014 janë emetuar dy garanci në tregun e brendshëm në favor të KESH sh.a. përkatësisht në vlerat 1 miliard LEK dhe 6 milionë EUR. Ndërkohë, deri në fund të vitit pritet që garancitë e brendshme të rriten deri në nivelin e 8,3 miliardë LEK. Për sa i përket garancive të jashtme, gjatë vitit 2014 janë vlerësuar me ulje për shkak të nivelit të ulët të disbursimeve.

milion LEK	2010	2011	2012	2013	Shtator 2014	Dhjetor 2014(Prsh.)
i. Stoku i borxhit të brendshëm shtetëror	401,821.00	429,925.00	454,695.00	500,868.00	533,820.35	551,977.80
ii. Stoku i borxhit të jashtëm shtetëror	268,124.00	294,276.00	319,833.00	332,500.00	376,267.73	380,302.75
I. Stoku shtetëror gjithsej (i+ii)	669,945.00	724,201.00	774,528.00	833,368.00	910,088.07	932,280.55
iii. Garancitë e brendshme	5,551.00	8,657.00	15,663.00	19,918.00	21,113.84	28,208.00
iv. Garancitë e jashtme	39,875.00	39,659.00	37,790.00	31,406.00	29,599.33	28,890.84
II. Garancitë gjithsej (iii+iv)	45,426.00	48,316.00	53,453.00	51,324.00	50,713.17	57,098.84
III. Stoku i borxhit gjithsej (I+II)	715,371.00	772,517.00	827,981.00	884,692.00	960,801.24	989,379.39
PBB	1,222,462.00	1,282,255.00	1,326,000.00	1,358,000.00	1,412,000.00	1,412,000.00
i. Stoku i borxhit të brendshëm shtetëror/PBB	32.87%	33.53%	34.29%	36.88%	37.81%	39.09%
ii. Stoku i borxhit të jashtëm shtetëror/PBB	21.93%	22.95%	24.12%	24.48%	26.65%	26.93%
I. Stoku i borxhit shtetëror/PBB	54.80%	56.48%	58.41%	61.37%	64.45%	66.03%
iii. Garancitë e brendshme/PBB	0.45%	0.68%	1.18%	1.47%	1.50%	2.00%
iv. Garancitë e jashtme/PBB	3.26%	3.09%	2.85%	2.31%	2.10%	2.05%
II. Garancitë gjithsej /PBB	3.72%	3.77%	4.03%	3.78%	3.59%	4.04%
III. Stoku i borxhit gjithsej /PBB	58.52%	60.25%	62.44%	65.15%	68.05%	70.07%

Analiza e treguesve të riskut - Përsa i përket treguesve të riskut edhe gjatë vitit 2014 ato kanë vazhduar të kenë një trend pozitiv si rezultat i emetimit të instrumentave afatgjata dhe kryesisht

si rezultat i emetimit të obligacionit 10- vjeçar 3 herë brenda kësaj periudhe në një total që arrin 9.7 miliardë LEK, rreth 2.7 herë më shumë se një vit më parë.



Ditët mesatare në maturim (jetëgjatësia mesatare e portofolit të borxhit të brendshëm) kanë pasur një përmirësim të dukshëm gjatë këtij viti duke kapur nivelin prej 612 ditë, krahasuar me 559 ditë në fundin e vitit 2013. Kjo rritje vjen kryesisht nga emetimi vazhdueshëm dhe rritja e peshës specifike të instrumentave afatgjatë në totalin e portofolit të borxhit të brendshëm (obligacionet 10 dhe 7-vjeçare). Yieldi mesatar i ponderuar (YMP, kosto mesatare e portofolit të borxhit të brendshëm) gjithashtu ka pasur një përmirësim gjatë vitit 2014. Ky tregues ka ardhur duke u ulur nga 6.72% në fund të vitit 2013 në 5.61% në fund të muajit shtator 2014, duke përmirësuar në këtë mënyrë koston mesatare të portofolit të borxhit në tregun vendas. Gjithsesi, *portofoli vazhdon të jetë i ndjeshëm ndaj luhatjeve të normave të interesit, pasi kjo ulje e yieldit mesatar të ponderuar i atribuohet likuiditetit të përkohshëm në tregun bankar si rezultat i pasigurive të sistemit përsa i përket kreditimit të ekonomisë për shkak të rritjes së NPL-ve, si edhe uljes së normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë si pjesë e politikave monetare të saj.*

Vlen të theksohet se ecuria e treguesve ka qenë pozitive, por qëndrueshmëria në aspektin afatgjatë për përmirësimin e tyre mbetet ende një sfidë në tregun e brendshëm dhe zhvillimet e tij.

Portofoli i borxhit të brendshëm - Në tabelën e mëposhtme paraqitet kompozimi i stokut të borxhit të brendshëm sipas llojit të instrumentave:

milion LEK	2010	2011	2012	2013	Qershor 2014	Shtator 2014	Dhjetor 2014(Prsh)
Stoku i Borxhit	407,372	438,581	470,358	520,786	543,425	554,934	580,186
<i>Bonot e Thesarit</i>	231,436	241,385	250,352	245,782	256,197	253,080	261,216
<i>Obligacionet</i>	170,385	188,539	204,343	255,086	266,093	280,740	290,762
<i>Rivlerësimi i Valutës</i>	0	0	0	0	0	0	0
<i>Kredi Direkte</i>	0	0	0	0	0	0	0
<i>Garancitë</i>	5,551	8,657	15,663	19,918	21,135	21,114	28,208
<i>Bonot e Thesarit %</i>	56.81%	55.04%	53.23%	47.19%	47.14%	45.61%	44.97%

Obligacionet %	41.83%	42.99%	43.44%	48.98%	48.97%	50.59%	50.16%
Rivlerësimi i Valutës%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Kredi Direkte %	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Garancite %	1.36%	1.97%	3.33%	3.82%	3.89%	3.80%	4.87%


Përsa i përket kompozimit të portofolit të borxhit të brendshëm, sipas llojit të titujve, ajo që vihet re gjatë vitit 2014 është se pjesa përbërëse e bonove të thesarit në totalin e borxhit të brendshëm është ulur nga 47.19% në fund të vitit 2013 në nivelin prej 45.61% në muajin shtator 2014. Ndërkohë është rritur pesha specifike e obligacioneve në stokun e borxhit të brendshëm me 161 pikë bazë. Gjatë kësaj periudhe kohore vihet re se po rritet diferenca ndërmjet instrumentave në favor të atyre afatgjatë, duke e bërë strukturën e borxhit të brendshëm më të qëndrueshme.

Mbajtësit e borxhit - Gjatë vitit 2014 ka vazhduar tendenca pozitive e rritjes së numrit të pjesëmarrësve në tregun primar të letrave me vlerë të Qeverisë, duke sjellë një thellim të diversifikimit të portofolit nga pikëpamja e mbajtësve të tij. Tendenda që vërehet është zvogëlimi i portofolit me tituj qeveritarë i Bankës së Shqipërisë, ulja e peshës specifike në portofol të Bankës Raiffeisen dhe në të njëjtën kohë rritja e peshës specifike në portofol për bankat e tjera si dhe për institucionet jo-banka. Më konkretisht, gjatë vitit 2014 kemi pasur rënie të peshës specifike në portofol të Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Raiffeisen përkatësisht me 87 pikë bazë dhe me 339 pikë bazë. Nga ana tjetër kemi pasur rritje në peshën specifike të institucioneve të tjera bankare dhe jo bankare përkatësisht me 281 dhe 230 pikë bazë. Ndërkohë, ndryshe nga tendenca e viteve të fundit gjatë vitit 2014 (ashtu si edhe në vitin 2013) vërehet një rënie me 85 pikë bazë të pjesëmarrjes së individëve. Kjo ulje e peshës specifike të individëve në portofolin e borxhit të brendshëm është e shoqëruar më së shumti me tendencën rënëse të normave interesit gjatë 2 viteve të fundit. Ulja e normave të interesit të letrave me vlerë ka bërë më pak tërheqëse pjesëmarrjen e individëve në ankande.

Diversifikimi i bazës së investitorëve ndikon ndjeshëm në zhvillimin e tregut primar vendas, por mbështetja tek sistemi bankar dhe angazhimi i një pjese të konsiderueshme të aseteve të tij përbën risk të konsiderueshëm për ecurinë në terma afatgjatë.

	2010	2011	2012	2013	Qershor 2014	Shtator 2014
BOA	15.41%	14.30%	12.48%	12.27%	11.79%	11.40%
Raiffeisen Bank	34.90%	34.20%	29.43%	22.55%	20.13%	19.16%
Bankat e tjera	34.40%	34.85%	37.45%	40.02%	42.00%	42.83%
Jo Banka	3.21%	3.73%	6.16%	12.66%	14.23%	14.96%
- Inst. Financiare	1.16%	3.69%	6.06%	12.61%	14.19%	14.78%
- Inst. Jo Financiare	2.05%	0.04%	0.10%	0.05%	0.04%	0.18%
Individe	12.08%	12.92%	14.48%	12.50%	11.85%	11.65%

Ecuria e normave të interesit - Në tregun primar, normat e interesit të instrumentave afatshkurtër të qeverisë kanë pësuar rënie të ndjeshme krahasuar me fundin e vitit 2013 duke kapur kështu edhe vlerat më të ulta historike, ndërkohë që titujt afatgjatë (përfshijtur obligacionet 2-vjeçare) kanë pësuar rritje të lehtë. Kjo tendencë ka nisur që prej muajit janar dhe është theksuar edhe në periudhën në vazhdim.



Kërkesa dhe likuiditeti i ofruar nga pjesëmarrësit në tregun primar të titujve qeveritarë afatshkurtër ka qenë më e lartë krahasuar me titujt afatgjatë. Ndërkohë, mosrealizimi i ankandeve të obligacioneve ka krijuar presione për rritjen e normave të interesit dhe ka bërë që kurba e normave të interesit të titujve afatgjatë të shfaqet e zhvendosur lartë.

Gjatë këtij viti instrumentat që kanë pësuar rënien më të madhe të normave të interesit janë bonot e thesarit 3-mujore dhe 12-mujore, normat e të cilave janë ulur përkatësisht me 48 dhe 44 pikë bazë krahasuar me fundin e vitit 2013. Ndërkohë, instrumentat normat e të cilave kanë pësuar rritje janë obligacionet 3 dhe 7-vjeçare përkatësisht me një rritje prej 34 dhe 22 pikë bazë. Rënia e normave të interesit për bonot e thesarit është e lidhur me disa faktorë në tregun e instrumentave financiare, si p.sh:

- Shtimi i kërkesës për këto lloj instrumentash nisur nga perceptimi i një risku të lartë për instrumentat aftgjata dhe rritja e likuiditetit të sistemit bankar, si rrjedhojë e ngurtësimit të kreditimit ndaj sektorit privat për shkak të rritjes së kredive që nuk performojnë mirë (NPL).
- Ulja e normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë nisur nga presionet e ulëta inflacioniste dhe vlerësimet për një kërkesë të brendshme të dobët.

Shërbimi i Borxhit - Shërbimi i borxhit të brendshëm në fund të vitit 2014 vlerësohet në ulje me 2.2 miliardë LEK për shkak të efektit që japin ulja e normave të interesit për instrumentat afatshkurtra gjatë 6- mujorit të dytë të vitit 2013 dhe në vazhdim gjatë vitit 2014.

Ndërkohë, përsa i përket borxhit të jashtëm interesat e tij në shumë absolute janë rritur me 1.1 miliardë si rezultat i shtimit të disbursimeve dhe stokut të borxhit të jashtëm. Sa më sipër edhe ripagesat e borxhit të jashtëm në fund të vitit 2014 vlerësohen në rritje me rreth 6.7 miliardë LEK.

Mbështetur në këto të dhëna dhe duke e parë edhe në vizionin afatgjatë është i rëndësishëm angazhimi për uljen e stokut të borxhit në mënyrë që të menaxhohen kostot që shoqërojnë huamarrjen.

milion LEK	2010	2011	2012	2013	Shtator 2014	Dhjetor 2014 (Prsh)
Shërbimi Borxhit gjithsej (I+II)	48,116	48,734	52,166	56,109	41,291	60,909
I. Interesa	41,604	41,121	41,497	43,335	28,610	42,296
Brendshëm	35,583	34,253	34,005	35,890	24,921	33,700
Huaj	6,021	6,868	7,492	7,445	3,689	8,596
II. Ripagesat	6,512	7,613	10,669	12,774	12,682	18,613
PBB	1,222,462	1,282,300	1,326,000	1,358,000	1,412,000	1,412,000
Interesa/PBB	3.40%	3.21%	3.13%	3.19%	2.03%	3.00%
Interesa, borxh i brendshëm/PBB	2.91%	2.67%	2.56%	2.64%	1.76%	2.39%
Interesa, borxh i jashtëm/PBB	0.49%	0.54%	0.57%	0.55%	0.26%	0.61%
Ripagesat/PBB	0.53%	0.59%	0.80%	0.94%	0.90%	1.32%

Borxhi i jashtëm - Në muajin shtator 2014 borxhi i jashtëm vlerësohet të jetë në nivelin e 405.8 miliardë LEK (2,9 miliardë EUR), ku 376.3 (2,7 miliardë EUR) është stoku i borxhit shtetëror, ndërkohë që pjesa tjetër i përket borxhit të garantuar. Përsa i përket monedhave që kompozojnë portofolin e borxhit të jashtëm, vihet re që në muajin shtator të vitit 2014 portofoli i borxhit të jashtëm është i kompozuar nga tre monedha kryesore (EUR, USD, YEN), ku peshën më të madhe e mban monedha EUR me 67.75% të portofolit. Krahasuar me fundin e vitit të kaluar peshat e monedhave EUR dhe USD në portofol kanë pasur një rënie përkatësisht prej 44 dhe 10 pikë bazë. Ndërkohë, kemi një rritje të peshës së monedhës YEN me 43 pikë bazë. Përqindja e lartë e stokut të borxhit në EUR bën që portofoli të jetë i ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit.

Disbursimet - Gjatë nëntë muajve të vitit 2014 janë disbursuar rreth 45.3 miliardë LEK (323.5 milionë EUR), nga të cilat 45.2 miliardë (323 milionë EUR) i përkasin borxhit shtetëror. Krahasuar me vitet e tjera vërehet një rritje e konsiderueshme e disbursimeve, e cila i atribuohet mbështetjes buxhetore në një vlerë prej 30.6 miliardë LEK (218.7 milionë Euro), ndërkohë disbursimet e projekteve me financim të huaj janë në nivele relativisht të ulëta. Disbursimet e sektorit të Transportit zënë (13.4%), të Ujësjellës Kanalizimeve (9.00%) dhe Energjetikës (6%). Shuma e angazhuar dhe e padisbursuar (pa përfshirë mbështetjen buxhetore të padisbursuar) është në nivele të larta rreth 112 miliardë LEK (800 milionë EUR). Ky tregues kërkon vëmendje nga ministritë e linjës lidhur kontraktimin e projekteve të reja dhe eficiencën e projekteve ekzistuese.

KËSHILLI I MINISTRAVE